



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN

**RAPORTI VJETOR I DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN
Z.KRESHNIK AJAZI**

**MBI PUNËN E BËRË NË PROKURORI DHE GJENDJEN
E KRIMINALITETIT NË QARKUN E ELBASANIT
PËR VITIN 2023**



Elbasan, shkurt 2024

Falenderim

Në hartimin e këtij raporti punuan dhe dhanë kontributin e tyre Zv.Drejtuasi i Prokurorisë Xhelian Seferi, kancelare Alketa Kurmaku, prokurorët Pranvera Stafa, Edlira Bako, Neritan Hoxha, oficere e policisë gjyqësore Lorena Musaj dhe punonjësit e administratës Lindita Shopi, Elida Kasa, Armida Halili, Xhesi Çimo, Fjoralba Salla, Anita Hoxha, Rozalina Terziu, Pamela Hoxha, Xhesika Latifi, Zamira Zykollari, Denada Hajdini dhe Klajva Xheka. Falenderim dhe mirënjohje për punën e bërë prej tyre.

Përgjatë vitit 2023 kanë përballuar dhe kryer një punë të jashtëzakonshme dhe me seriozitetin që kërkon lartësia e detyrës të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe stafi administrativ i prokurorisë. Mirënjohje për të gjithë kontributin e dhënë prej tyre.

Përpunimi grafik mbi baza shkencore i të dhënave në këtë raport është kryer nga oficere e policisë gjyqësore Dr.Lorena Musai.



Vlen të theksohet se Prokuroria e Elbasanit ka filluar të ushtroj funksionin e saj në vitin 1948 dhe është përfshirë gjatë këtyrë viteve në një transformim të saj në varësi të rrethanave dhe të kushteve politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Gjithashtu, pas Reformave të thella ligjore dhe strukturore që pasuan pëmbysjen e regjimit komunist dhe kthesën demokratike në vitet 90 përfshinë edhe prokurorinë, duke i kthyer asaj fizionominë dhe portretin institucional në përputhje me shtetin e së drejtës si dhe duke e përfshirë prokurorinë në pushtetin gjyqësor.

Në krye të Prokurorisë së Elbasanit kanë ushtruar funksionin e drejtuesit të saj nga viti 1990 dhe aktualisht, drejtuesit e mëposhtëm të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në luftën kundër kriminalitetit në Qarkun e Elbasanit.

DREJTUES TË PROKURORISË NDËR VITE

1. Neshat Fana	1990-1991
2. Arben Vasili	1991
3. Vangjel Tanku	1991-1992
4. Dashnor Sula	1992-1997
5. Nikolla Duro	1997-1998
6. Luan Kaloçi	1998-2002
7. Durim Bedini	2002-2008
8. Elvin Gokaj	2008-2013
9. Gentjan Osmani	2013-2015
10. Eugen Beçi	2015
11. Besnik Cani	2015-2016
12. Dritan Gina	2016-2018
13. Ardian Nezha	2018
14. Enkeleda Millonai	2018-2019
15. Kreshnik Ajazi	2019-aktualisht

Kreshnik AJAZI ka lindur në Gramsh më 5 tetor 1983. Ka përfunduar në vitin 2007 studimet me rezultate të larta në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës dhe më pas është diplomuar Magjistrat në Profilin Prokuror në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2010. Prej datës 12 tetor 2009 ka ushtruar detyrën e prokurorit në prokuroritë e Tiranës, Vlorës, Elbasanit, Kavajës dhe Pogradecit, ku për disa vite ka qënë pjesë e Njesisë së Përbashkët Hetimore Task-Force kundër Krimit Financiar dhe Korrupsionit në prokuroritë e Vlorës dhe Elbasanit si dhe ka mbajtur detyrën e drejtuesit të seksionit në prokuroritë e Tiranës dhe Elbasanit. Prej dhjetorit 2019 mban detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ka ushtruar funksionin e lektorit të jashtëm në disa institucione akademike si Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Kolegjin Universitar të Biznesit, Universitetin “A.Xhuvani” Elbasan. Në Shkollën e Magjistraturës ka filluar në vitin 2012 fillimisht si lehtësues dhe më pas si ekspert në Programin e Trajnimit Vazhdues për Gjyqtarë dhe Prokurorë dhe prej vitit 2023 edhe si pedagog i jashtëm për Programin e Trajnimit Fillestar për Gjyqtarë dhe Prokurorë. Prej vitit 2018 është ekspert lokal i Këshillit të Europës.

Ka marrë pjesë në shumë trajnime, vizita studimore, konferenca shkencore, takimet ndërkombëtare, grupe ekspertësh ligjor, shkolla verore etj., brenda dhe jashtë vendit. Është autor i disa shkrimeve akademike në lëmin e së drejtës.

© Të gjitha të drejtat e pronësisë së këtij raporti që burojnë nga e drejta e autorit i takojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Prokurorisë së Përgjithshme

Në çdo riprodhim të plotë apo të pjesëshëm të këtij raporti duhet të shënohet emërtimi i titullarit të së drejtës së autorit

PËRMBAJTJA

KREU 1 DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË VITIN 2023

1.1	Të dhëna për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë	Fq.1
1.2	Rritja e rolit aktiv të prokurorit dhe hetimet proaktive	Fq.3
1.2.1	Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit	Fq.5
1.2.2	Lufta kundër korrupsionit	Fq.6
1.2.3	Lufta kundër krimit të organizuar	Fq.7
1.3	Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm	Fq.8
1.3.1	Udhëzime të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë	Fq.8
1.3.2	Akte të Drejtuesit të Prokurorisë	Fq.9
1.4	Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj	Fq.13
1.5	Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm	Fq.17
1.6	Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal.	Fq.21
1.6.1	Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut	Fq.22
1.7	Grupet vulnerabël, të miturit në konflikt me ligjin, dëshmitarë dhe viktimë të veprës penale	Fq.23
1.8	Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe zbatimi i akteve/marrëveshjeve	Fq.24
1.8.1	Bashkëpunimi institucional me Policinë e Shtetit	Fq.25
1.8.2	Bashkëpunimi institucional me Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan	Fq.26
1.8.3	Bashkëpunimi institucional me Këshillin e Lartë të Prokurorisë	Fq.26
1.8.4	Bashkëpunimi institucional me Prokurorinë e Përgjithshme	Fq.26
1.8.5	Bashkëpunimi institucional me Komisionin e Policisë Gjyqësore	Fq.26
1.8.6	Bashkëpunimi me institucionet e tjera	Fq.27
1.8.7	Këshilli Vendor i Sigurisë Publike	Fq.27
1.8.8	Marrëveshjet dhe referimet për vitin 2023	Fq.28
1.8.9	Bashkëpunimi ndërkombëtar	Fq.30
1.9	Të dhëna lidhur me temat dhe trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.	Fq.30

KREU 2 ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

2.1	Volumi i punës në hetim.	Fq.31
2.2	Të dhëna mbi vendimet e mosfillimeve	Fq.34
2.2.1	Të dhëna statistikore për vendimet e mosfillimit	Fq.34
2.3	Të dhëna për procedime të pushuara	Fq.35
2.3.1	Kërkesat për pushim dhe pushimet	Fq.35
2.3.2	Kërkesat për pushim të ndara sipas krekrëve të kodit penal	Fq.36

2.3.3	Kërkesa për pushim përpersonat nën hetim/të arrestuar për të cilat është kërkuar pushimi i çështjes	Fq.37
2.3.4	Shkaqet e pushimit të çështjeve	Fq.38
2.4	Të dhëna statistikore për procedime të pezulluara	Fq.38
2.4.1	Procedime penale të pezulluara të ndara sipas krerëve të kodit penal	Fq.39
2.5	Të dhëna statistikore për procedime të transferuara	Fq.40
2.5.1	Kompetencat të ndara sipas krerëve të kodit penal	Fq.40
2.6	Kërkesa për dërgimin e çështjeve për gjykim	Fq.41
2.6.1	Çështje të dërguara për gjykim sipas krerëve të kodit penal	Fq.41
2.6.2	Çështje të përfaqësuara në gjykatë	Fq.42
2.7	Të dhëna statistikore për procedime me të pandehur/persona nën hetim	Fq.43
2.8	Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal	Fq.44
2.9	Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afateve të hetimeve paraprake	Fq.49
2.10	Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit pasuror	Fq.51
2.11	Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë	Fq.54
2.11.1	Urdhëra ekzekutimi	Fq.54
2.11.2	Urdhërat e ekzekutuara	Fq.55
2.11.3	Urdhëra të mbartura të paekzekutuara	Fq.56
2.12	Gjykimet në fazën e ekzekutimit me të dënuar	Fq.57
2.13	Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të Njësi Administrative	Fq.59
2.14	Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së v.p dhe tendencave të tyre	Fq.60
2.15	Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje)	Fq.61

KREU 3 TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJEÇARË TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

3	Të dhëna mbi veprat penale të ndara sipas krerëve të kodit penale viteve 2022-2023	Fq.62
3.1	Procedime penale të regjistruara përgjatë viteve 2022-2023	Fq.93
3.1.1	Krime kundër jetës me dashje, vitet 2022-2023	Fq.93
3.1.2	Vepra penale me dashje kundër shëndetit, vitet 2022-2023	Fq.94
3.1.3	Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës, apo shkaktim vetëvrasje	Fq.95
3.1.4	Vepra penale me natyrë seksuale	Fq.95
3.1.5	Vepra penale kundër lirisë së personit	Fq.96
3.1.6	Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	Fq.96
3.1.7	Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes	Fq.97
3.1.8	Vepra penale në lidhje me vjedhjen e pasurisë	Fq.98
3.1.9	Veprat penale në lidhje me mashtrimet	Fq.98
3.1.10	Vepra penale që lidhen me shkatërrimin e pronës	Fq.99
3.1.11	Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare	Fq.99
3.1.12	Vepra penale për krime në fushën e doganave	Fq.100
3.1.13	Vepra penale në fushën e tatim taksave	Fq.100
3.1.14	Vepra penale në lidhje me falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë	Fq.101
3.1.15	Vepra penale në lidhje me falsifikimi i dokumentave	Fq.101

3.1.16	Vepra penale në lidhje me zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit	Fq.102
3.1.17	Vepra penale që çenojnë regjimin juridik të tokës	Fq.102
3.1.18	Vepra penale kundër mjedisit	Fq.103
3.1.19	Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga shtetasit	Fq.103
3.1.20	Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga punonjësit	Fq.104
3.1.21	Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike	Fq.105
3.1.22	Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore	Fq.105
3.1.23	Vepra penale kundër drejtësisë	Fq.106
3.2	Të dhëna krahasuese për çështjet e përfaqësuara në gjykime themeli për vitet 2022-2023	Fq.107
3.3	Të dhëna krahasuese për gjykimet e themelit për të pandehurit për vitet 2022-2023	Fq.108
3.4	Kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës, vitet 2022-2023	Fq.109

KREU 4 ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË

4.1	Treguesi i efektivitetit në hetim dhe ndjekje penale	Fq.112
4.1.1	Raporti i çështjeve dhe të pandehurve të dërguara me kërkesë për gjykim me ato të pushuara	Fq.112
4.1.2	Raporti i çështjeve të pezulluara me çështjet e përfunduara në hetimet paraprake	Fq.113
4.2	Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe dënimin e të pandehurve	Fq.114
4.3	Të dhëna për gjykimet e posaçme	Fq.115
4.4	Numri i procedimeve për të cilët është proceduar me secilin nga llojet e gjykimeve	Fq.116
4.5	Të dhëna sociale dhe demokratike mbi të pandehurit (gjinia, mosha, arsimi, punësimi)	Fq.117
4.5.1	Persona nën hetim/ pandehur sipas gjinisë	Fq.117
4.5.1.1	Persona nën hetim/ pandehur sipas gjinisë, të ndarë sipas krerëve të kodit penal	Fq.117
4.5.2	Persona nën hetim/ pandehur sipas nivelit arsimor	Fq.118
4.5.2.1	Persona nën hetim/ pandehur sipas nivelit arsimor, të ndarë sipas krerëve të kodit penal	Fq.118
4.5.3	Të pandehurit sipas vendbanimit	Fq.119
4.5.3.1	Persona nën hetim/ pandehur sipas vendbanimit, të ndarë sipas krerëve të kodit penal	Fq.119
4.5.4	Gjendja gjyqësore e të pandehurve	Fq.121
4.6	Të dhëna mbi viktimat e veprave penale dhe pasojat e veprës penale	Fq.122
4.7	Të dhëna për referime, mosfillime e procedime për personat/pandehur të mitur të regjistruara në vitin 2023	Fq.123
4.7.1	Mënyra e përfundimit të çështjeve me të mitur	Fq.125
4.7.2	Viktimat e mitur nga vepra penale	Fq.126
4.8	Vepra penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës	Fq.127

KREU 5 TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

5.1	Ekstradime	Fq.129
5.2	Letërporosi	Fq.129
5.3	Njohjet e vendimeve penale	Fq.131
5.4	Transferime të dënuarish	Fq.132
5.5	Shpalljet/Heqjet nga kërkimi ndërkombëtar	Fq.132

KREU 6 TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

6.1	Të dhëna për ngarkesën dhe treguesit e punës për prokuroret	Fq.133
6.2	Të dhëna për ngarkesën dhe treguesit e punës për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve	Fq.152

KREU 7 INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

7.1	Struktura organike	Fq.165
7.1.1	Organizimi i brëndshëm i prokurorisë	Fq.167
7.1.2	Administrimi i burimeve	Fq.170
7.1.2.1	Emërimi i zv/drejtuesit të prokurorisë	Fq.170
7.1.1.2	Procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve (Vetting)	Fq.172
7.1.1.3	Lëvizjet në organikën e prokurorëve	Fq.173
7.1.2.4	Shqetësime të ngritura në lidhje me organikën e re	Fq.174
7.1.2.5	Mbrojtja fizike e prokurorëve	Fq.180
7.1.2.6	Procesi i vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve	Fq.180
7.1.2.7	Oficerët e policisë gjyqësore	Fq.180
7.1.2.7.1	Karriera e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit	Fq.182
7.1.2.7.2	Vlerësimi i punës së oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit	Fq.183
7.1.2.7.3	Propozim për shpërblim me merita profesionale për oficerët e policisë gjyqësore	Fq.186
7.1.2.8	Rekrutime të reja lidhur me stafin administrativ përgjatë vitit 2023	Fq.187
7.1.2.9	Procedura e ndjekur në rastet e punësimeve	Fq.188
7.1.2.10	Procedura e ndjekur në rastet e largimeve	Fq.189
7.2	Raporti financiar	Fq.191
7.3	Informacion mbi Regjistrat	Fq.193
7.3.1	Informacioni i klasifikuar	Fq.197
7.3.2	Administrimi i arkivës dhe dhomës së provave materiale	Fq.198
7.4	Mbi administrimin e prokurorisë	Fq.201
7.5	Siguria fizike në institucion	Fq.201

7.6	Masat administrative dhe procedurale në kuadër të procesit zgjedhor 2023	Fq.202
7.7	Skema e shpërndarjes së zyrave	Fq.202
7.8	Inspektime të kryera nga institucione në prokurori	Fq.203
7.8.1	Inspektim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit	Fq.203
7.8.2	Rekomandim nga Avokati i Popullit	Fq.203
7.8.3	Inspektim nga Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë	Fq.203
7.8.4	Kërkesa për fillim procedimi disiplinor	Fq.204
KREU 8	INFORMACION PËR MARËDHENIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT	
8.1	Tranparenca	Fq.205
8.2	Procesi monitorues nga komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Fq.206
8.3	E drejta informimit	Fq.207
8.4	Marrëdhëniet me publikun	Fq.208
KREU 9	Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024. Rekomandime	Fq.216

Shkurtime termash në këtë raport :

KLP – Këshilli i Lartë i Prokurorisë

KLGG – Këshilli i Lartë Gjyqësor

ILD – Inspektori i Lartë i Drejtësisë

PP – Prokurori i Përgjithshëm

MD – Ministria e Drejtësisë

DPPSH – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

DVP Elbasan – Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan

AMP – Agjensia e Mbikqyrjes Policore

OPGJ – Oficer i Policisë Gjyqësore

DPT – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

DPD – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

SHKBB – Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve

IEVP – Institucion Ekzekutimi i Vendimeve Penale

IML – Instituti i Mjekësisë Ligjore

IPSH – Instituti i Policisë Shkencore

ONM – Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

KPA – Komisioni i Pavarur i Ankimimit

KPK – Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

KVSP – Këshilli Vendor i Sigurisë Publike

cp – caktim i përkohshëm

KREU I
DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË
VITIN 2023

1.1 TË DHËNA PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE PRIORITARE TË PROKURORISË

Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 97, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin Penal, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur” ,në “Kodin Penal ushtarak”, në “Kodin e Procedurës Penale”, Rezolutës së dt.06.07.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2022”, si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.103 dt.25.07.2023 “Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2022”, të Rekomandimeve Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.226 datë 13.04.2023, Udhëzimit nr.02 datë 29.07.2022 “ Për rekomandimet prioritare të këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokurorië e juridiksionit të përgjithshëm” si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.70 dt. 12.05.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke pasur parasysh edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023, është fokusuar në punën e saj duke i dhënë prioritet në punën e saj këtyre drejtimeve kryesore:

- *Rritja e efikasitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprës penale dhe kimit financiar;*
- *Lufta kundër korrupsionit;*
- *Rritja e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë;*
- *Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit;*
- *Rritja e efikasitetit në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në luftën ndaj veprave penale të dhunës në familje, kundër fëmijëve dhe grave,krimeve me motive të urrejtjes,si dhe masat e marra për trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave për këto vepra penale;*
- *Rritja e efikasitetit në luftën kundër kimit të organizuar dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Kimit të Organizuar;*
- *Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional.*
- *Zhvillimi i aktivitete të përbashkëta trajtuese me institucione/agjenci ligjzbatuese për veprat penale të pastrimit të parave*
- *Rritja e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre*

- *Mirëfunksionimin e punës në prokurori dhe shpërndatjen e drejtë të çështjeve, mbi bazën e kriterëve transparente të percaktuara nga Prokurori i Përgjithshëm*
- *Rritja e trajnimeve në lidhje me ndjekjen penale ndaj grupveprave të trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, si dhe për mbrojtjen e viktimave dhe në vecanti gratë dhe fëmijët.*
- *Përmirësimi, mbajtja dhe plotësimi me korrektesi i të dhënave statistikore lidhur me viktimat, të miturit dhe të dhënat socio-demografike.*
- *Identifikimi i problemeve dhe masat konkrete për përmirësimin e sistemit menaxhimit të çështjeve” (CAMS).*

Krahas këtyre prioriteteve, gjatë vitit 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është punuar, pa lënë mënjanë, edhe në lidhje me ndjekjen penale dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve penale në lidhje me veprat penale kundër shëndetit dhe jetës, në fushën e krimit ekonomik, kundër autoritetit të shtetit të kryer nga shtetas, veprave penale që çënojnë lirinë e zgjedhjeve, mbrojtjen e regjimit juridik të tokës, vepra penale kundër mjedisit apo veprave të tjera penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 nga prokurorët e kësaj prokurorie i është kushtuar rëndësi dhe përdorimit më efektiv të instituteve procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, duke qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor përkatës.

Gjithashtu është punuar për hartimin dhe nxjerrjen e rregullave standard për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës, si dhe rritjen e pavarësisë së prokurorëve dhe forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësi nga çdo prokuror.

Në kuadër të funksionit drejtues është rritur kontrolli prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.

Është përmirësuar organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.

Është pasur në vëmendje respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Po kështu në vëmendje ka qenë dhe rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.

Administrimi i sistemit elektronik e-tracking PRESTO, për hedhjen e të dhënave të përditësuara për çështjet e regjistruara për vitin 2023 e në vijim dhe çështjet e mbartura me 1 janar 2023 e në vijim, për veprat penale të pastrimit të parave në zbatim të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm

Nr.92 datë 30.07.2021 ”Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfitimin e statistikave për çështje të pastrimit të parave në Prokuroritë e Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm (e-tracking, PRESTO “dhe në përmbushje të planit të veprimit ICRG/FATF, në kuadrin e integritetit europian të vendit kryhet nga vetë prokurorët e Seksionit të Posaçëm Kundër Pastrimit të Parave, Krimeve Financiare, Financimin e Terrorizmit dhe Hetimet Pasurore. Gjatë

përdorimit të sistemit elektronik, prokurorët kanë vërejtur vonesa në përpunimin e të dhënave si dhe volume të konsiderueshëm detajesh të cilat ekspozojnë hetimin.

1.2 RITJA E ROLIT AKTIV TË PROKURORIT DHE HETIMET PROAKTIVE

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Elbasan, në varësi të natyrës së veprës penale, janë zhvilluar hetime proaktive, disa prej të cilave kanë rezultuar të suksesshme. Kryesisht, janë zhvilluar hetime proaktive për hetimin e veprave penale kundër veprave të rënda ndaj jetës në fushën e korrupsionit, narkotikëve, duke përdorur kryesisht metodat hetimore të përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiental. Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2023 janë regjistruar 62 procedime për të cilët janë zhvilluar hetime proaktive.

Lidhur ngushtë dhe me hetimet proaktive që janë zhvilluar, si mjete për kërkimin e provës janë përdorur dhe:

- Kontrolllet, parashikuar nga nenet 202-207 të K.Pr.Penale.
- Përgjimet, ku përfshihen përgjimet telefonike dhe ambientale, përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes, mjete këto të parashikuara dhe në Seksionin IV të K.Pr.Penale, neni 222 e vijues të këtij kodi.
- Veprime simuluese, të parashikuar nga neni 294/a i K.Pr.Penale.

• OPERACIONE TË SUKSESSHME PËRGJATË VITIT 2023

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023 në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm që organi procedues ka me Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan janë ndërmarrë tre operacione të suksesshme në luftën kundër narkotikëve. Konkretisht:

- Operacioni “Rrjeti” me 86 autorë të dyshuar, nga të cilët 5 të arrestuar, 45 të ndaluar, 7 në kërkim dhe 29 në gjëndje të lirë;
- Operacioni “Tempulli”, me 17 autorë të dyshuar, nga të cilët 3 të arrestuar, 11 të ndaluar dhe 3 në gjëndje të lirë;
- Operacioni “Never Forget”, me 16 autorë të dyshuar, nga të cilët 2 të arrestuar, 11 të ndaluar dhe 3 në kërkim.

Arritja e një rezultat të suksesshëm i atribuhet punës intensive të punonjësve të policisë në bashkëpunim me organin procedues si dhe teknikave speciale të hetimeve proaktive, si kontrolllet, përgjimet, veprimet simuluese etj.

• KONTROLLET:

Gjatë vitit 2023 nga Prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë bërë në gjykatë 33 kërkesa për kontrolle vendesh, kërkesa këto të miratuara edhe nga gjykata ndërsa gjatë vitit 22 kemi patur 22 kërkesa për kontroll.

- **PËRGJIMET:**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbahet regjistri i posaçëm ku rregjistrohen të dhënat për përgjimet, sipas treguesve të regjistrit.

Nga të dhënat e deritanishme, referuar edhe të dhënave të marra në gjykatë, rezultojnë se janë rregjistruar 123 vendime lejim përgjimi, ku përfshihen si ato ambjentale, ashtu dhe ato telefonike, për zgjatje afatit të përgjimeve,

- **VEPRIMET SIMULUESE:**

Veprime simuluese rezultojnë të jenë përdorur në 126. raste në lidhje me procedime penale të regjistruara për veprat penale të parashikuar nga nenet 283 i K.Penal. Veprimet simuluese janë rritur ndjeshëm në krahasim me një vit më parë, kjo si pasojë e tre orperacioneve të rëndësishme që Prokuoria ka kryer me Drejtorinë Vendore të Policië Elbasan.

- **BASHKËPUNIM DHE NEGOCIATË ME DREJTËSINË**

Si rezultat i hetimeve procedurale gjatë vitit 2023 kemi patur në dy procedime penale, 2 të penduar të cilët kanë bashkëpunuar me organin procedues. Njëri nga procedimet është ndjekur nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe tjetri nga zëvendës drejtuesi i Prokurorisë.

- **PERSONA NË KËRKIM NDËRKOMBËTAR.**

Nga Mbretëria e bashkuar në Shqipëri, njohje e vendimit penal të huaj, me Vendimin Nr 470 datë 02.03.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Kjo procedurë është ndjekur nga Drejtuesi i Prokurorisë Z.Kreshnik Ajazi.

- **PROCEDIME KRYESISHT**

Gjatë këtij viti janë filluar kryesisht nga prokurori 6 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal 3(tre) procedime penale, 1(një) për neni 201 të Kodit penal, 1(një) për neni 319 të K.Penal, 1(një) për nenin 295/a/1 të Kodit Penal.

1.2.1 GARANTIMI I PAVARËSISË DHE I PËRGJEGJSHMËRISË SË PROKURORIT

1. Të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke ju kërkuar prokurorëve që në rastet që ata mund të marrin dijeni nga media apo informacionet që ata mund të administrojnë për shkak të funksionit të tregohen sa më aktivë për fillimin kryesisht të hetimeve. Afati : brenda 3 muajve.

2. Të nxiten prokurorët që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e OPGJ-ve, duke u inkurajuar ata që të evidentojnë rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbushjen e detyrave që u ngarkon ligji. Afati : në vijim.

3. Të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/ose oficerët e Policisë Gjyqësore të kësaj prokurorie lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe më pas të organizohen trajnime të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve duke ia paraqitur këto shqetësime Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shkollës së Magjistraturës për të mundësuar trajtimin e tyre në programet e trajnimeve vazhduese. Afati : brenda muajit qershor.

4. Të merren masa për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve, duke u inkurajuar prokurorët që të raportojnë pa asnjë hezitim rastet kur ndaj tyre është ushtruar ndonjë influencë apo ndikim i kundraligjshëm. Afati : në vijim.

5. Në kuadër të forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe të llogaridhënies së prokurorit, nga Drejtuesi i Prokurorisë nëpërmjet kërkesave për informacion dhe udhëzimeve jo detyruese do të mundësohet kontrolli sipas parashikimeve ligjore, si dhe në rast se konstatohen shkelje të rënda do të informohen ILD-ja, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, kjo dhe në kuadër të zbatimit e monitorimit të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm. Afati : në vijim.

6. Do të identifikohen problemet dhe do të merren masa konkrete për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS) dhe PRESTO, duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e IT-së dhe Drejtorinë Ekonomike dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve, për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave. Afati : në vijim.

7. Do të merren masa nëpërmjet tërheqjes së vëmendjes apo udhëzimeve detyruese për marrjen e masave për zbatimin nga prokurorët të rekomandimeve prioritare. Afati : në vijim.

8. Nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie do merren masa për të garantuar pavarësinë në vendimarrjen e tyre nga çdo ndërhyrje e paligjshme, duke siguruar zbatimin e kërkesave të ligjit si dhe duke reaguar proceduralisht në rastet e konstatimit të ndërhyrjeve të paligjshme. Afati : në vijim.

1.2.2 LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

1. Nga prokurorët e kësaj prokurorie duhet të rritet cilësia e hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit që janë kompetencë lëndore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave pro-aktive të hetimit për aq sa është e mundur, si dhe duke rritur numrin e personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave. Afati : në vijim.
2. Nga prokurorët e kësaj prokurorie duhet të rritet numri i hetimeve pro-aktive pasurore dhe financiare, veçanërisht për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie. Afati : në vijim.
3. Nga prokurorët e kësaj prokurorie duhet të synohet shtimi i numrit të hetimeve pro-aktive (çështje të filluara kryesisht) me qëllim përnirësimin e cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit, në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie. Afati : në vijim.
4. Do të synohet shtimi i numrit sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimi i aseteve të sekuestruara/konfiskuara. Afati : në vijim.
5. Do të synohet zhvillimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashketa me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjensitë e zbatimit të ligjit, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore. Afati : në vijim.
6. Do të ndiqen me përparësi kallëzimet/çështjet penale që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe SPAK-un. Afati : në vijim.
7. Prokurorët e kësaj prokurorie të jenë aktivë dhe aplikimin e masave të sigurisë me natyrë ndaluese mbi personat zyrtarë publik mbi të cilët ka dyshime për kundërligjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre. Afati : në vijim.
8. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale përsa i takon masave të sigurimit personal dhe llojeve dhe masave të dënimit ndaj të pandehurve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale, krimet mjedisore, krimet ndaj të miturve, krimet e rënda, trafiket e paligjshme dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.
9. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave ndaj pasurisë me burim kriminal sipas kriterëve të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.10192/2009 si dhe rrisin kujdesin e nevojshëm për ndjekje penale efektive të rasteve të pastrimit të produkteve të veprës penale. Të realizohen sekuestrime asetesh me prejardhje të dyshuar kriminale. Afati : brenda muajit dhjetor 2023.
10. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ndjekjen me dilijencë dhe përparësi, kur është rasti edhe me metoda speciale hetimi dhe në bashkëpunim të ngushtë me policinë e shtetit, procedimet penale për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, krimet e rënda, trafiket e paligjshme, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.
11. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin, në rastet e procedimeve penale ndaj vepra penale prioritare të rekomanduara, të metodave speciale të hetimit dhe mjeteve për kërkimin e provës të tilla si përgjime të telekomunikimeve, përgjime dhe vëzhgime ambjentale

në vende private dhe publike, veprime simuluese, lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me bashkëpunëtorin e drejtësisë, kontrollet e vendeve, sekuestrimet e të dhënave bankare, elektronike etj. Afati : në vijim dhe dinamikë.

12. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie tregojnë dilijencën e duhur për të iniciuar kryesisht dhe rritur numrin e hetimeve pasurore përse i takon hetimit dhe gjurmimit të pasurive të dyshuara me burim kriminal, për plotësimin e rekomandimeve të Moneyval, duke utilizuar edhe bashkëpunimin rajonal si dhe me Eurojust. Afati : në vijim dhe dinamikë.

13. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale, forcimin e dilijencës në hetime dhe rritjen e vëmëndjes në hetimin dhe gjykimin e efektiv të krimeve zgjedhore, rrisin bashkëpunimin e shërbimet e policisë gjyqësore në institucione të tjera. Afati : në vijim dhe dinamikë.

1.2.3 LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

1. Nga prokurorët e kësaj prokurorie duhet të forcohet më tej bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjensive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike. Afati : në vijim.

2. Do të synohet përmirësimi i cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore. Afati : në vijim.

3. Do të synohet fuqizimin i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet hartimit në kohë të letërporosive, në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj. Afati : në vijim.

4. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale përse i takon masave të sigurimit personal dhe llojeve dhe masave të dënimit ndaj të pandehurve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale, krimet e rënda, trafiket e paligjshme dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.

5. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave ndaj pasurisë me burim kriminal sipas kriterëve të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.10192/2009 si dhe rrisin kujdesin e nevojshëm për ndjekje penale efektive të rasteve të pastrimit të produkteve të veprës penale. Të realizohen sekuestrime asetesh me prejardhje të dyshuar kriminale. Afati : brenda muajit dhjetor 2023.

6. Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin me dilijencë dhe në afat plotësimin e kërkesave nga autoritetet e huaja për ndihmë juridike në fushën penale. Afati : në vijim.

7. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ndjekjen me dilijencë dhe përparësi, kur është rasti edhe me metoda speciale hetimi dhe në bashkëpunim të ngushtë me policinë e shtetit, procedimet penale për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, krimet e rënda, trafiket e paligjshme, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.

8. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin, në rastet e procedimeve penale ndaj vepra penale prioritare të rekomanduara, të metodave speciale të hetimit dhe mjeteve për

kërkimin e provës të tilla si përgjime të telekomunikimeve, përgjime dhe vëzhgime ambjentale në vende private dhe publike, veprime simuluese, lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me bashkëpunëtorin e drejtësisë, kontrollet e vendeve, sekuestrimet e të dhënave bankare, elektronike etj. Afati : në vijim dhe dinamikë.

9. Prokurorët e kësaj prokurorie inkurajohen të vlerësojnë lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me bashkëpunëtorin e drejtësisë, nëse janë kushtet ligjore. Afati : në vijim dhe dinamikë.

10. Drejtuesi i Prokurorisë vlerëson ngritjen dhe krijimin e grupeve hetimore për çështje penale dhe hetimeve komplekse. Afati : në vijim.

1.3 INFORMACION MBI ZBATIMIN E UDHËZIMEVE TË PËRGJITHSHME TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Me qëllim zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan janë hartuar, përveç masave konkrete të marra për zbatimin e tyre, si mbledhja e prokurorëve dhe diskutimi tyre, udhëzimet dhe urdhëra. Pasqyrimi si më poshtë vijon:

1.3.1 UDHËZIME TË NXJERRA NGA DREJTUESI I PROKURORISË

Përgjatë vitit 2023 nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë nxjerrë **2 udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete** dhe **3 udhëzime të përgjithshme të detyrueshme**. Rezulton se të gjitha këto udhëzime janë pranuar nga prokurorët e kësaj prokurorie dhe nuk ka pasur asnjë kundërshtim apo ankimim për to.

- Udhëzim jo detyrues nr.11, datë 05.01.2023 për çështje konkrete që ka të bëjë me shpërndarjen e lëndëve narkotike
- Udhëzim nr.55, datë 27.07.2023 “Për çështje konkrete”
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.14, datë 16.01.2023 “Mbi disa masa administrative dhe procedurale në kuadër të mirëfunksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.35, datë 26.05.2023 “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”
- Udhëzim i Përgjithshëm nr.49, datë 30.06.2023 “Për disa rishikime në Udhëzimet e Përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të rekomandimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

1.3.2 AKTE TË DREJTUESIT TË PROKURORISË

Përgjatë vitit 2023 nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë nxjerrë **78 akte të ndryshme me natyrë administrative dhe procedurale**. Rezulton se të gjitha këto akte janë pranuar nga prokurorët e kësaj prokurorie dhe nuk ka pasur asnjë kundërshtim apo ankimim për to.

1. Urdhër nr.1, datë 04.01.2023 “Për delegimin e firmës”
2. Urdhër nr.2, datë 04.01.2023 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.87, datë 15.09.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
3. Urdhër nr.3, datë 04.01.2023 “Për nëpunësin autorizues të nivelit të dytë”
4. Urdhër nr.4, datë 04.01.2023 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël”
5. Urdhër nr.5, datë 04.01.2023 “Për krijimin e komisionit të kolaudimit”
6. Urdhër nr.6, datë 04.01.2023 “Për Grupin e Menaxhimit Strategjik”
7. Urdhër nr.7, datë 04.01.2023 “Për deklarimin e konfliktit të interesit nga zyrtarët e prokurimit”
8. Urdhër nr.8, datë 04.01.2023 “Për përcaktimin e normave limit të konsumimit të karburantit për vitin 2023”
9. Urdhër nr.9, datë 04.01.2023 “Për delegimin e kompetencave në organizimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit”
10. Urdhër nr.10, datë 04.01.2023 “Mbi organizimin e brendshëm administrative të punës në prokurori”
11. Udhëzim jo detyrues nr.11, datë 05.01.2023 për çështje konkrete që ka të bëjë me shpërndarjen e lëndëve narkotike
12. Urdhër nr.12, datë 06.01.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
13. Urdhër nr.13, datë 16.01.2023 “Për vlerësimin profesional të rezultateve të punës dhe integritetin etik të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
14. Udhëzim i Përgjithshëm nr.14, datë 16.01.2023 “Mbi disa masa administrative dhe procedurale në kuadër të mirëfunksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
15. Urdhër nr.15, datë 23.02.2023 “Për delegimin e firmës për ekzekutimin e vendimeve penale”
16. Urdhër nr.16, datë 27.02.2023 “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Z. Gentjan Habazaj”
17. Urdhër nr.17, datë 27.02.2023 “Mbi normimin e disa rregullave që kanë të bëjnë me nëpunësit e administratës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre gjatë periudhës së procesit zgjedhor”
18. Urdhër nr.18, datë 02.03.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe të firmës”
19. Urdhër nr.19, datë 15.03.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.3, datë 06.01.2022 “Për caktimin e Drejtuesve të Seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)

20. Urdhër nr.20, datë 17.03.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit G.Habazaj”
21. Urdhër nr.21, datë 23.03.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe firmës”
22. Urdhër nr.22, datë 27.03.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe firmës për çështjet penale që lidhen me procesin zgjedhor të datës 14.05.2023”
23. Urdhër nr.23, datë 27.03.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit G.Habazaj”
24. Urdhër nr.24, datë 11.04.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
25. Urdhër nr.25, datë 12.04.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare”
26. Urdhër nr.26, datë 12.04.2023 “Mbi organizimin e shërbimit të gadishmërisë së përforcuar së prokurorëve, oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore dhe punonjëve të administratës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për periudhën zgjedhore nga 14.04.2023 deri më dt.19.05.2023” (nxjerrë nga Drejtuesi i Seksionit të Përgjithshëm)
27. Urdhër nr.27, datë 14.04.2023 “Për përjashtimin nga shorti të prokurorit Xh.Seferi”
28. Urdhër nr.28, datë 02.05.2023 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.2, datë 06.01.2022 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)
29. Urdhër nr.29, datë 02.05.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
30. Urdhër nr.30, datë 11.05.2023 “Për disa ndryshime në Urdhër nr.26 dt.12.04.2023 “Mbi organizimin e shërbimit të gadishmërisë së përforcuar së prokurorëve, oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore dhe punonjëve të administratës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për periudhën zgjedhore nga 14.04.2023 deri më dt.19.05.2023”. (nxjerrë nga Drejtuesi i Seksionit të Përgjithshëm)
31. Urdhër nr.31, datë 11.05.2023 “Për disa ndryshime në Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë nr.10, datë 04.01.2023 “Për organizimin e brendshëm administrativ të punës në prokurori”
32. Urdhër nr.32, datë 16.05.2023 “Për hapjen e zyrës dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit që lidhet me detyrën të prokurores Zena Lila”
33. Urdhër nr.33, datë 16.05.2023 “Për përjashtimin nga shorti të prokurorit Z.Lila”
34. Thirrje nr.34, datë 22.05.2023 “Për mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”
35. Udhëzim i Përgjithshëm nr.35, datë 26.05.2023 “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”
36. Urdhër nr.36, datë 26.05.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” të Prokurorit të Përgjithshëm”
37. Urdhër nr.37, datë 29.05.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurores Z.Lila”

38. Urdhër nr.38, datë 02.06.2023 “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurorët Z. Ritvan Suka dhe Z. Platin Aliçka”
39. Urdhër nr.39, datë 02.06.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.2, datë 06.01.2022 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar) si dhe në urdhërin nr.3, datë 06.01.2022 “Për caktimin e drejtuesve të seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)”
40. Urdhër nr.40, datë 02.06.2023 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr. 12, datë 04.02.2020 “Për shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe median në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)”
41. Urdhër nr.41, datë 02.06.2023 “Për delegimin e firmës”
42. Urdhër nr.42, datë 13.06.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit Ritvan Suka dhe prokurores Zena Lila”
43. Thirrje nr.43, datë 13.06.2023 “Për mbledhjen e prokurorëve”
44. Urdhër nr.44, datë 14.06.2023 “Për fillimin e procedurës së emërimit të Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”
45. Urdhër nr.45, datë 14.06.2023 “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Z. Arbër Berexha”
46. Urdhër nr.46, datë 20.06.2023 “Për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”
47. Urdhër nr.47, datë 23.06.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit Arbër Berexha”
48. Urdhër nr.48, datë 26.06.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit Platin Aliçka”
49. Udhëzim i Përgjithshëm nr.49, datë 30.06.2023 “Për disa rishikime në Udhëzimet e Përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të rekomandimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”
50. Thirrje nr.50, datë 13.07.2023 “Për mbledhjen e prokurorëve”
51. Urdhër nr.51, datë 14.07.2023 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.2, datë 06.01.2022 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)
52. Urdhër nr.52, datë 14.07.2023 “Për disa ndryshime në Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë nr.10, datë 04.01.2023 “Për organizimin e brendshëm administrativ të punës në prokurori”
53. Urdhër nr.53, datë 25.07.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e punës, delegimin e kompetencave si dhe dhënien e lejeve të zakonshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan gjatë pushimeve vjetore nga data 01 Gusht 2023 deri më datë 04 Shtator 2023”
54. Urdhër nr.54, datë 26.07.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
55. Udhëzim nr.55, datë 27.07.2023 “Për çështje konkrete”
56. Urdhër nr.56, datë 31.07.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të

- Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022”
57. Urdhër nr.57, datë 04.09.2023 “Për përjashtimin nga shorti të prokurorit Xh.Seferi”
 58. Thirrje nr.58, datë 15.09.2023 “Për mbledhjen e prokurorëve”
 59. Urdhër nr.59, datë 18.09.2023 “Për zbatimin e Urdhërit nr.94, dt.12.09.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për marrjen e informacionit periodik nga kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive lidhur me veprimtarinë gjyqësore dhe veprimtarinë e prokurorive”
 60. Urdhër nr.60, datë 05.10.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.2, datë 06.01.2022 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)”
 61. Urdhër nr.61, datë 05.10.2023 “Për disa ndryshime në Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë nr.10, datë 04.01.2023 “Për organizimin e brendshëm administrativ të punës në prokurori”
 62. Urdhër nr.62, datë 05.10.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
 63. Urdhër nr.63, datë 05.10.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe firmës”
 64. Vendim nr.64, datë 05.10.2023 “Për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie)”
 65. Urdhër nr.65, datë 16.10.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe firmës për çështje që lidhen me Bashkinë Gramsh”
 66. Urdhër nr.66, datë 26.10.2023 “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Z. Mustafa Turku”
 67. Thirrje nr.67, datë 26.10.2023 “Për mbledhjen e prokurorëve”
 68. Urdhër nr.68, datë 31.10.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.2, datë 06.01.2022 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)”
 69. Urdhër nr.69, datë 01.11.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
 70. Urdhër nr.70, datë 13.11.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit Mustafa Turku”
 71. Urdhër nr.71, datë 14.11.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.112, datë 28.10.2021 në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme (i ndryshuar)”
 72. Urdhër nr.72, datë 23.11.2023 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.2, datë 06.01.2022 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” (i ndryshuar)”
 73. Thirrje nr.73, datë 23.11.2023 “Për mbledhjen e prokurorëve”
 74. Urdhër nr.74, datë 06.12.2023 “Për inventarizimin e vlerave materiale dhe monetare për vitin 2023”
 75. Urdhër nr.75, datë 18.12.2023 “Mbi procedurat e dorëzimit të dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori Z. Hektor Mushi”
 76. Urdhër nr.76, datë 20.12.2023 “Për përjashtimin nga shorti të prokurorit Xh.Seferi”
 77. Urdhër nr.77, datë 27.12.2023 “Për trajtimin e materialeve të prokurorit Hektor Mushi”

78. Urdhër nr.78, datë 27.12.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe hartimin e analizës së punës për vitin 2023”

1.4 INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ

Në shkresën nr.7817/1 prot., datë 31.07.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë është dërguar në PP informacion mbi zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të RSH.

Kuvendi i RSH më datë 06.07.2023 ka miratuar Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2022”, të cilat i’ a ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm.

Mbi bazën e kësaj rezulote, nga ana e PP është nxjerrë Urdhëri nr.103, dt. 25.07.2023 “Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022” të Prokurorit të Përgjithshëm, urdhër që i është shpërndarë për njohje trupës së prokurorëve të kësaj prokurorie.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë ndërmarrë këto masa :

- 1. Urdhër nr.56, datë 31.07.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022”.*

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 21 dhe 42, shkronja “a” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjit nr.7895, dt.27.01.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Rezolutës së dt.06.07.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2022”, si dhe Urdhërit nr.103, dt. 25.07.2023 “Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022” të Prokurorit të Përgjithshëm:

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është marrë vendimi për Miratimin e Planit të Veprimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Drejtuesi i Prokurorisë, periodikisht çdo 3 (tre) muaj, dhe sa herë kërkohet, si dhe nëpërmjet raportit vjetor mbi ecurinë e punës së prokurorisë, informon Prokurorin e Përgjithshëm, për masat administrative dhe procedurale të marra për zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit, të shoqëruar me tregues statistikorë të saktë dhe analitik dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arritjet e problematikat, si dhe me vlerësimin si ka ndikuar zbatimi i kërkesave të rezolutës mbi gjendjen e kriminalitetit dhe performancën e prokurorisë.

Me qëllim për të unifikuar ndjekjen dhe zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2022” në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në kompetencë lëndore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me objektiv përcaktimin e masave administrative dhe procedurale që duhet

të merren për realizimin e përparësive që sigurojnë zbatimin është hartuar ky plan veprimi, me objektiva dhe afate të qarta :

1. Të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke i'u kërkuar prokurorëve që në rastet që ata mund të marrin dijeni nga media apo informacionet që ata mund të administrojnë për shkak të funksionit, të tregohen sa më aktivë për fillimin kryesisht të hetimeve. Afati : brenda 3 muajve.

2. Të zhvillohen aktivitete të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese të perfshira, mbi gjurmimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave në bashkëpunim me projektet/misionet ndërkombetare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale. Afati : në vijim.

3. Të forcohen kapacitetet institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre, për të shmangur efektet e krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke bashkërenduar dhe koordinuar përpjekjet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magistrat/prokuror sipas rregullave të përcaktuara në ligj, si dhe të kërkohej pranë Prokurorisë së Përgjithshme rritja e numrit të punonjësve të administratës sipas rregullave të përcaktuara në ligj. Afati : Në vijim.

4. Drejtuesi i Prokurorisë të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, duke u fokusuar kryesisht në procedimet penale që kanë të bëjnë me veprat penale prioritare të rekomanduara apo edhe me subjektet e rekomanduara, me qëllim dhënien përparësi hetimeve diligjente dhe pro-aktive për këto procedime penale. Afati : në vijim.

5. Deri në nxjerrjen e një udhëzimi të përgjithshëm nga Prokurori i Përgjithshëm për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në prokurori, duke pasur parasysh të dhënat e administruara në “Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale”, ngarkesën e punës në prokurori, mirëfunksionimin e punës në prokurori dhe shpërndatjen e drejtë të çështjeve, mbi bazën e kritereve transparente, numrin dhe specializimin e prokurorëve, përhapjen dhe kategorinë e veprave penale në territorin në juridiksion të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nevojën për konsolidimin e politikës penale, si dhe organikën aktuale dhe faktike të prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, brenda muajit janar 2024 të bëhet një riorganizim i ri i seksioneve të prokurorisë. Afati : brenda muajit janar 2024.

6. Të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/oficerët e Policisë Gjyqësore të kësaj prokurorie lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe më pas të organizohen trajnime të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve duke ia paraqitur këto shqetësime Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shkollës së Magistraturës për të mundësuar trajtimin e tyre në programet e trajnimeve vazhduese. Afati : brenda muajit shtator.

7. Të kërkohej rritja e trajnimeve në lidhje me ndjekjen penale ndaj grupveprave të trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, si dhe për mbrojtjen e viktimave dhe në veçanti gratë dhe fëmijët. Afati : në vijim.

8. Të kërkohej nga Komisioni i Policisë Gjyqësore menaxhimi mbi baza ligjore dhe profesionale i karrierrës së policisë gjyqësore pasi konstatohen gjatë vitit 2022-2023 lëvizje të

shumta, të pa arsytura, të pa argumentuara, jo të studiuara dhe jo sistematike të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit duke krijuar pengesa, vështirësi dhe kaos në veprimtarinë e prokurorisë. Afati : në vijim.

9. Të identifikohen problemet dhe të merren masa konkrete për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CAMS), PRESTO dhe sistemit SVHOPGJP, duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e IT-së dhe Drejtorinë Ekonomike dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme. Të nxiten oficerët dhe prokurorët në përdorimin dhe funksionimin e sistemeve si dhe të kontrollohen me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive sipas ligjit. Afati : në vijim.

10. Nga prokurorët e kësaj prokurorie të rritet numri i referimeve për procedime disiplinore mbi oficerët e policisë gjyqësore, të seksionit ose shërbimeve, të cilët konstatohen që me veprimet ose mosveprimet e tyre sjellin pasoja mbi procedimet penale që kanë në ndjekje. Afati : në vijim.

11. Prokurorët e kësaj prokurorie të jenë aktivë dhe aplikimin e masave të sigurisë me natyrë ndaluese mbi personat zyrtarë publik mbi të cilët ka dyshime për kundërligjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre. Afati : në vijim.

12. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie kujdesen për të garantuar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve, forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut në proces penal si dhe për të ndërtuar një ndjekje penale efektive ndaj krimit të organizuar, korrupsionit si dhe ndaj veprave penale dhe subjekteve prioritare të rekomanduara. Afati : në vijim.

13. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë marrjen e masave të nevojshme procedurale për të siguruar rritjen e gjykimeve të posaçme, të tilla si gjykimet me marrëveshje dhe aplikimin e urdhërave penale si dhe të gjykimeve të drejtpërdrejta. Afati : në vijim.

14. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë rritjen në aplikimin e masave të shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit në konflikt me ligjin si dhe të masave alternative të dënimit penal me burg. Afati : në vijim.

15. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale përsa i takon masave të sigurimit personal dhe llojeve dhe masave të dënimit ndaj të pandehurve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimeve kibernetike, krimet seksuale, krimet e rënda, trafiqet e paligjshme dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.

16. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave ndaj pasurisë me burim kriminal sipas kriterëve të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.10192/2009 si dhe rrisin kujdesin e nevojshëm për ndjekje penale efektive të rasteve të pastrimit të produkteve të veprës penale. Të realizohen të paktën 2 sekuestime asetesh me prejardhje të dyshuar kriminale. Afati : brenda muajit dhjetor 2022.

17. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie marrin masat e nevojshme për të forcuar kontrollin dhe drejtimin ndaj policisë gjyqësore në hetimin e çështjeve penale si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive për oficerët e policisë gjyqësore që me veprimtarinë e tyre sjellin pasoja në ndjekjen penale. Afati : në vijim.

18. Drejtuesi i Prokurorisë dhe Drejtuesit e Seksioneve merr masat e nevojshme për të koordinuar punën hetimore me institucionet e tjera që kanë në varësi struktura që ushtrojnë atributet e policisë gjyqësore, veçanërisht me policinë e shtetit, strukturat e hetimit tatimor, doganor etj. Afati : në vijim.

19. Drejtuesi i Prokurorisë vlerëson ngritjen dhe krijimin e grupeve hetimore për çështje penale dhe hetimeve komplekse. Afati : në vijim.
20. Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin me dilijencë dhe në afat plotësimin e kërkesave nga autoritetet e huaja për ndihmë juridike në fushën penale. Afati : në vijim.
21. Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme administrative për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Afati : në vijim.
22. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ndjekjen me dilijencë dhe përparësi, kur është rasti edhe me metoda speciale hetimi dhe në bashkëpunim të ngushtë me policinë e shtetit, procedimet penale për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, krimet e rënda, trafiket e paligjshme, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.
23. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin, në rastet e procedimeve penale ndaj vepra penale prioritare të rekomanduara, të metodave speciale të hetimit dhe mjeteve për kërkimin e provës të tilla si përgjime të telekomunikimeve, përgjime dhe vëzhgime ambjentale në vende private dhe publike, veprime simuluese, lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me bashkëpunëtorin e drejtësisë, kontrollet e vendeve, sekuestrimet e të dhënave bankare, elektronike etj. Afati : në vijim dhe dinamikë.
24. Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin aktivisht zbatimin nga policia gjyqësore të udhëzimeve të përgjithshme nr.5/2018, 3/2019, 10/2020, 17/2020, 9/2021, 2/2023 e vijues, si pjesë e mekanizmit për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga oficerët e policisë gjyqësore. Afati : në vijim.
25. Prokurorët e kësaj prokurorie, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët për subjektet me status të posaçëm zbatojnë në mënyrë rigorozë detyrimet ligjore dhe nënligjore për asistencën ndaj të miturve në konflikt me ligjin, viktimat ose dëshmitarë si dhe në rastet e veprave penale të dhunës në familje apo të dhunës me bazë gjinore. Afati : në vijim.
26. Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët e Seksionit nr.3, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët për subjektet me status të posaçëm vijnë të zbatojnë marrëveshjet e bashkëpunimit me Forumin e Gruas Elbasan, Shoqatën TjetërVizion, Ndihma e Eälheim për Shqipërinë dhe subjekte të tjera të shoqërisë civile sipas objektit të marrëveshjeve përkatëse në fokus të miturit, dhunën në familje, rehabilitimin e viktimave dhe autorëve të dhunës në familje etj. Afati : në vijim.
27. Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët për subjektet me status të posaçëm vijnë të zbatojnë marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë Elbasan, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Peqin, Belsh dhe Prrenjas sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për veprimin e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Koordinatorët për Dhunën me qëllim garantimin e ndihmës ligjore, psikologjike dhe sociale për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat ose dëshmitarë si dhe dhunuesit dhe viktimat e dhunës në familje. Afati : në vijim.
28. Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët për subjektet me status të posaçëm vijnë të zbatojnë marrëveshjet e bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan sipas marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit. Afati : në vijim.

29. Drejtuesi i Prokurorisë vijon të angazhohet aktivisht në veprimtaritë në kuadër të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, Trekëndëshit të Sigurisë, Mekanizimit Referues të Dhunës në Familje, me qëllim zhvillimin e mbledhjeve ndëraktoriale periodike dhe të forumeve të llogaridhënies publike në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së organit të prokurorisë, rritjes së besimit të publikut, forcimit të përgjegjshmërisë dhe krijimin e një klime ndërveprimi me të gjithë aktorët dhe faktorët lokal, publik dhe privat. Afati : në vijim.

30. Drejtuesi i Prokurorisë, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët për subjektet me status të posaçëm vijojnë të zhvillojnë takime periodike me stafet pedagogjike, të rinjtë në shkolla, oficerët e sigurisë, punonjësit social në shkolla si dhe me OJF në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të të rinjve për raportimin e krimit si dhe për forcim të bashkëpunimit në kuadër të plotësimit të detyrimeve për parandalimin dhe ndërveprimin në rastet e kriminalitetit të të rinjve. Afati : në vijim.

31. Prokurorët e kësaj prokurorie nxitren të përdorin maksimalisht të dhënat elektronike të garantuara dhe siguruara nga sistemet elektronike në të cilat kanë akses si e-albania, regjistri notarial, regjistri i pasurive të paluajtshme, të dhënat e gjendjes civile, të dhënat tatimore, sistemin TIMS, të dhënat e gjendjes gjyqësore etj duke garantuar përdorimin e tyre vetëm konform ligjit dhe për qëllime të ndjekjes penale. Afati : në vijim.

32. Drejtuesi i Prokurorisë vijon bashkëpunimin me ILD për kryerjen e inspektimeve tematike dhe të atyre për shkelje individuale të magjistratëve. Afati : në vijim.

33. Drejtuesi i Prokurorisë vijon bashkëpunimin me KLP për plotësimin e vakancave në organikën e prokurorëve si dhe kërkon nga PP forcimin e kapaciteteve administrative të burimeve njerëzore të nëpunësve publik dhe administrative të prokurorisë. Afati : në vijim.

34. Drejtuesi i Prokurorisë vijon kërkesat drejtuar PP mbi arsytet e shkurtimeve të numrit të prokurorëve gjatë vitit 2023 nga 25 në 20 të tillë dhe vijon me kërkesën për ri përcaktimin e numrit prej 25 prokurorësh në këtë prokurori. Afati : në vijim.

35. Drejtuesi i Prokurorisë vijon të kërkojë nga PP plotësimin e kushteve minimale të punës përsa i takon infrastrukturës në drejtim të investimit për një pajisje të re kondicionimi në godinën e prokurorisë si dhe për investime të tjera në arkivë, në sigurinë fizike të institucionit etj. Afati : në vijim.

1.5 INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Në shkresën nr. 5255 prot., datë 26.05.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë është dërguar në PP informacion mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit në vitin 2022.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.226, datë 13.04.2023 ka miratuar rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2023, të cilat i'a ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm.

Mbi bazën e këtij vendimi, nga ana e PP është nxjerrë Udhëzimi i Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 si dhe Urdhëri nr.70, datë 12.05.2023, të cilat së bashku me Rekomandimet Prioritare të KM për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2023, i janë shpërndarë për njohje trupës së prokurorëve të kësaj prokurorie.

Më datë 25.05.2023, në zbatim të thirrjes nr.34, datë 22.05.2023, është organizuar mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbledhje e cila është organizuar nga Drejtuesi më datë 25.05.2023.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë ndërmarrë këto masa :

1. *Thirrje nr.34, dt.22.05.2023 “Për mbledhjen e prokurorëve”.*
2. *Udhëzim i Përgjithshëm nr.35, datë 26.05.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.*
3. *Urdhër nr.36, datë 26.05.2023 i Drejtuesit të Prokurorisë “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” të Prokurorit të Përgjithshëm”, shoqëruar me planin e veprimit.*

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.226, datë 13.04.2023 ka miratuar rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2023, të cilat i’a ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm.

Mbi bazën e këtij vendimi, nga ana e PP është nxjerrë Udhëzimi i Përgjithshëm nr.02, datë 12.05.2023 si dhe Urdhëri nr.70, datë 12.05.2023, të cilat së bashku me Rekomandimet Prioritare të KM për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2023, i janë shpërndarë për njohje trupës së prokurorëve të kësaj prokurorie.

Më datë 25.05.2023, në zbatim të thirrjes nr.34, datë 22.05.2023, është organizuar mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Me qëllim forcimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është e nevojshëm të miratohet një udhëzim i përgjithshëm në funksion të unifikimit të ndjekjes penale efektive dhe zbatimit të një politike penale unitare, pa cënuar pavarësinë substanciale dhe funksionale të prokurorëve në hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit.

Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndjekin me diligençë zbatimin dhe vlerësojnë masat e nevojshme për të mundur përmbushjen e rekomandimeve prioritare për zbatimin e politikës në luftë kundër krimit sipas drejtimeve të rekomanduara dhe për veprat penale prioritare të rekomanduara, në përputhje me përcaktimet e dhëna në VKM nr.226/2023.

Drejtuesi i Prokurorisë miraton një plan veprimi për përmbushjen e rekomandimeve prioritare në luftë ndaj kriminalitetit për vitin 2023 të dhëna në VKM nr.226, datë 13.04.2023 si dhe një plan veprimi për ndjekjen e rekomandimeve të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të RSH për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë.

Drejtuesi i Prokurorisë nxjerr, konform ligjit, udhëzime jo të detyrueshme për çështje penale konkrete për rastet e hetimit të veprave penale prioritare dhe/ose ndaj subjekteve të rekomanduara.

Drejtuesi i Prokurorisë merr të gjitha masat e nevojshme procedurale dhe administrative për të mundësuar zbatimin rekomandimeve prioritare në përputhje me treguesit e gjendjes së kriminalitetit dhe specifikat e çështjeve penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Prokurorët vlerësojnë në çdo rast masat që duhet të marrin në zbatimin e rekomandimeve prioritare, duke treguar dilijencës e duhur në ushtrimin efektiv të ndjekjes penale dhe duke ruajtur pavarësinë e tyre funksionale nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimarrjen e tyre.

Prokurorët e kësaj prokurorie fokusohen në kryerjen e hetimeve të gjithanëshme për veprat penale dhe ndaj subjekteve prioritare të rekomanduara, duhet të rrisin kujdesin e nevojshëm për hetime pro-aktive, të konsiderojnë fillimin e hetimeve penale kryesisht, respektojnë të drejtat e palëve në proces si dhe garantojnë procesin e rregullt ligjor si dhe zbatojnë një politikë penale sipas rekomandimeve të dhëna.

Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie kujdesen për të garantuar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut në proces penal si dhe për të ndërtuar një ndjekje penale efektive ndaj krimit të organizuar, korrupsionit si dhe ndaj veprave penale dhe subjekteve prioritare të rekomanduara.

Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie kujdesen për të garantuar pavarësinë në vendimarrjen e tyre nga çdo ndërhyrje e paligjshme, duke siguruar zbatimin e kërkesave të ligjit si dhe duke reaguar proceduralisht në rastet e konstatimit të ndërhyrjeve të paligjshme.

Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie tregojnë dilijencën e duhur për të pasur një bashkëpunim korrekt dhe në kohë reale me strukturën e posaçme SPAK për fakte që vihen në dijeni të cilat përfshihen brenda sferës së veprimit dhe kompetencës hetimore të kësaj strukture.

Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie tregojnë dilijencën e duhur për të iniciuar kryesisht dhe rritur numrin e hetimeve pasurore përsa i takon hetimit dhe gjurmimit të pasurive të dyshuara me burim kriminal, për plotësimin e rekomandimeve të Moneyval, duke utilizuar edhe bashkëpunimin rajonal si dhe me Eurojust.

Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë marrjen e masave të nevojshme procedurale për të siguruar rritjen e gjykimeve të posaçme, të tilla si gjykimet me marrëveshje dhe aplikimin e urdhërave penale si dhe të gjykimeve të drejtpërdrejta.

Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave të shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit në konflikt me ligjin si dhe të masave alternative të dënimit penal me burg. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale përsa i takon masave të sigurimit personal dhe llojeve dhe masave të dënimit ndaj të pandehurve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale, krimet e rënda, trafiket e paligjshme, krimet mjedisore, abuzimet me të mitur, krimeve kibernetike dhe veprat e tjera penale të rekomanduara.

Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale, forcimin e dilijencës në hetime dhe rritjen e vëmëndjes në hetimin dhe gjykimin e efektiv të krimeve zgjedhore, rrisin bashkëpunimin e shërbimet e policisë gjyqësore në institucione të tjera.

Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë aplikimin e masave ndaj pasurisë me burim kriminal sipas kriterëve të K.Pr.Penale dhe ligjit nr.10192/2009 si dhe rrisin kujdesin e nevojshëm për ndjekje penale efektive të rasteve të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Drejtuesi i Prokurorisë merr masa për të garantuar mirëfunksionimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve CAMS dhe sistemin PRESTO.

Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie marrin masat e nevojshme për të forcuar kontrollin dhe drejtimin ndaj policisë gjyqësore në hetimin e çështjeve penale si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive për oficerët e policisë gjyqësore që me veprimtarinë e tyre sjellin pasoja në ndjekjen penale.

Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme për të koordinuar punën hetimore me institucionet e tjera që kanë në varësi struktura që ushtrojnë atributet e policisë gjyqësore, veçanërisht me policinë e shtetit, strukturat e hetimit tatimor, doganor etj.

Drejtuesi i Prokurorisë vlerëson ngritjen dhe krijimin e grupeve hetimore për çështje penale dhe hetimeve komplekse.

Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin, sipas ligjit, udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të rekomandimeve prioritare për ndjekjen penale efektive ndaj kriminalitetit për vitin 2023.

Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin me dilijencë dhe në afat plotësimin e kërkesave nga autoritetet e huaja për ndihmë juridike në fushën penale.

Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme administrative për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Zv.Drejtuesi i Prokurorisë dhe Kancelarja janë përgjegjës për raportimin periodik dhe sa herë kërkohet në PP për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftë ndaj kriminalitetit.

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 21 dhe 42, shkronja “a” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjit nr.7895, dt.27.01.1995 “Kodi Penal”, i ndryshuar, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, si dhe Urdhërit nr.70 dt. 12.05.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” të Prokurorit të Përgjithshëm:

Me urdhër të Drejtuesit të Prokurorisë është vendosur për Miratimin e Planit të Veprimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”.

Drejtuesi i prokurorisë, periodikisht çdo 3 (tre) muaj, dhe sa herë kërkohet, si dhe nëpërmjet raportit vjetor mbi ecurinë e punës së prokurorisë, informon Prokurorin e Përgjithshëm, për masat administrative dhe procedurale të marra për zbatimin e kërkesave të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave, të shoqëruar me tregues statistikorë të saktë dhe analitik dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arritjet e problematikat, si dhe me vlerësimin si ka ndikuar zbatimi i kërkesave të rezolutës mbi gjendjen e kriminalitetit dhe performancën e prokurorisë.

Me qëllim për të unifikuar ndjekjen dhe zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, në kompetencë lëndore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me objektiv përcaktimin e masave administrative dhe procedurale që duhet të merren për realizimin e përparësive që sigurojnë zbatimin, është hartuar ky plan veprimi.

1.6 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE DHE INTERESAVE TË LIGJSHME TË SHTETASVE NË PROCESIN PENAL

Në lidhje me këtë çështje objektivat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kanë qenë:

-Rritje e numrit të rasteve të zbatimit të urdhrimit penal, marrëveshjes dhe gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim përmirësimin e efikasitetit të hetimit dhe uljes së normës së kohëzgjatjes mesatare të hetimit të çështjeve;

-Rritje të kërkesave për dhënien e dënimeve alternative për autorë dhe vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore;

-Rritje të numrit të masave alternative që synojnë shmangien e të miturit autor të veprës penale nga procedimi penal;

-Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;

-Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale për rastet me të mitur dëshmitar dhe viktimë të veprës penale;

-Ashpërsim të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit të fëmijëve;

-Hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

-Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve me fokus specializimin dhe krijimin e profesionistëve që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Politika që ka ndjekur kjo prokurori për vitin 2023, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre, për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Si autoritet përgjegjës për garantimin e të drejtave të të pandehurve dhe të viktimës gjatë fazës së hetimeve paraprake, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë treguar kujdes në njohjen e tyre me të drejtat që ata gëzojnë, mbështetur në dispozitat procedurale penale dhe angazhimin pozitiv për të mundësuar realizimin e këtyre të drejtave.

Viktimat dhe të pandehurit janë njohur me të drejtat e tyre, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, si dhe në përfundim të hetimeve gjithashtu u është vënë në dispozicion kopje e akteve vendimmarrëse duke i bërë të ditur të drejtën e ankimit. Në rastet kur viktimë ka ndërruar jetë, janë bërë përpjekje për të gjetur dhe njoftuar trashëgimtarët e tyre.

Në rastet që qytetarët apo subjektet e tjera, kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, apo edhe kur vetë prokurorët kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e tyre, nga ushtrimi i ndjekjes penale në çështje të caktuara, nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, është proceduar me marrjen e vendimeve përkatëse, në respektim të dispozitave procedurale penale, neni 16 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

Përgjithësisht nga ana e viktimave apo edhe të pandehurve, të drejtat që janë ushtruar kanë pasur të bëjnë me kërkesat që i kanë drejtuar organit procedues për të marrë informacion në lidhje me procedimet penale ku janë të përfshirë si palë, për të kërkuar kryerje veprimesh hetimore shtesë e të tjera. Nga ana e prokurorëve është ndjekur praktika e dhënies përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të parashtruara, duke u marrë edhe vendimet përkatëse mbi kërkesat e palëve.

Në respektim edhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, qytetarëve apo subjekteve të ndryshme, iu është dhënë përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të tyre. Në dhënien e informacioneve, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është mbajtur parasysh ruajtja e sekretit hetimor apo atij shtetëror. Për realizimin e këtyre momenteve, ka qenë e rëndësishme koordinimi i punës mes zyrës së marrëdhënieve me publikun, me prokurorin e çështjes.

Gjatë këtij procesi nga ana e kësaj prokurorie, janë respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke ruajtur të dhënat personale, duke pasur parasysh të drejtën për jetë private.

Përsa i përket pretendimeve të ndryshme nga qytetarët në letra të shkruara prej tyre, përgjithësisht është ndjekur si procedurë, thirrja e qytetarëve në rastet kur prej tyre ka pasur pretendime për ekzistencën e ndonjë veprë penale, dhe marrja e kallzimit penal nga oficeri i policisë gjyqësore sipas grafikut të gatishmërisë, në ditët e ardhjes së letrës apo në rast ngarkese të këtij të fundit, kallzimi penal është marrë nga një oficer tjetër i policisë gjyqësore i kësaj prokurorie. Thirrja e qytetarëve për të parashtruar pretendimet e veta në formën e kallzimit kur kanë pasur pretendime për vepra penale, është bërë mbështetur në respektimin e dispozitave proceduriale penale, neni 283 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

1.6.1 FORCIMI I RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

1. Nga prokurorët duhet të synohet shtimi i numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjyqimit të drejtperdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve. Afati : në vijim.

2. Do të synohet nxitja e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore. Afati : në vijim.

3. Do të vijojë ashpersimi i masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve. Afati : në vijim.

4. Do të synohet rritja e cilësisë së hetimeve dhe ashpersimi i politikës penale për autorët e veprës penale të dhunës në familje. Afati : në vijim.

5. Nga prokurorët e kësaj prokurorie të rritet numri i referimeve për procedime disiplinore mbi oficerët e policisë gjyqësore, të seksionit ose shërbimeve, të cilët konstatohen që me veprimet ose mosveprimet e tyre sjellin pasoja mbi procedimet penale që kanë në ndjekje. Afati : në vijim.

6. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë marrjen e masave të nevojshme procedurale për të siguruar rritjen e gjykimeve të posaçme, të tilla si gjykimet me marrëveshje dhe aplikimin e urdhërave penale si dhe të gjykimeve të drejtpërdrejta. Afati : në vijim.

7. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë rritjen në aplikimin e masave të shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit në konflikt me ligjin si dhe të masave alternative të dënimit penal me burg. Afati : në vijim.

8. Prokurorët e kësaj prokurorie vlerësojnë ashpërsimin e politikës penale përsa i takon masave të sigurimit personal dhe llojeve dhe masave të dënimit ndaj të pandehurve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, krimet seksuale, krimet e rënda, trafiket e paligjshme dhe veprat e tjera penale të rekomanduara. Afati : në vijim.

1.7 GRUPET VULNERABËL, TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN, DËSHMITARË DHE VIKTIMA TË VEPRËS PENALE

Politika që ka ndjekur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për vitin 2023, ka pasur në fokus kryesor të miturit si dhe viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të gjinisë së tyre.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar funksionimi i Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me të pandehur dhe viktimat e mitur, dhunës në familje si dhe për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

Prokurorët e caktuar në këto seksione, përgjatë vitit 2023 kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës apo institucione të tjera me objekt të miturit dhe dhunën në bazë gjinore. Njohuritë e përftuara në këtë drejtim, janë munduar t'i zbatojnë në punën e tyre të përditshme dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm me organizmat e ndryshëm shtetërorë, lokale, qendrore apo shoqatat jo fitim prurëse. Vazhdon të ushtrojë kompetencat e saj Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm, roli i së cilës ka në fokus të miturit në konflikt me ligjin, viktimat e mitur, subjektet e dhunës me bazë gjinore, si dhe personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike

Për ti ardhur sa më shumë në ndihmë Prokuroria ka zbatuar marrëveshjet e bashkëpunimit ku janë referuar për ndihmë viktimat apo dhe të miturit në konflikt me ligjin për të cilët është parë e nevojshme që duhet të punohet nga shërbim psiko - social për problemet në sjelljen e tyre. Është respektuar me rigorozitet Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur gjatë dhënies së deklaratave të të miturve, apo dhe viktimave të veprave penale. Gjithashu është bërë i mundur aplikimi i drejtësisë restauruese duke aplikuar shmangien nga ndjekja penale për të mitur, tek rastet në të cilat prokurori e ka parë të arsyeshme.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”, për qarkun e Elbasanit, janë caktuar psikologe vlerësuese dhe asistuese. Duke pasur parasysh numrin e çështjeve, ku përveç pranisë së detyrueshme në rastet me të dëmtuar apo autorë të mitur, vlerësohet prania e psikologut edhe në çështjet e dhunës me bazë gjinore, si dhe shtrirjes territoriale që ka qarku i Elbasanit, do të ishte me vend rritja e numrit të psikologëve. Puna që kryen kjo prokurori, në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të tyre, ka si fokus kryesor shmangien e riviktimizimit apo viktimizimit të përsëritur dhe bashkërendimin me gjithë aktorët e tjerë, me qëllim sigurimin e mundësive viktimave për të venë në vend të drejtat e tyre dhe për t'u rehabilituar.

Në zbatim të Urdhërit nr. 53 prot datë 05.07.2018 ``Për caktimin e personit të kontaktit për komunikimet me organizmat e ndryshme në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore si dhe të specialistit që do të jetë pjesë e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor``, mbështetur në VKM nr. 334 datë 17.02.2011 ``Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij``, në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura si më sipër, vazhdon punën personi i caktuar si person kontakti, të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura, si dhe përgjegjës për dhënien rrugë përgjigjeve të nevojshme, si pikë kontakti në Ekipin Teknik Ndërdisciplinor.

1.8 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE ZBATIMI I AKTEVE/MARRËVESHJEVE

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur raporte korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural, ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse dhe atij organik për prokurorinë Shqiptare. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

- Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
- Strukturat e policisë së shtetit dhe institucionet e tjera që kanë shërbime të policisë gjyqësore, për bashkëpunimin që lidhet me fazën e hetimit paraprak të procedimeve.
- Me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykim, me paraqitjet në seancat paraprake si në rastet e kërkesave për pushim, ashtu edhe në ato për gjykim.
- Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuar, me njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm.
- Me institucione të tjera në nivel qendror dhe lokal.

1. Nga prokurorët duhet të punohet për konsolidimin e bashkëpunimit nëpërmjet nxitjes për shkëmbim të të dhënave, kryerjes së analizave të përbashkëta për rastet e referuara, shkëmbimit dhe kërkimit të ekspertizës, krijimin e procedurave standarde hetimore me të gjitha agjencite ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe lehtësimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e pastrimit të parave, pastrimit të të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit. Afati : në vijim.

2.Do të synohet forcimi i efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiscal ose doganor, por edhe nëpunësve publike të administratës tatimore dhe asaj doganore, nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat përkatëse tatimore dhe doganore, apo agjensi të tjera ligjzbatuese. Afati : në vijim.

3.Do të synohet forcimi i kapaciteteve të seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimet pasurore me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtyre seksioneve. Afati : brenda muajit dhejtor 2023.

4. Do të synohet që të përfshihen në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore oficerët e shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre, në respektim të parimit për të caktuar si OPGJ oficerin e strukturës referuese. Afati : në vijim.
5. Duhet të synohet zhvillimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të ligjshmerisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave, veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik. Afati : në vijim.
6. Të kërkohet nga Komisioni i Policisë Gjyqësore menaxhimi mbi baza ligjore dhe profesionale i karrierës së policisë gjyqësore pasi konstatohen gjatë vitit 2023 lëvizje të shumta, të pa arsyetura, të pa argumentuara, jo të studiuara dhe jo sistematike të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit duke krijuar pengesa, vështirësi dhe kaos në veprimtarinë e prokurorisë. Afati : në vijim.
7. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie marrin masat e nevojshme për të forcuar kontrollin dhe drejtimin ndaj policisë gjyqësore në hetimin e çështjeve penale si dhe për nxjerrjen e përgjegjësive për oficerët e policisë gjyqësore që me veprimtarinë e tyre sjellin pasojë në ndjekjen penale. Afati : në vijim.
8. Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme për të koordinuar punën hetimore me institucionet e tjera që kanë në varësi strukturat që ushtrojnë atributet e policisë gjyqësore, veçanërisht me policinë e shtetit, strukturat e hetimit tatimor, doganor etj. Afati : në vijim.
9. Prokurorët e kësaj prokurorie ndjekin me dilijencë dhe në afat plotësimin e kërkesave nga autoritetet e huaja për ndihmë juridike në fushën penale. Afati : në vijim.
10. Drejtuesi i Prokurorisë merr masat e nevojshme administrative për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Afati : në vijim.
11. Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët e kësaj prokurorie tregojnë dilijencën e duhur për të pasur një bashkëpunim korrekt dhe në kohë reale me strukturën e posaçme SPAK për fakte që vihen në dijeni të cilat përfshihen brenda sferës së veprimit dhe kompetencës hetimore të kësaj strukture. Afati : në vijim.

1.8.1 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL ME POLICINË E SHTETIT

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vijuar në mënyrë rigorozë të përmbushë detyrimet ligjore përsa i takon ushtrimit të kompetencave ligjore në kryerjen e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim. Në këtë kuptim kemi vijuar bashkëpunimin e ngushtë, të gjithëanshëm dhe profesional me shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, komisariatet në varësi si dhe me strukturat drejtuese të kësaj drejtorie, veçanërisht me Drejtorin Z. Ilir Proda. Shërbimet e policisë gjyqësore në DVP Elbasan përgjithësisht kanë treguar gatishmëri për të kryer veprimet hetimore në mënyrë korrekte dhe me ndërgjegje profesionale. Nga ana e këtyre strukturave është ndërtuar një strategji e qartë komunikimi me prokurorët e gatshëm që në veprimet e para hetimore duke krijuar kështu mundësi që prokurori të ushtrojë funksionet e tij që në fillim të çështjes penale. Në mënyrë periodike janë zhvilluar takime dhe analiza pune.

➤ Me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit gjithashtu ka vijuar një bashkëpunim serioz, kryesisht në hetimin e ngjarjeve të rënda kriminale dhe nga ana e kësaj drejtorie janë vendosur në mënyrë të shpejtë në dispozicion të hetimit të gjitha strukturat në varësi të saj. Vlen të theksohet bashkëpunimi me Departamentin e Policisë Kriminale, Institutin e Policisë Shkencore, ZQK Interpol Tirana, Drejtorinë e Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit, Drejtorinë Anti-Terror etj.

1.8.2 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL ME GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan duke qënë të vetdijshëm për situatën e vështirë të shkaktuar nga mbingarkesa në punë e gjyqtarëve për shkak të mungesave të mëdha në organikën e gjykatës për një pjesë të vitit 2023 janë treguar korrekt dhe serioz në përmbushjen e detyrimeve ligjore në raport me pjesëmarrjen në gjykim. Në mënyrë që të garantohet procesi i rregullt ligjor nga ana jonë është treguar vazhdimisht dilijencë e duhur në raport me gjykatën. Po ashtu, edhe nga ana e gjyqtarëve kemi gjetur një gatishmëri për t'iu përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri ligjore kërkesave tona. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi që bashkërendimi me gjyqtarët e kësaj gjykate përgjatë vitit 2023 ka qënë në lartësinë e kërkuar të detyrës.

1.8.3 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL ME KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka përmbushur në mënyrë serioze dhe të plotë të gjitha detyrimet që lidhen me KLP, të tilla si dhënien e informacionit mbi verifikimet e nevojshme për personat që janë kërkuar të verifikohen nga KLP nëse kanë qënë apo jo në ndjekje penale, përcjelljen e të dhënave për ngarkesën në punë, përcjelljen e fashikujve të procedimeve penale të ndryshme etj.

1.8.4 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vijuar të përmbushë të gjitha detyrimet e saj në raport me Prokurorinë e Përgjithshme, ku veçanërisht duhet theksuar komunikimi tepër korrekt dhe profesional me dy struktura tepër të nevojshme në veprimtarinë procedurale si Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Sektori i Përgjimeve të Telekomunikacionit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative. Në tërësi stafi i këtyre strukturave është treguar korrekt, profesional dhe bashkëpunues me institucionin tonë, natyrisht nën frymën e përcjellë nga drejtuesit e këtyre strukturave Znj. Pranvera Pustina dhe Z. Thoma Jano. Nga ana tjetër edhe marrëdhënia me Drejtorinë e Koordinimit Institucional Z. Kosta Beluri dhe Sekretarin e Përgjithshëm Z. Luan Abazi për çështje të investimeve dhe ato financiare ka qënë bashkëpunuese dhe e ndërtuar mbi shina përgjegjshmërie profesionale.

1.8.5 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL ME KOMISIONIN E POLICISË GJYQËSORE

Me këtë organ ka munguar në mënyrë tërësore bashkëpunimi pavarësisht faktit se nga ana jonë janë përmbushur në mënyrë rigorozë dhe në afat të gjitha detyrimet që lidhen me këtë komision. Natyrisht që kjo sjellje nga pikëpamja administrative dhe institucionale jo vetëm krijon një imazh të papranueshëm për një institucion publik por edhe sjell një humbje tërësore të perceptimit pozitiv për një organ që duhet të luajë një rol crucial në administrimin e një prej shtyllave kryesore të sistemit prokurorial sot, policinë gjyqësore. Kaosi dhe amullia në transferimet dhe komandimet e pastuduara e oficerëve të policisë gjyqësore për dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan që ka vijuar edhe përgjatë vitit 2023, pa vënë në asnjë moment në dijeni drejtuesit dhe trupën e prokurorëve të kësaj prokurorie, procedimi disiplinor mbi oficerët e policisë gjyqësore të prokurorisë sonë pa sjellë qoftë edhe një shkresë të vetme në Prokurorinë e Elbasanit dhe situatat absurde me vlerësimet e oficerëve për vitin 2022 të krijuara me kthimin disa herë të vlerësimeve dhe në fund me dështimin e këtij komisioni për të kryer vlerësimin, tregon për standarte të dyfishta për raste të ngjashme, njëanëshmëri dhe mungesë serioziteti në zbatimin e ligjit.

1.8.6 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka realizuar në mënyrë periodike takime dhe analiza pune me shërbimet e policisë gjyqësore në institucione të tjera si me SHISH, Drejtorinë e SHKBB, Drejtorinë e AMP, Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DPT, Drejtorinë e Hetimit Doganor në DPD, Sektorin e Hetimit pranë Policisë Ushtarake. Po ashtu, takime pune periodike realizohen me përfaqësues dhe autoritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, drejtoritë e IEVP Peqin, Elbasan, Kosovë e Madhe dhe Degën Territoriale të Shërbimit të Provës Elbasan.

1.8.7 KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nën kujdesin e veçantë të Drejtuesit të Prokurorisë ka vijuar t'i kushtojë një vëmendje të veçantë pjesëmarrjes dhe angazhimit në KVSP Elbasan, sidomos përsa i takon axhendës së aktiviteteve të trekëndëshit të sigurisë Bashki-Polici-Prokurori. Modeli i ndërtuar në Elbasan ka gjetur një përkrahje të madhe nga opinioni publik në qark por edhe nga institucionet vendore dhe partnerët europian. Kështu takimet me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar dhe atë të OSCE, me përfaqësues të strukturave të OKB mbi ekstremizmin e dhunshëm, llogaridhëniet publike, publikimi i buletineve informative të KVSP, takimet me qytetarët, edukimi ligjor në institucione arsimore dhe tek të rinjtë, ditët e hapura për publikun, takimet periodike me përfaqësues të OSHC, me autoritete publike vendore dhe qendrore, me grupe të interesit qytetar, organizimi i konferencës solemne në ditën kombëtare të drejtësisë etj, janë një sërë aktiviteteve që jo vetëm rrisin besimin e publikut tek drejtësia por edhe na bëjnë më të përgjegjshëm për misionin qytetar dhe publik që kemi si autoritete ligjzbatuese.

1.8.8 MARRËVESHJET DHE REFERIMET PËR VITIN 2023

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për vitin 2023, përveçse luftimit të krimit ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çenime në të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Në mbështetje të VKM (të rishikuar) nr. 327 datë 02.06.2021 *``Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij``*, në këtë Prokurori kanë vazhduar të zbatohen Marrëveshjet me objekt koordinimi dhe bashkëpunimi për referimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit viktimë, si më poshtë:

1. Marrëveshje bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje (MKR) me Bashkinë Elbasan.
2. Marrëveshje bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje (MKR) me Bashkinë Belsh.
3. Marrëveshje bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje (MKR) me Bashkinë Peqin.
4. Marrëveshje bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje (MKR) me Bashkinë Gramsh.
5. Marrëveshje bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje (MKR) me Bashkinë Librazhd.
6. Marrëveshje bashkëpunimi për vijimin e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje (MKR) me Bashkinë Prrenjas.
7. Marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën *``Forumi i Gruas Elbasan``*
8. Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën *``Tjetër Vizion``*
9. Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën *``Ndihma e Eeilheim për Shqipërinë``*
10. Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën *``Në familje, për familjen``*
11. Marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve

Objekti i këtyre marrëveshjeve është koordinimi i punës dhe bashkëpunimi midis institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, për të adresuar rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes një mekanizmi referimi.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar të ushtrojë kompetencat e saj Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm, roli i së cilës ka në fokus të miturit në konflikt me ligjin, viktimat e mitur, subjektet e dhunës me bazë gjinore, si dhe personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike. Në kuadër të funksionimit të marrëveshjes dhe të ushtrimit të detyrave të Koordinatorit për Subjektet me Status të Posaçëm gjatë vitit 2023 dhe në kuadër të marrëveshjes lidhur ndërmjet Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shoqatave të lartpërmendura, gjatë vitit 2023 janë referuar **40** raste për mbështetje, (*ndryshe nga viti 2022 ku kishim 31 referime*). Ka pasur referime të shumta nga ne si organ procedues, ku një fokus të madh përveç viktimave të dhunës i është dhënë dhënë dhe burrave dhunues duke qenë se është një target grupi i cili ka nevojë për shumë ndërhyrje. Nga **40** raste të referuara, në **22** prej tyre është kërkuar ndihmë për gratë viktimë të dhunës në familje bashkë me fëmijët e tyre (*ndërsa gjatë vitit 2022 janë referuar 16 raste në total*), ku 19 janë referuar

në shoqatë ndërsa 3 në Drejtorinë e Shërbimit Social apo në Koordinatorën Vendore të Dhunës pranë Bashkisë si dhe **8** raste janë referuar me objekt “rehabilitim dhunuesi”. Ndërsa **2** referime të tjera janë bërë në Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit, të cilat mund ti quajmë raste suksesi pasi palët e përfshirë në konflikt kanë arritur të bisedojnë e të bien në dakordësi midis tyre për zgjidhjen e problemit.

Kontakte të vazhdueshme kemi patur me Koordinatorën Vendore të Dhunës në Familje dhe Nënpunësen Gjimore në Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashkinë Elbasan apo dhe Drejtorinë e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar për raste më specifike që kanë pasur nevojë për mbështetje. Kemi referuar **7** të mitur në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë përkatëse. Gjithashtu kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me shoqatën “Ndhima e Eeilheimit” për rastin e **1** të mituri viktimë të strehuar në shelterin e tyre.

Në kuadër të këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi kemi pasur kontakte lidhur me rastet për mbështetje psikologjike, sociale dhe edukative, seanca këshillimi, strehime në shelter, ndjekja e kurseve profesionale, ndihmë ligjore falas, bonuse qeraje, mundësi punësimi, etj. Komunikimi me qendrat me të cilat është nënshkruar marrëveshja është i vazhdueshëm jo vetëm për raste të cilat ne kemi referuar për mbështetje por dhe për çdo shkëmbim informacioni i cili ka qenë i nevojshëm për mbarëvajtjen e punës në lidhje me rastet e dhunës në familje apo të miturve viktimë.

Prokuroria Elbasan vazhdon të jetë pjesë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) në Bashkinë Elbasan ku është bërë ngritja e sekretariatit teknik për trekëndëshin Polici – Prokurori – Bashki, të cilët janë ndër aktorët kryesorë, për rritjen e transparencës, por edhe nxitjen e urave lidhëse të komunikimit midis të gjithë aktorëve, për të kontribuar në përpjekjet e "të gjithë shoqërisë" për të identifikuar, kuptuar dhe lehtësuar parandalimin e sjelljeve kriminale në komunitetet e tyre, si edhe në procesin e riintegritit të të dënuarve, pasi ata kanë kryer dënimin. Pjesë e këtyre takimeve është vetë Drejtuesi ose një person tjetër përgjegjës i caktuar prej tij. Prokuroria merr pjesë në mënyrë të vazhdueshme në takimet e ekipit teknik ndërdisiplinar me anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje, ku diskutohen raste specifike dhe ndihma që mund t'u ofrohet, dhe është treguar gjithmonë e hapur për bashkëpunim.

Dhe institucioni ynë në kuadër të sigurisë publike ka organizuar disa takime: Me rastin e 110 – vjetorit të Ditës së Drejtësisë Drejtuesi i Prokurorisë në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” organizuan një simpozium me temë “Sfidat e drejtësisë shqiptare nga Kanuni i Zhurisë deri tek reforma në drejtësi në kuadër të proceseve integruese”. Gjithashtu një takim me perfaqësuesit e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Qarkun Elbasan për të diskutuar sfidat me të cilat përballemi dhe si të përmirësojmë bashkëpunimin.

Kemi organizuar ditë të hapura në insitucion ku kemi pritur grupe nxënësish gjimnazistë, për tu njohur me funksionin e prokurorisë dhe për të diskutuar rreth të miturve në konflikt me ligjin dhe sjelljet që përbëjnë vepër penale, apo kemi qenë prezentë dhe nëpër shkolla ku kemi diskutuar për këto tema.

Në kuadër të ditëve të dhunës me bazë gjimore kemi përgatitur disa fletpalosje dhe një video sensibilizuese për të denoncuar dhunën, e cila u shfaq dhe si spot në mediat locale.

Kto takime kanë pasur për qëllim nxitjen e personave përgjegjës për të bërë referime në rastet e nevojshme dhe kanë qenë efektive pasi njerëzit arrijnë të njihen me shumë me funksionin e institucionit të prokurorisë, të krijojnë më shumë besim, të ndjehen më të sigurtë dhe të rinjtë

marrin informacion më të detajuar rreth sjelljeve që përbëjnë vepra penale, apo se si procedohet kur ata kryejnë një krim, duke i treguar pasojat dhe duke i nxitur të reflektojnë që të jenë të kujdesshëm në veprimet e tyre.

1.8.9 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Me qëllim bashkëpunimin e efektshëm në ushtrimin e ndjekjes penale apo marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, lidhur me veprat penale që kanë kryer shtetasit shqiptarë jashtë shtetit, apo shtetasit e huaj në qarkun e Elbasanit, nga ana e Prokurorisë Elbasan janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dy organet kompetente që mundësojnë ndërmjetësimin e bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar¹, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, specifikisht nga pala shqiptare në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

1.9 TË DHËNA LIDHUR ME TEMAT DHE TRAJNIMET E PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE

Pamvarsisht ngarkesës së lartë të procedimeve të hetuara nga prokurorët në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është gjetur kohë nga ana e tyre të ndjekin trajnimet vazhduese, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët si Euralius, Opat etj. Prokurorët e prokurorisë Elbasan gjatë vitit 2023 kanë marrë pjesë për trajnimet me tema: “Masat e sigurimit ndaj të miturit në konflikt me ligjin”, “Administrimi i prokurorisë dhe statistikat si mjete strategjike për përmisimin e performancës”, “Pavlefshmeria e akteve të procedurës penale dhe reforma e procedurës penale”, Kontrohet dhe sekuestrimet si mjete të kërkimit të provës”, Kufijtë e veprimtarisë/kopetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive”, “Mbi sistemin e-tracking PRESTO”, “Kundër Rrëmbimit apo heqjes së paligjshme të lirisë së personave dhe zvatjes” “Korrupsioni si vepër penale në sektorin publik dhe privat”, “Pameca”, “Rishikimi i vendimeve penale, risitë”, Llojet e masave të shmangjes ndaj të miturit”, “Afatet e paraburgimit, etj”, “Prova skencore në procesin penal, vlerësimi i provës”, “Regjistrimi i procedimit penal, urdheri për regjistrimin e emrit, etj”. Po kështu edhe oficerët e seksioneve kanë marrë pjesë në trajnime sipas tematikave përkatëse nga Shkolla e Magjistraturës.

¹ Të dhënat statistikore pasqyrohen në pikën përkatëse të këtij raporti

KREU 2 ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

1.1 VOLUMI I PUNËS NË HETIM


Përgjatë vitit 2023 nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është vendosur mosfillimi i procedimit penal, si dhe është ushtruar ndjekja penale për procedime penale të mbartura nga viti 2022, procedime penale të regjistruara të reja, procedime të rifilluara gjatë vitit 2023, si dhe ato të ardhura me moskompetencë si më poshtë vijon:

Nga 2212 materiale kallzues të regjistruara përgjatë vitit 2023 është vendosur mosfillimi për 598 materiale hetimore duke përfshirë (duke përfshirë dhe materiale të mbartura nga viti 2022) për 9 materiale kallzuese i kanë kaluar Prokurorive të tjera për kompetencë dhe 217 materiale janë mbartur për verifikim për vitin 2024.

Procedime penal për vitin 2023 hetuar në total 3202 procedime penale me 503 persona nën hetim, 755 të pandehur , 355




PROCEDIME PENALE TË HETUARA V.2023



me masë sigurimi arrest me burg prej të cilave 1490 procedime penale janë të reja, 321 persona nën hetim, 398 të pandehur dhe 261 të arrestuar (në këtë shifër përfshihen procedime penale të cilat janë bashkuar apo dhe ndarë gjatë këtij vitit si dhe 16 procedime penale të ardhura për kompetencë), 1699 procedime penale të mbartura, me 182 persona nën hetim, 357 të pandehur dhe 94 të arrestuar, si dhe 13 procedime penale të rifilluara².

Gjithashtu janë hetuar edhe 3 çështje të Kodit Penal Ushtarak të cilat 2 janë të mbartura nga viti i kaluar dhe 1 e regjistruar si çështje e re.



² Pjesën më të madhe e zënë procedimet penale për veprat penale që lidhen me falsifikimin e dokumentave.

Referuar të dhënave statistikore të ndara sipas krerëve të Kodit Penal, rezulton se janë regjistruar gjatë vitit 2023:

	Kreun II “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”	Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”	Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”	Kreun V-VII “Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”	Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”	Kreun IX “Vepra penale kundër drejtësisë”	Kreun X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”
Proc.Pen	247	566	44	0-1	579	50	3
Person nën hetim	49	79	8	0	173	8	4
pandehur	87	70	4	0	225	12	0
Arrest Burg	84	36	1	0	123	13	4

Nga të dhënat referuar Tabelës së mësipërme rezultojn se volumin më të madh të procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2023 e zënë veprat penale Kreut VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit” e pasuar nga ajo e kreut III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”.

Në lidhje me numrin e personave të cilët kanë qenë nën hetim e më pas marrë të pandehur numrin më të lartë të tyre e kemi në kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” ndërsa numrin më të ulët e gjejmë tek Kreun V i cili nuk ka të regjistruar asnjë procedim dhe si rrjedhojë asnjë autor.


Referuar materialeve kallëzuese të regjistruara përgjatë këtij viti gjithsej **2212 materiale**, pjesën më të madhe e zënë materialet e referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan dhe shërbimet e policisë gjyqësore të komisariateve të policisë që mbulojnë Qarkun e Elbasanit me **1809 referime**, të ndara si më poshtë Drejtoria e Policisë Elbasan referuar **650** materiale, Komisariati i Policisë Elbasan referuar **610** materiale, Komisariati i Policisë Librazhd referuar **221** materiaile, Komisariati i Policisë Cërrik **187** materiale, Komisariati i Policisë Gramsh referuar **80** materiale dhe Komisariati i Policisë Peqin referuar **61** materiale ndërsa 403 referime janë nga subjekte të tjera.



Nga të dhënat ndodhur në zyrën e regjistrit për vitin 2023 rezulton se materiale referuese kanë ardhur edhe nga subjekte të tjera, rreth 403 të referimeve në rang Qarku.

Konkretisht:

1. **37** materiale kallëzuese kanë ardhur nga Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm të Sistemit të Burgjeve;
2. **147** materiale janë referuar nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë Elbasan;
3. **3** materiale janë referuar nga Insektoriati I Mbrojtjes së Territorit Dega Elbasan;
4. **7** materiale janë referuar Agjensia e Mbikqyrjes Policore ;
5. **2** materiale kallëzuese janë referuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor;
6. **5** materiale janë referuar nga Ujësjiellës - Kanalizime Elbasan;
7. **26** materiale hetimore ka referuar Departamenti i Policisë Kriminale Tiranë ;
8. **5** materiale nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
9. **6** materiale janë filluar kryesisht me iniciativë të prokurorit;
10. **4** materiale Zyra Përbarimore Elbasan;
11. **16** procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga prokuroritë e rretheve apo Prokuroria e Posaçme;
12. **21** materiale referuara nga Bashkia Elbasan, Gramsh, Prrenjas;
13. Pjesa tjetër e materialeve referuese ka ardhur nga institucione të ndryshme.



Nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2023 janë referuar në total **2212 materiale** përkundrejt 2398 materiale kallëzuese të referuar gjatë vitit 2022.

Rezulton se përgjatë vitit 2023 kemi një ulje me 4% të materialeve të referuara në krahasim me një vit më parë, kjo dhe për faktin se gjatë vitit 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është krijuar regjistri i njoftimeve të viktimeve akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale ku janë regjistruar gjithsej 614 materiale, në kuadër të “Memorandumit të Mirëkuptimit”, nënshkruar nga Prokurori i

Referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale ku janë regjistruar gjithsej 614 materiale, në kuadër të “Memorandumit të Mirëkuptimit”, nënshkruar nga Prokurori i

Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, më datë 30.09.2020, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2021.

2.2 TË DHËNA MBI VENDIMET E MOSFILLIMEVE

Gjatë vitit 2023 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për **598** materiale hetimore, një numër më i ulët krahasuar me vitet e kaluara pasi është krijuar “Regjistri i njoftimeve të viktimave akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” në të cilin janë regjistruar 614 materiale.

2.2.1 TË DHËNA STATISTIKORE PËR VENDIMET E MOSFILLIMIT

Mosfillimet përkatësisht të ndara sipas krerëve të Kodit Penal:

1. Për Kreun II - “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës” është vendosur mosfillimi për **122** materiale kallëzuese, ku pjesën më të madhe e zenë mosfillimet për veprën penale të parashikuar nga neni 84, 89,99, 124, 130/a i Kodit Penal

2.Për Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” është vendosur mosfillimi për **163** materiale kallëzuese, ku pjesën më të madhe e zenë mosfillimet për veprën penale të parashikuar nga neni 134/ 143, 150, 151, 161, 180, 186, 199/a, 200, 205, të Kodit Penal.


3.Kreu IV “Vepra penale kundër mjedisit” është vendosur mosfillimi për **8** materiale kallëzuese, ku pjesën më të madhe e zenë mosfillimet për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal.

4.Kreu VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit” është vendosur mosfillimi për **212** materiale kallëzuese, ku pjesën më të madhe e zenë mosfillimet për veprën penale të parashikuar nga neni 242, 247, 248, 274, 275, 277, 290, 291 i Kodit Penal.

5.Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, është vendosur mosfillimi për **10** materiale kallëzuese, ku pjesën më të madhe e zenë mosfillimet për veprën penale të parashikuar nga neni 305, 321 të Kodit Penal.

Është vendosur mosfillimi i procedimit penal edhe për **83** materiale hetimore pa përcaktime të dispozitave të Kodit Penal.

Vihet re se numrin më të lartë të vendimeve të “Mosfillimit të Procedimit Penal” e zënë veprat penale të kreu VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit, me 212 Vendime Mosfillimi dhe numrin më të vogël të vendimeve të mosfillimit e zënë veprat penale të parashikuara në Kreu IV “Vepra penale kundër mjedisit” me 8 vendime mosfillimi.



Në lidhje me vendimet e mosfillimit të prokurorit nga informacioni që disponon zyra e regjistrimit, janë kundërshtuar në gjykatë 6 prej tyre, nga ku rezultojnë se:

1. Për 3 vendime është rrefuzuar kërkesa e lënë në fuqi vendimi i mosfillimit i prokurorit.
2. Për 1 vendim është pranuar kërkesa dhe urdhëruar regjistrimin e procedimit penal (përfshirë 290 të Kodit penal)
3. Për 2 vendime mosfillimi të prokurorit kundërshtuar e vazhdon gjykimi.

2.3 TË DHËNA STATISTIKORE PËR PROCEDIME TË PUSHUARA

2.3.1 KËRKESAT PËR PUSHIM DHE PUSHIMET

Gjatë vitit 2023 nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur pushimi i çështje ose është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes në total për 404 procedime penale me 132 persona, prej të cilëve 6 të arrestuar, përfshirë dhe ato të kodit penal ushtarak.



Rezultojnë se janë paraqitur kërkesa në gjykatë për pushimin e çështjes, gjithsej 320, në të cilat ka pasur 101 persona nën hetim. Gjykata ka dhënë deri tani 124 vendime për pushim çështje dhe për 3 çështje janë kthyer aktet për vazhdimin e hetimit, si dhe vendosur pushimi i çështjes nga vetë prokurori për 84 procedime penale dhe 8 persona nën hetim.

Ndërsa gjatë vitit 2022 nga prokurorët e kësaj prokurorie është vendosur pushimi i çështje ose është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes në total për 446 procedime penale me 171 persona, prej të cilëve 8 të arrestuar.

Vihet re se kemi një ulje me 4% në vitin 2023 të kërkesave për pushimin e çështjes drejtuar gjykatës në lidhje me një vit më parë.



Vlen të përmendet se se gjatë vitit 2023 krahas vendimeve të pushimeve për kundravajtjet penale dhe kërkesave për pushim të procedimeve penale drejtuar gjykatës për krimet, organi procedues i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për 372 procedime penale.

2.3.2 KËRKESAT PËR PUSHIM TË NDARA SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL


Për Kreun II - “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës” prokurori i është drejtuar gjykatës për 46 çështje me 14 persona nën hetim me kërkesë për pushimin e procedimit penal dhe rezulton se nga ana gjykatës është vendosur pushimi për 23 çështje.

Në lidhje me veprat penale të cilat përfshihen në **Kreun III** “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes për 115 procedime penale me 38 persona nën hetim, dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes për 79 procedime penale dhe kthim aktesh dhe vazhdimin e hetimit për 2 çështje.

Kreu IV “Vepra penale kundër mjedisit” prokurori i është drejtuar gjykatës për 1 çështje me 1 person nën hetim me kërkesë për pushimin e procedimit penal dhe është pranuar kërkesa për pushim nga gjykata për 4 procedime penale.

Në lidhje me **Kreun VIII** “Vepra penale kundër krimit të autoritetit të shtetit” prokurori i është drejtuar gjykatës për 150 procedime penale me 66 persona në hetim, me kërkesë për pushimin e procedimit penal.

Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes për 49 prej tyre dhe ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve për një procedim penal. Nga shifrat e raportuara na rezulton se ky grup veprash penale zë dhe pjesën më të madhe të kërkesave të prokurorit për pushimin e çështjes.



Kreu IX “*Vepra penale kundër drejtësisë*”, prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim për 10 procedime penale me 2 persona nën hetim, dhe gjykata ka vendosur pushim e çështjes për 7 procedime penale.

Kreu X “*Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*” nuk ka asnjë kërkesë të prokurorit por gjykata ka vendosur pranimin e 1 kërkesë, procedim penal i mbartur në gjykim nga viti i kaluar.

Lidhur me çështjet e pushuara nga prokurori vihet re se veprat penale për të cilat është vendosur pushimi janë kryesisht 84, 89, 100, 236, 242, 275, 297, të Kodit Penal, gjithsej 84 procedime penale.

Nga të dhënat e paraqitura vihet re se numrin më të lartë të vendiemve për pushim apo kërkesave drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit penal e zënë veprat penale Kreun VIII “Vepra penale kundër krimit të autoritetit të shtetit”, me 150 procedime penale ndërsa për grup veprat e ndodhura në Kreu X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve” nuk ka asnjë kërkesë të prokurorit.

2.3.3 KËRKESA PËR PUSHIM PËR PERSONAT NËN HETIM TË ARRESTUAR PËR TË CILËT ËSHTË KËRKUAR PUSHIMI I ÇËSHTJES

Gjatë vitit 2023 është kërkuar në gjykatë pushimi i çështjes për 319 procedime penale, 101 persona nën hetim, 6 prej të cilëve me masë sigurimi arrest në burg,

- Është kërkuar pushim për një procedim penal me 1 person nën hetim me masë sigurimi arrest në burg për veprën penale 79/dh të Kodit Penal.
- Është kërkuar pushim për një procedim penal me 1 person nën hetim me masë sigurimi arrest në burg për veprën penale 79/c të Kodit Penal.
- Është kërkuar pushimi për një procedim penal me 1 person nën hetim me masë sigurimi arrest në burg për veprën penale 100/2 të Kodit Penal.
- Është kërkuar pushim për një procedim penal me 2 persona nën hetim me masë sigurimi arrest në burg për veprën penale 109/b-1 të Kodit Penal.
- Është kërkuar pushim për një procedim penal me 1 person nën hetim me masë sigurimi arrest në burg për veprën penale 283/1 të Kodit Penal.

Lidhur me kërkesat me pushim të prokurorit për çështjet në hetim me pesona me masë sigurimi arrest në burg janë kryesisht rastet për shkak të gjendjes shëndetësore duke kërkuar “masë mjekësore” pasi rezulton se personi është i papërgjegjshëm.

2.3.4 SHKAQET E PUSHIMIT TË CËSHTJEVE (PUSHIM+KËRKESA PËR PUSHIM)

Duke ju referuar të dhënave statistikore të vitit 2023 rezulton se:

1. Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 6 procedime penale me 2 persona nën hetim për mungesë fakti;
2. Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 21 procedime penale me 9 persona nën hetim për mungesë provash;
3. Pushimi i çështjes është vendosur apo kërkuar për 376 procedime penale me 121 persona nën hetim për shkaqe të tjera.



2.4 TË DHËNA STATISTIKORE PËR PROCEDIME TË PEZULLUARA

Gjatë vitit 2023 është vendosur pezullimi i çështjes për 510 procedime penale, ndërsa në vitin 2022 janë pezulluar hetimet për 637 procedime penale për arsye të moszbulimit të autorëve të veprës penale.

Vihet re se procedimet penale të pezulluara përgjatë vitit 2023 kanë pësuar një ulje me 12% krahasuar me një vit më parë.



2.4.1 PROCEDIMET PENALE TË PEZULLUARA TË NDARA SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL

Për Kreun II - “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”, pezulluar gjithsej 29 procedime penale.


Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, pezulluar gjithsej 380 procedime penale, sic shihet nga të dhënat statistoke për veprën penale të “Vjedhje” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal zbulueshmëria e autorëve të veprës penale lë shumë për të dëshiruar, duke patur parasysh edhe faktin se kjo është dhe vepra penale më e përhapur në Qarkun e Elbasanit.

Kreu IV “Vepra penale kundër mjedisit” pezulluar gjithsej 11 procedime penale,

Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”, pezulluar gjithsej 85 procedime penale,

Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, pezulluar gjithsej 5 procedime penale,

Nga të dhënat e pasqyruar sa më sipër vihet re se numrin më të madh të vendimeve të pezullimit e zënë grup veprat penale të ndodhura në Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, me 380 procedime penale të pezulluara nga organi procedues dhe numrin më të vogël të vendimeve të pezulluara e zënë veprat penale të Kreun IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, me 5 procedime të tilla.



2.5 TË DHËNA STATISTIKORE PËR PROCEDIME TË TRANSFERUARA/MOSKOMPETENCË

Procedime penale të dërguara për kompetencë gjatë vitit 2023 janë 27 procedime penale, me 21 persona nën hetim e 15 të arrestuar, krahasuar me vitin 2022 nga prokurorët e kësaj prokurorie është shpallur moskompetenca tokësore apo ajo lëndore për 35 procedime penale me 11 persona nën hetim, prej të cilëve 5 të arrestuar.



Siç vihet re nga grafiku rezulton se kemi një rritje me 12% të procedimeve penale gjatë vitit 2023 ku prokurori ka shpallur moskompetencën dhe i ka dërguar aktet prokurorisë kompetente në lidhje me një vit më parë.

1.5.1 KOMPETENCAT TË NDARA SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL

Kreun II - “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”

Dërguar për kompetencë 7 procedime penale , me 15 persona nën hetim dhe 14 të arrestuar.

Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”.

Dërguar për kompetencë 6 procedime penale me 3 persona nën hetim, 1 i arrestuar.

Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”

Dërguar për kompetencë 12 procedime penale, me 2 persona nën hetim.

Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë,

Dërguar për kompetencë 1 procedime penale, me 1 person nën hetim.



Nga të dhënat e pasqyruar sa më sipër vihet re se numrin më të madh të vendimeve të shpalljes së moskompetencës e zënë grup veprat penale të ndodhura në Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”, me 12 procedime penale dërguara për kompetencë nga organi procedues dhe numrin më të vogël të vendimeve ku është shpallur moskompetenca e zënë veprat penale të Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, me 1 procedim.

2.6 KËRKESA PËR DËRGIMIN E ÇËSHTJEVE PËR GJYKIM

Procedime penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2023 janë 608 procedime penale me 755 të pandehur e 209 të arrestuar, nga prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë dërguar me kërkesa për gjykim të drejtëpërdrejtë ose me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq, nga ku gjykim të drejtëpërdrejtë janë gjithsej 19 procedime penale me 19 të pandehur.



E krahasuar me vitin 2022 ku nga ana e prokurorëve janë dërguar për gjykim, 809 procedime penale me 990 të pandehur e 205 të arrestuar.

Duke bërë krahasimet statistikore vihet re që kemi një ulje me 14 % të procedimeve të dërguara në gjyq gjatë vitit 2023 në lidhje me një vit më parë.

2.6.1 ÇËSHTJE TË DËRGUARA PËR GJYKIM SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL

Kreun II “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”

Dërguar për gjykim **135** procedime penale, me 175 të pandehur dhe 80 të arrestuar.

Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”.

Dërguar për gjykim **144** procedime penale, me 173 të pandehur dhe 23 të arrestuar.

Kreu IV “Vepra penale kundër mjedisit”, dërguar për gjykim **4** procedime penale me 6 të pandehur.

Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”,

Dërguar për gjykim **304** procedime penale, me 360 të pandehur dhe 91 të arrestuar.

Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë,

Dërguar për gjykim **21** procedime penale, me 41 të pandehur dhe 15 të arrestuar.

Kreu X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”

Nuk ka anjë procedim penal të dërguar për gjykim.

Mbeten në hetim 1654 procedime penale, me 350 persona nën hetim e 125 të arrestuar.




Nga të dhënat e pasqyruar sa më sipër vihet re se numrin më të madh të kërkesave për dërgimin e çështjes në gjykim e zënë grup veprat penale të ndodhura në Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”, me 304 procedime penale dhe numrin më të vogël e zënë veprat penale të Kreut IV “Vepra penale kundër mjedisit”, me 4 kërkesa për dërgimin e çështjes në gjykim.

2.6.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2023 prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm Elbasan, kanë përfaqësuar në gjykime themeli 943 çështje me 1165 të pandehur, prej të cilëve 310 të arrestuar, çështje këto ku përfshihen ato të mbartura në gjykim themeli nga viti 2022 dhe ato të dërguar për gjykim në vitin 2023.

Gjithashtu për vitin 2023 janë mbartur në gjykime themeli 335 çështje me 410 të pandehur, prej të cilëve 101 të arrestuar.

Ka përfunduar gjykimi për 499 procedime penale, me 599 të pandehur e 195 me masë sigurimi arrest në burg.



Të ndara sipas llojit të gjykimit, ka përfunduar gjykimi me gjykim të drejtpërdrejtë për 20 procedime penale me 20 të pandehur,

Me gjykim të zakonshëm 51 procedime penale me 66 të pandehur, gjykim të shkurtuar 426 procedime penale me 511 të pandehur, gjykime në mungesë 2 procedime penale me 2 të pandehur.

Lidhur me kërkesat e prokurorit gjatë gjykimit, është kërkuar dënimi me gjobë për 38 të pandehur, gjykimi me burg në minimum për 187 të pandehur, mesatar për 41 të pandehur, burgim të përjetshëm për 3 të pandehur, 327 dënim në aplik të nenit 59 të K.Pr.P dhe për 3 të pandehur pushim çështje, gjithsej 11 apeline të prokurorit.





Mbi bazën e kërkesës së prokurorit nga gjykata është dhënë vendim me gjobë për 33 të pandehur, për 1 të pandehur është dhënë koha e paraburgimit, për 172 të pandehur dënim me burg minimum, për 36 të pandehur dënim mesatarë, për 1 të pandehur dënimin në maksimum, për 2 të pandehur burgim të përjetshëm, për 347 dënim në aplikim të nenit 59 të Kodit të Pr.Penale, për 3 të pandehur janë kthyer aktet, vendosur pushimi i çështjes për 3

të pandehur, dhënë pafajësi për 1 të pandehur.

Kanë mbetur në gjykim për vitin 2024, 444 çështje penale me 566 të pandehur, nga të cilët 115 me masë sigurimi arrest në burg.

2.7 TË DHËNA STATISTIKORE PËR PROCEDIME ME TË PANDEHUR/PERSONA NËN HETIM

Gjatë vitit 2023 janë hetuar e gjykuar gjithsej 1673 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 355 me masë sigurimi arrest në burg.

Gjatë vitit 2023 hetimi ka përfunduar për 908 persona nën hetim/të pandehur prej të cilëve 125 të arrestuar, ndërsa gjatë vitit 2022 hetimi kishte përfunduar për 1172 persona nën hetim/të pandehur prej të cilëve 218 të arrestuar.

Kanë mbetur në hetim për vitin 2024 gjithsej 350 persona nën hetim me 125 të arrestuar, ndryshe nga viti 2022 (mbartur për vitin 2023), në hetim 215 persona prej të cilëve 76 të arrestuar.





Nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2023 kemi një ulje në % të personave nën hetim/pandehur dhe atyre me arrest në burg, të përfunduara në krahasim me atë të një viti më parë. Konkretisht, një ulje me 8% për pesonat nën hetim dhe me 4% për pesont me arrest në burg gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më parë.

Nga të dhënat rezulton se gjatë vitit 2023 kemi një rritje në % të personave nën hetim/pandehur dhe atyre me arrest në burg të mbetura në hetim në krahasim me atë të një viti më parë. Konkretisht, një rritje me 31% për pesonat nën hetim dhe me 7% për pesont me arrest në burg gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më parë.



2.8 TË DHËNA NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT PERSONAL

Në gjykatë janë paraqitur, përgjatë vitit 2023, gjithsej **537** kërkesa për caktim mase sigurimi shtrënguese dhe **6** kërkesë për masë ndaluese.

Gjykata për vitin 2023 ka vendosur të japë **536** masa shtrënguese dhe **6** masë ndaluese.


Ndërkohë gjatë vitit 2022, janë paraqitur në gjykatë, gjithsej **551** kërkesa për caktim të masave të sigurimit personal dhe **13** kërkesa për masa ndaluese. Gjykatat për vitin 2022 kanë vendosur të japin **550** masa shtrënguese dhe **4** masa ndaluese.





Pra vihet re nje trend në ulje prej 2% përgjatë vitit 2023 të kërkesave të prokurorit për caktimin e masave shtrenguese dhe ndaluese në krahasim me një vit më parë. I njejt trend është edhe në gjykatë.

Lidhur me masat e sigurimit gjatë vitit 2023 janë kryer **442** arreste nga oficerët e policisë gjyqësore dhe **99** urdhëra ndalimi.



Gjatë vitit 2023 ka rezultuar se nga ana e prokurorit është bërë një urdhër lirim i menjëhershëm, janë bërë **540** kërkesa për vlerësim arresti dhe nga gjykata janë vendosur **538** vleftësime të ligjshme dhe **2** arreste në flagrancë janë vlerësuar të paligjshëm.



Nga të dhënat e paraqitura më sipër, vihet re se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka kërkuar për vepra të ndryshme penale, **279** kërkesa arrest në burg³, **1** arrest me burg në mungesë, **27** arrest shtëpie, **31** arrest me afat, **199** detyrim paraqitje para oficerit të policisë gjyqësore⁴ dhe **6** masa ndaluese⁵.

³ Neni 238 i K.Proc.Penale, 1. Me vendimin e arrestit në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore që ta kapë të pandehurin dhe ta çojë menjëherë në një institut paraburgimi për të qëndruar aty në dispozicion të autoritetit procedues. 2. Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit.

⁴ Neni 234 i K.Proc.Penale, Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, 1. Me vendimin për paraqitjen në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore. 2. Gjykata cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

⁵ Masat ndaluese janë: a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik; b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

Gjithashtu, vihet re se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vendosur masë sigurie **236** arrest në burg, **43** arrest shtëpie, **28** arrest me afat, **229** detyrim paraqitje para oficerit të policisë gjyqësore⁶ dhe **6** masa ndaluese.



Nga të dhënat e paraqitura në grafikët e mësipërm, vihet re se Prokuroria pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka kërkuar për vepra të ndryshme penale, 51% arrest në burg⁷, 5% arrest shtëpie, 6% arrest me afat, 37% detyrim paraqitje para oficerit të policisë gjyqësore⁸ dhe 1% masa ndaluese⁹.

Gjithashtu, vihet re se Gjykata e e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka vendosur masë sigurie 44% arrest në burg, 8% arrest shtëpie, 5% arrest me afat, 42% detyrim paraqitje para oficerit të policisë gjyqësore¹⁰ dhe 1% masa ndaluese.

⁶ Neni 234 i K.Proc.Penale, Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, 1. Me vendimin për paraqitjen në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore. 2. Gjykata cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

⁷ Neni 238 i K.Proc.Penale, 1. Me vendimin e arrestit në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore që ta kapë të pandehurin dhe ta çojë menjëherë në një institut paraburgimi për të qëndruar aty në dispozicion të autoritetit procedues. 2. Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit.

⁸ Neni 234 i K.Proc.Penale, Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, 1. Me vendimin për paraqitjen në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore. 2. Gjykata cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

⁹ Masat ndaluese janë: a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik; b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

¹⁰ Neni 234 i K.Proc.Penale, Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, 1. Me vendimin për paraqitjen në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore. 2. Gjykata cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

Vihet re se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka tendencë të zbusë masën e sigurimit personal kërkuar nga organi procedues pasi vihet re një rritje % së masës së sigurimit “Detyrim paraqitje”, “Arrest me afat” si dhe “Arrest shtëpie” dhe një ulje e % së masës së sigurimit “Arrest me Burg”, prej 6% në lidhje me kërkesat nga ana e organit procedues.

Rezulton se përgjatë vitit 2022 nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë kërkuar **249** arrest në burg, **4** arrest me burg në mungesë, **17** arrest në shtëpi, **24** arrest me afat, **257** detyrim paraqitjeje dhe **13** masa ndaluese. Po gjatë këtij viti nga gjykata në lidhje me këto kërkesa janë vendosur **202** arreste në burg, **4** arrest në burg në mungesë, **30** arreste në shtëpi, **34** arrest me afat, **280** detyrim për paraqitje dhe **13** masa ndaluese.



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në lidhje me arrestimet në flagrancë dhe ndalimet gjatë vitit 2023 për veprat penale të hetuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Ajo që vihet re është se për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal kemi numrin më të lartë të arresteve në flagrancë me 127 të arrestuar ndjekur nga vepra penale e “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i k.Penal me 61 të arrestuar dhe 3 urdhëra ndalimi nga oficerët e policisë gjyqësore.

Neni K.P	Arrestime në flagrancë	Ndalime nga opgj	Ndalime nga prokurori
76-22	2	0	0
76	0	0	0
78/1	9	0	0
78/a	1	0	0
79-a	4	0	0
79-dh	1	0	0
79/c	2	0	0
80	3	2	0
84	6	0	0
88	4	1	0
89	4	0	0
99	1	0	0


100/2	0	1	0
103/1	0	0	0
108/a-1	0	1	0
109/b-1	5	0	0
110/2	1	0	0
121/a/1	3	1	0
121/a/3	0	1	0
130/a	61	3	0
134	17	10	0
135	0	0	0
139	4	0	0
141/a-1	0	2	0
142	0	0	0
143	2	3	0
143/b-1	1	0	0
150	4	0	0
151	6	0	0
154	0	0	0
156	0	0	0
159	2	0	0
172	0	0	0
173/1	0	0	0
174/1	1	0	0
180	3	0	0
186	2	1	0
197	23	0	0
198	2	0	0
199/a	5	3	0
205/a/1	2	0	0
206/b/2	1	0	0
235,236,237,238	25	1	0
242	1	0	0
244	0	0	0
248	2	12	0
259	0	1	0
273	1	0	0
278	9	3	0
278/a-2	1	0	0
279	5	0	0
280	1	0	0
283	23	48	0
284	0	2	0
287/1-b	1	0	0
289	10	0	0
290	39	2	0
291	127	0	0

298/1	0	0	0
300, 301, 302	2	0	0
306	2	0	0
321/1	0	0	0
323	5	1	0
324/a-1	1	0	0
328/a-1	4	0	0

2.9 SHPEJTËSIA NË HETIME DHE ZGJATJA E AFATIT TË HETIMEVE PARAPRAKE

Gjatë vitit 2023 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 130 çështje me 170 persona në hetim apo të pandehur nga të cilët, 73 kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”.

Për periudhën deri në **3 muaj** ka patur 91 çështje me 126 të pandehur, 58 arrest në burg; për periudhën **mbi 3 deri në 6 muaj** ka patur 18 çështje me 21 të pandehur, 7 arrest në burg dhe për periudhën **6 deri në 9 muaj** zgjatje ka patur për 11 çështje me 12 të pandehur, 7 të arrestuar, për periudhën **9 muaj deri në 1 vit** ka patur zgjatje për 4 çështje me 4 të pandehur, për periudhën **mbi 1 vit** kemi patur zgjatje për 6 çështje, me 7 të pandehur e 1 të arrestuar.



Nga të dhënat që disponohen nga zyra e regjistrimit përqindjen më të madhe të zgjatjeve të afateve e kemi për periudhën deri në 3 muaj me 70% ndërsa përqindjen më të ulët e kemi për zgjatjen e hetimeve për periudhën deri në 12 muaj me 3%.


Mund të themi se rrethanat që kanë çuar në zgjatje të afatit të hetimeve lidhen kryesisht me vonesat në administrimin e akteve nga Drejtoria e Policisë Shkencore kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH Tiranë dhe informacioneve të tjera nga institucionet.

Ndërsa gjatë vitit 2022 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 157 çështje me 188 persona në hetim apo të pandehur nga të cilët, 84 kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”. Për periudhën deri në 3 muaj ka patur 122 çështje me 143 të pandehur, 52 arrest në burg; për periudhën mbi 3 deri në 6 muaj ka patur 29 çështje me 39 të pandehur, 21 arrest në burg dhe për periudhën 6 deri në 9 muaj zgjatje ka patur për 6 çështje me 6 të pandehur, 1 i arrestuar;



Rezultoni se gjatë vitit 2022 kemi 10% më tepër procedime penale, ku nga organi procedues është parë e nevojshme zgjatja e hetimeve paraprake, në krahasim me vitin 2023.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se kemi një ulje të përqindjeve të zgjatjeve të hetimeve paraprake përgjatë vitit 2023 në lidhje me një vit më parë përse I përket zgjatjeve të hetimeve për periudhën deri në 3 muaj dhe atë nga 3-6 muaj. Koncretisht me 11% për zgjatjen e hetimeve paraprake për periudhën deri në 3 muaj dhe me 4% për periudhën nga 3-6 muaj. Vihet re një rritje e përqindjeve të zgjatjeve të hetimeve gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022 në lidhje me zgjatjet për një periudhë nga 6-9 muaj me 2% si dhe kemi rritje të përqindjes për periudhën nga 9-12 muaj me 1% dhe me 2% për periudhën mbi 12 muaj.



2.10 TË DHËNA NË LIDHJE ME HETIMET PASURORE DHE MASAT E SIGURIMIT PASUROR

Nga të dhënat e administruara nga registri elektronik i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rezulton se gjatë vitit 2023 janë regjistruar 14 referime pasurore, nga të cilat dy janë procedime pasurore, të mbartura nga vitit i kaluar 51 referime pasurore dhe 15 procedime pasurore.

Nga ana e organit procedues është vendosur mosfillimi për 11 referime pasurore, dërguar për kompetencë 5 referime pasurore si dhe vendosur pushimi për 2 procedime pasurore.

Në bazë të nenit 270 e vijues të K.Pr.Penale organi procedues i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Elbasan me kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventiv, kërkesa të cilat janë miratuar me vendim nga ana e gjykatës.

Përgjatë vitit 2023 organi procedues i është drejtuar gjykatës me 5 kërkesa për vendosjen e masës së sekuestros. Konkretisht, ka kërkuar 1 sekuestrim pasurie bazuar në kodin e procedurës penale, dhe 4 bazuar në ligjin Nr.10192/2009



“Antimafia”, i ndryshuar. Gjithashtu, janë paraqitur edhe 2 kërkesa për konfiskim pasurie bazuar në ligjin Nr.10192/2009 “Animafia”, i ndryshuar.

Gjykata në lidhje me kërkesat e organit procedues për sekuestrim pasurie ka vendosur sekuestrimin e 5 automjete, 5 apartamente/ndërtesa me sipërfaqe deri në 100m², 2 apartament/ndërtesë me sipërfaqe mbi 100m².

Prokuroret janë drejtuar Gjykatës për konfiskimin e pasurisë së sekuestruar për 2 procedime pasurore.



Konkretisht, përgjatë vitit 2022 janë sekuestruar : 16 automjete, 15 apartamente, 5 troje dhe 3 subjekte.



Hetimet pasurore, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve te tjera, nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”.

HETIMET PASURORE


Pas ndryshimeve përkatëse në Kodin e Procedurës Penale, si dhe pas krijimit të Prokurorisë së Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), duke filluar nga fundi i vitit 2019 e në vazhdim dhe në vitin 2020, si kompetencë lëndore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka kaluar dhe hetimi pasuror, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve te tjera, nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”.

Gjatë vitit 2023 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë regjistruar gjithsej 14 referime pasurore, nga të cilat 2 janë regjistruar procedime pasurore. Janë mbartur nga viti kaluar 51 referime pasurore dhe 15 procedime pasurore. 11 referime pasurore janë mosfilluar, 5 për kompetencë dhe 49 janë në fazë verifikimi.



Gjatë vitit 2022 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë regjistruar gjithsej 12 referime pasurore, nga të cilat 2 janë regjistruar procedime pasurore, 1 referim është mosfilluar, 3 për kompetencë (dërguar SPAK) dhe 6 janë në fazë verifikimi.

Janë mbartur nga viti 2021, 73 referime, nga të cilat 10 referime pasurore janë mosfilluar.



Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se përgjatë vitit 2023 kemi të njëjtën % të referimeve pasurore të regjistruar në procedime pasurore në krahasim me një vit më parë, i njëjti trend vihet re edhe për vendimet e mosfillimeve. Përgjatë vitit 2023 kanë përsuar një rritje me 1% ku organi procedues ka shpallur moskompetencën e saj duke i dërguar aktet prokurorisë kompetente në krahasim me atë të një viti më parë. Ndërsa referimet pasurore në fazë verifikimi janë ulur ndjeshëm me 19%

në vitin 2023 në lidhje me të njëjti vit më parë.

Në lidhje me procedimet pasurore gjatë vitit 2023 kemi 2 procedime të regjistruara, 1 në fazë hetimi dhe 1 është bërë *Kerkese per konfiskimin e pasurise se sekuestruar* Dt: 10.07.2023.

15 procedime pasurore janë të mbartura nga viti 2023, për 1 procedim pasuror është paraqitur “*Kerkese Gjykates Elbasan per konfiskimin e pasurise se sekuestruar ngarkim te M. K date 20.07.2023; Me vendimin dt 30.10.2023 pranuar kerkesa per konfiskimin e automjeit tip Lamburgini me targe DO14MBO- Arshivuar dt 31.10.2023*”, për 2 prej tyre janë pushuar dhe për 2 është shpallur moskompetenca.

Në lidhje me procedimet pasurore gjatë vitit 2022 kemi 2 procedime të regjistruara, 1 në fazë hetimi dhe 1 është dërguar për kompetencë, 16 procedime pasurore janë të mbartura nga viti 2021, 4 prej tyre janë pushuar dhe 1 është shpallur moskompetenca.

KONFISKIMI PASURIVE, LIGJI ANTIMAFIA

Përgjatë vitit 2023 kemi kërkesa për konfiskim të pasurive të sekuestruara për 2 procedime pasurore.

2.11 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

2.11.1 URDHËRA EKZEKUTIMI

Gjatë vitit 2023, nga Prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë nxjerrë gjithsej 1040 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë.

Në lidhje me urdhërat e ekzekutimit të nxjerra gjatë vitit 2023 rezulton se janë nxjerrë:


- 194 urdhëra për dënime me burgim;
- 18 urdhëra për dënime gjobë;
- 2 urdhëra për dënime plotësuese;
- 322 urdhëra për dënime



Për vitin 2023 është vendosur pezullimi i procedimit penal për moszbulim autori gjithsej 510 procedime penale, nga 1548 procedime penale të përfunduara në total , 153 persona nën hetim, 755 të pandehur, 230 të



RAPORTI I CËSHTJEVE TË PEZULLUARA ME CËSHTJET E PËRFUNDUARA



arrestuar. Vihet re se, Vendimet e pezullimeve zëne 25 % të procedimeve penale të përfunduara përgjatë vitit 2023.

Për vitin 2022, është vendosur pezullimi për 425 procedime penale nga 1715 procedime penale me 182 persona nën hetim, 990 të pandehur, 218 të arrestuar në total. Vihet re se përgjatë vitit 2023 kemi ulje me 5% të procedimeve të përfunduara në krahasim me një vit më parë përkundrazi një rritje me 2%


të vendimeve të pezullimit gjatë 2023 krahasuar me vitin 2022.

4.2 TREGUESI I EFEKTIVITETIT NË GJYKIMIN DHE DËNIMIN E TË PANDEHURVE

Në përfundim të gjyqimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2023 për 599 të pandehur të gjykuar nga prokurorët janë kërkuar :

- Dënime me gjobë për 38 të pandehur;
- Dënime me burgim për 231 të pandehur, nga të cilët dënim në minimum për 187 të pandehur, mesatar 41 të pandehur dhe burgim të përjetshëm 3 të pandehur;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 327 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 3 të pandehur;

TREGUESI I EFEKTIVITETIT NË GJYKIMIN DHE DËNIMIN E TË PANDEHURVE



Në përfundim të gjyqimeve të çështjeve penale gjatë vitit 2023 për 599 të pandehur të gjykuar nga gjykata janë dhënë :

- Dënime me gjobë për 33 të pandehur;


- Dënime me burgim për 212 të pandehur, për të cilët 1 me paraburgim, dënim minimal është dhënë për 172 të pandehur, dënim mesatar për 36, 1 për dënim maksimal dhe 2 të pandehur me burgim të përjetshëm;
- Dënime alternative N.59 e 63 i K.Penal për 347 të pandehur;
- Pushim gjykimi për shkak vdekje të pandehuri ose për shkak të tërheqjes së ankimit për 3 të pandehur.
- Pafajsi për 1 të pandehur në 1 çështje penale
- Kthim aktesh për 3 çështje penale me 3 të pandehur.

Në lidhje me pafajsitë e dhëna gjatë vitit 2023 nga gjykata rezulton se: Gjatë vitit 2023 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është dhënë vendim pafajësie e plotë për 1 të pandehur në procedimin 273 të vitit 2021 për nenin 283/2 dhe është dhënë pafajësi e pjesshme për një të pandehur për procedimin 08 të vitit 2022 për veprën 278/1 të Kodit penal dhe është dhënë dënim me burg për të njëjtin të pandehur për nenin 283/2 të të njëjtit procedim, ndryshe nga kërkesa e prokurorit për deklarim fajtor dhe dënim me burgim për të pandehurit për këto vepra penale. Të dy këto vendime janë apeluar nga prokurori.

4.3 TË DHËNA PËR GJYKIMET E POSAÇME

- 1. Në lidhje me gjykimin e drejtpërdrejtë:** Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë 20 çështje me 20 të pandehur. Me gjithë ngarkesën e se cilit Prokuror, gjatë vitit 2023 vihet re një rritje e kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë. Të gjitha kërkesat për gjykim të drejtpërdrejtë kanë përfunduar me dënim fajësie nga Gjykata. Ndërkohë gjatë këtij viti janë paraqitur gjithësej 19 kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë.
- 2. Në lidhje me Marrëveshje për praninë fajësie dhe caktimin e dënimit:** Gjatë vitit 2023 janë dërguar në Gjykatë 13 Kërkesa për gjykim me marrëveshje fajësie për 12 procedime penale me 13 të pandehur dhe caktim dënimi. Kanë përfunduar gjykimin me procedurë gjykimi praninë marrëveshje fajësie për 12 çështje me 12 të pandehur dhe për 1 të pandehur është refuzuar marrëveshja dhe janë kthyer aktet.
- 3. Në lidhje me Urdhërat penal:** Gjatë vitit 2023 janë përcjell me kërkesë për miratim urdhëri penal 3 çështje me 3 të pandehur. Ka përfunduar gjykimi duke u miratuar Urdhëri Penal për 5 procedime penale me 5 të pandehur (*përfshirë dhe çështjet e mbartura në gjykim*) Nga Gjykata është refuzuar Urdhëri Penal dhe kthyer aktet për 2 të pandehur
- 4. Gjykim i shkurtuar:** Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar me gjykim të shkurtuar 426 procedime penale me 511 të pandehur.

Nga grafiku vihet re se % më të madhe e zënë gjykimet e shkurtuara me 83%, ndjekur nga gjykimet e zakonshme me 10%, gjykimet të drejtpërdrejta me 4%. Marrëveshje për pranimin e fajësisë me 2% dhe Urdhër Penal me 1%.




4.4 NUMRI I PROCEDIMEVE PËR TË CILËT ËSHTË PROCEDUAR ME SECILIN NGA LLOJET E GJYKIMEVE

Referuar të dhënave statistikore në rubrikën çështje të gjykuara rezultojn se për vitin 2023 ka përfunduar gjykimi për 499 procedime penale me 599 të pandehur, 195 të arrestuar.

Të ndara sipas llojit të gjykimit raportojmë se gjatë vitit 2023 kanë përfunduar:

1. Me gjykim të drejtpërdrejtë 20 procedime penale me 20 të pandehur.
2. Me gjykim të zakonshëm 51 procedime penale me 66 të pandehur.
3. Gjykim të shkurtuar 426 procedime penale me 511 të pandehur.
4. Gjykim në mungesë 2 procedime penale me 2 të pandehur.



Siç vihet re mund të themi se pjesën më të madhe të llojeve të gjyqimeve e zënë gjykimet e shkurtuara, me 426 procedime penale.

4.5 TË DHËNA SOCIALE DHE DEMOKRAFIKE MBI TË PANDEHURIT (GJINIA, MOSHA, ARSIMI,)

4.5.1 PERSONA NËN HETIM/ PANDEHUR SIPAS MOSHËS PËR VITIN 2023



Referuar të dhënave statistikore të vitit 2023 janë hetuar dhe gjykuar në total 1673 persona nga të cilët 1598 janë meshkuj dhe 75 femra, ku 14 persona janë shtetas të huaj.

Nga grafikët e Vihet re se numrin më të lartë të personave nën hetim/pandehur të cilët janë autor të veprave penale i përkasin gjinisë mashkullore përkatësisht me 96%.


4.5.1.1 PERSONA/TË PANDEHUR SIPAS GJINISË, TË NDARË SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL

Për **Kreun II** “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”, nga 314 të regjistruar persona/të pandehur, 297 meshkuj dhe 17 femra.

Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” nga 389 të regjistruar persona/të pandehur, 2 janë shtetas të huaj, dhe sipas gjinisë 354 janë meshkuj dhe 35 femra.

Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 17 persona/ të pandehur të cilët janë të gjithë meshkuj.

Kreun V “Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 3 persona/të pandehur, të cilët 2 meshkuj dhe 1 femër, me shtetësi të huaj.



Kreun VIII “*Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit*”, regjistruar 865 persona/të pandehur, nga të cilët 9 janë shtetas të huaj, të ndarë sipas gjinisë 849 janë meshkuj dhe 16 femra.

Kreun IX “*Vepra penale kundër drejtësisë*”, në vitin 2023 janë regjistruar 81 persona/të pandehur, të ndarë sipas gjinisë 75 janë meshkuj dhe 6 femra.

Kreun X “*Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*”, për vitin 2023 janë regjistruar 4 persona/pandehur të cilët janë meshkuj dhe me shtetësi shqiptare.

Nga sa më sipër vihet re, numrin më të lartë të të pandehurve meshkuj e kemi për grupveprat penale të parashikuara në Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit” me 849 meshkuj ndërsa numrin më të lartë të të pandehurve femra e kemi për grupveprat penale të parashikuara në Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”.

4.5.2 PERSONA NËN HETIM/ PANDEHUR SIPAS NIVELIT ARSIMOR PËR VITIN 2023

Pjesa më e madhe e të pandehurve rezulton të kenë arsim deri në 9 klasë, e ky fakt evidentohet me numrin e të pandehurve që kanë këtë arsim, i cili është 1092 (65%), ndërkohë të pandehurit me arsim të mesëm janë 412 (25%) e ata me arsim të lartë janë 169 (10%).

Vihet re se % më të madhe të të pandehurve të cilët kanë kryer një vepër penale e zënë të pandehurit me arsim 9-vjeçar.

Nga të pandehurit e hetuar gjatë vitit 2023 theksojmë se 23 të pandehur kanë qenë punonjës policie ku në rolin bazë 6 punonjës policie, 14 në rolin e mesëm dhe 3 në rolin e lartë.



4.5.2.1 PERSONA/TË PANDEHUR SIPAS ARSIMIT, TË NDARË SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL

Për **Kreun II** - “*Veprat penale kundër personit krime kundër jetës*”, regjistruar 314 persona/të pandehur, me arsim 9 – vjeçar 228 të pandehur; 76 me arsim të mesëm dhe 10 me arsim të lartë; **Kreun III** “*Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*”, regjistruar 389 persona/të pandehur, me arsim 9- vjeçar 245 persona/të pandehur; 98 me arsim të mesëm dhe 46 me arsim të lartë;


Kreun IV “*Vepra penale kundër mjedisit*”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 17 persona/ të pandehur. Nga këta persona janë me arsim deri në 9- klasë 16 të pandehur dhe 1 është me arsim të mesëm.

Kreun V “*Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues*”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 3 persona/të pandehur, të 3 me arsim të mesëm.

Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”, regjistruar 865 persona/të pandehur, nga të cilët me arsim deri 9 – vjeçar 541 persona/të pandehur, me arsim të mesëm 219 dhe me arsim të lartë 105 persona.

Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, në vitin 2023 janë regjistruar 81 persona/të pandehur, nga ku 55 me arsim deri në 9 – klasë, 18 me arsim të mesëm dhe 8 me arsim të lartë.

Kreu X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, për vitin 2023 janë regjistruar 4 persona/pandehur të cilët janë me arsim 9 – vjeçar.



4.5.3 TË PANDEHURIT SIPAS VENDBANIMIT PËR VITIN 2023

Nga procedimet e hetuara përgjatë vitit 2023 rezulton se pjesa më e madhe e të pandehurve evidentohet të jenë banorë të qytetit, konkretisht 1111 (63%) të pandehur e 562 (37%) banojnë në zonat rurale përkundrejt 1200 (67%) të pandehurve që jetojnë në qytet dhe 600 (33%) në zona rurale përgjatë vitit 2022.




Nga të dhënat e paraqitura rezulton se kemi një ulje të % të vendbanimit të të pandehurve që kanë kryer një vepër penale gjatë vitit 2023 me 3% në krahasim me një vit më parë dhe rritje të të numrit të pandehurve të cilët jetojnë në zona rurale gjatë vitit 2023 me 1% më shume sesa në vitin 2022.



4.5.3.1 PERSONA/TË PANDEHUR SIPAS VENDBANIMIT, TË NDARË SIPAS KRERËVE TË KODIT PENAL

Për Kreun II - “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”, nga 314 të regjistruar persona/të pandehur, 174 persona/pandehur janë banues në qytet ndërsa 140 në zona rurale.



Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” nga 389 të regjistruar persona/të pandehur, 273 persona/pandehur janë banues në qytet ndërsa 116 në zona rurale.

Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 17 persona/ të pandehur, nga të cilët 2 në qytet dhe 15 në zona rurale.

Kreun V “Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 3 persona/të pandehur, të cilët janë banues në qytet.

cilët janë banues në qytet.

Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”, regjistruar 865 persona/të pandehur, nga të cilët 592 janë banues në qytet dhe 273 në zona rurale

Kreun IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, në vitin 2023 janë regjistruar 81 persona/të pandehur ,63 banues në qytet dhe 18 në zona rurale.


Kreun X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, për vitin 2023 janë regjistruar 4 persona/pandehur nga të cilët janë banues në qytet.

4.5.4 GJENDJA GJYQËSORE E TË PANDEHURVE GJATË VITIT 2023

Nga të dhënat e administruara rezulton se përgjatë vitit 2023 nga 1673 të pandehur, 198 (12%) janë recidivistë/përsëritës dhe 1475 (88%) janë të padënuar ndërsa gjatë vitit 2022 nga 1800 të pandehur, 213 (12%) janë recidivistë/përsëritës dhe 1587 (88%) janë të padënuar.

Për vitin 2023 persona/të pandehur sipas gjendjes gjyqësore, përkatësisht të ndarë sipas krerëve:

Për Kreun II - “Veprat penale kundër personit krime kundër jetës”, nga 314 të regjistruar persona/të pandehur, 48 persona/pandehur janë recidivistë ndërsa 266 të padënuar.



Kreun III “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” nga 389 të regjistruar persona/të pandehur, 47 recidivistë dhe 342 të padënuar.

Kreun IV “Vepra penale kundër mjedisit”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 17 persona/ të pandehur, 2 përsëritës, 15 janë me gjendje gjyqësore të padënuar.

Kreun V “Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 3 persona/të pandehur, të cilët janë të padënuar më parë.

Kreun VIII “Vepra penale krime kundër autoritetit të shtetit”, regjistruar 865 persona/të pandehur, nga të cilët 70 janë recidivistë dhe 795 të padënuar më parë

Kreu IX “Vepra penale kundër drejtësisë”, në vitin 2023 janë regjistruar 81 persona/të pandehur, 31 janë recidivistë dhe 50 të padënuar.

Kreu X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, për vitin 2023 janë regjistruar 4 persona/pandehur të cilët janë të padënuar.

Nga sa më sipër konkludohet se profili i autorit të veprës penale gjatë vitit 2023 është mashkull, hetuar në gjëndje të lirë, me vendbanim në qytet , i padënuar më parë dhe me arsim 9-vjeçar. I njëti profil i autorit të një viti më parë.

4.6 TË DHËNA MBI VIKTIMAT E VEPRAVE PENALE DHE PASOJAT E VEPRAVE PENALE

Gjatë vitit 2023 të dëmtuar viktima në total kemi 389 persona, nga të cilët të dëmtuar – vitkima deri në 18 vjeç kemi 26 meshkuj dhe 23 femra;

Të dëmtuar – viktima mbi 18 vjeç janë 348 persona nga të cilët 189 meshkuj dhe 159 femra.



Në lidhje me pasojat e veprës penale në dëm të shëndetit rezulton se kemi:

1. 36 viktima me pasojë vdekjen;
2. 37 me pasojë plagosje e rëndë;
3. 76 plagosje e lehtë;
4. Pasoja në dëm ekonomik, shuma në lekë në sektorin shtetëror kemi 1771615 lekë dhe në sektorin privat kemi 2170298 lekë.

4.7 TË DHËNA PËR REFERIME, MOSFILLIME E PROCEDIME PËR PERSONA/PANDEHUR TË MITUR TË REGJISTRUARA NË VITIN 2023

Gjatë vitit 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë referuar 148 materiale me të mitur të përfshirë, 8 materiale më shumë se gjatë vitit 2022, ku ka patur 140 materiale. Nga materialet e ardhura 42 prej tyre janë procedime me të mitur në konflikt me ligjin, 37 çështje janë me të mitur viktimë dhe 30 çështje me të mitur dëshmitarë



Në lidhje me të pandehur të mitur rezultojn se gjatë vitit 2023 janë regjistruar 40 të mitur të pandehur, të gjithë meshkuj, ndërsa gjatë vitit 2022 kanë qenë 46 të mitur në cilësinë e të pandehurit.

Ka rezultuar se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan përgjatë vitit 2023 janë referuar 148 materiale ku kanë qenë të përfshirë



të miturit në të gjitha pozitat procedurale.

Konkretisht, organi procedues ka marrë vendim mosfillimi për 15 materiale procedurale, ka regjistruar 42 procedime penale ku autor i veprës penale është i mituri në cilësinë e të miturit në konflikt me ligjin, nga të cilët 40 janë marrë të pandehur. Gjatë fazës së hetimeve paraprake ka rezultuar se 4 të mitur janë hetuar me masë sigurimi “*Arrest në burg*” dhe 1 (një) i mitur me masë sigurie “*Arrest në shtëpi*”.

Të dhëna për personat/pandehur të mitur gjatë vitit 2023

Sipas grupmoshës 5 persona kanë qenë deri në 14 vjeç, 17 të grupmoshës 14-16 vjeç, si dhe 18 të grupmoshës 16-18 vjeç.

Moshë			Gjinia	
Deri 14 vjeç	14-16 vjeç	16-18 vjeç	Meshkuj	Femra
5	17	18	40	0


Në lidhje me veprat penale të kryera nga të miturit rezulton se të miturit më së shumti kanë kryer veprën penale të *''Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt''* parashikuar nga neni 291 i K.Penal, gjithsej 20 persona të mitur, e njëjta shifër me atë të një viti më parë.

Pas kësaj vepra penale më e përhapur e kryer nga të miturit është *''Vjedhja''* me 5 persona të mitur në konflikt me ligjin, shihet një rënie e numrit të autorëve të kësaj vepre në krahasim e vitin 2022 ku kishim 6 të mitur autor

Përsa i përket veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe konkretisht *''Prodhimi dhe shitje e narkotikëve''* e parashikuar nga neni 283 i K.Penal rezulton se persona nën hetim kanë qenë 3 të mitur, shifër e njëjtë me atë të vitit 2022.

Viher re një rënie e ndjeshme e konsumimit të veprës penale të *''Prodhimi mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta''*, të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal ku kemi vetëm një të mitur të pandehur, ndryshe nga viti 2022 kur kanë qenë 7 të mitur autor.

Vihet re se gjatë vitit 2023 nuk kanë pësuar ndryshim veprat penale të konsumuara nga të miturit për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ndryshime kanë pësuar në ulje me 1% për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, me 10% për veprën të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më parë. Gkithashtu, rezulton se vetëm për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal kemi një rritje me 1% gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më parë.



Të dhëna për personat/pandehur të mitur për vitin 2023 sipas veprave penale

Vepra penale sipas neneve	Persona/pandehur
N. 79/a	4
N. 89	1
N. 130/a	1
N. 134	5
N. 198	1
N. 247	1
N. 279	1
N. 283	3
N. 290	2
N. 291	20
N. 323	1
Totali	40

4.7.1 MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE ME TË MITUR

Në lidhje me çështjet penale ku autorë janë të miturit rezulton se gjatë vitit 2023 janë mosfilluar 15 materiale ku 7 janë mosfilluar duke aplikuar shmangien nga dënimi dhe 8 materiale janë mosfilluar për arsye të tjera. (Në vitin 2022 janë mosfilluar 11 çështje, 4 janë mosfilluar duke aplikuar shmangie nga dënimi dhe 7 për arsye të tjera)

Në total janë pushuar 19 procedime penale me të mitur autor, nga të cilat 18 procedime me 18 të mitur autor janë pushuar duke aplikuar shmangien nga dënimi ndërsa vetëm 1 procedim me 1 të mitur autor është pushuar për arsye tjetër. Ndryshe nga viti 2022 ku u pushuan 28 procedime penale me 30 të mitur në konflikt me ligjin, ku nga këto 24

procedime me 26 të mitur autor janë pushuar për shmangie nga dënimi, konkretisht paralajmërim me shkrim dhe 4 procedime me 4 të mitur janë pushuar për shkak tjetër.)

Në total numri i shmangieve të aplikuara gjatë vitit 2023 është 25 çështje me 25 të mitur, ku 7 janë mosfilluar për shmangie ndërsa 18 janë pushuar duke aplikuar shmangien, ndryshe nga viti 2021 ku është aplikuar shmangie nga dënimi për 28 çështje me 30 të mitur.

Kjo dhe për arsye se gjatë vitit 2023 ka pasur një numër më të ulët referimesh për çështje me të mitur krahasuar me vitin 2022, gjithashtu sepse në disa çështje i mituri ka qenë përsëritës, ku i është aplikuar njëherë masa e shmangies nga dënimi.



Gjatë vitit 2023 është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim për 10 procedime (të reja dhe të mbartuar) me 14 të pandehur, ku nga gjykata janë pranuar 2 kërkesa për dërgim çështje në gjyq, për të cilat është dhënë masa e dënimit alternativ, 20 çështje me të mitur janë pezulluar, 1 çështje është transferuar dhe 13 çështje me të mitur janë ende në hetim.

Gjatë vitit 2022 u dërguan për gjykim. Është kërkuar dërgimi i çështjes për

gjykim për 16 procedime me 19 të pandehur, ku nga gjykata janë pranuar 2 kërkesa për dërgim çështje në gjyq, 1 çështje është pushuar dhe për një është dhënë dënim me burg, 2 çështje të dyshuara me të mitur në konflikt me ligjin janë pezulluar dhe 16 çështje me të mitur janë ende në hetim.


Vlen të theksohet se: 3 shmangie paralajmërim me shkrim kanë qenë procedime të mbartura nga 2022 por që janë pushuar në 2023; 9 procedime të mbartura nga viti 2022 janë pezulluar

në vitin 2023; 3 procedime të mbartura me 5 autor nga viti 2022 është dërguar kërkesa për gjykim në vitin 2023; 1 procedim i mbartur nga viti 2022 është bërë moskompetencë në 2023.

4.7.2 VIKTIMAT E MITUR NGA VEPRAT PENALE

Përsa i përket grupit të të miturve viktimat të veprave penale rezultojnë se gjatë vitit 2023 janë trajtuar 37 çështje me 51 të mitur viktimë ndryshe nga viti 2022 ku ka pasur 40 çështje me 48 të mitur viktimë, vihet re se ka ulje të numrit të çështjeve me të mitur viktimë. Nga 51 viktimat të mitur në total, 17 prej tyre janë femra dhe 34 meshkuj.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezultojnë se gjatë vitit 2023 kemi një ulje me 2% të çështjeve ku janë përfshirë të mitur viktimë në krahasim me një vit më parë por numri i viktimave përgjatë vitit 2023 është rritur me 2% në krahasim me një vit më parë.



Në total gjatë vitit 2023 ka patur 30 çështje me 52 të mitur dëshmitarë të veprave të ndryshme penale, ndryshe nga viti 2022 ku ka patur 26 çështje me 41 të mitur dëshmitarë.

Vihet re se numri i çështjeve ku i mituri është në cilësinë e dëshmitarit të veprës penale ka pësuar një rritje me 3% gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022. I njëjti trend rritës vihet re edhe për numrin e dëshmitarëve të mitur të veprës penale i cili është rritur me 7% gjatë vitit 2023 në krahasim me një vit më parë.

Në lidhje me pasojat në shëndet rezultojnë se janë plagosur lehtë 28 viktimat të mitur, nga të cilët 21 kanë qenë viktimat të veprës penale *''Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor''*, e parashikuar nga neni 290 i K. Penal.

Në lidhje me viktimat të plagosur rëndë 2 të mitur kanë qenë viktimat të veprës penale *''Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor''*, e parashikuar nga neni 290/2 i K. Penal.

Në lidhje me viktimat të mitur me pasojë vdekjen ka qenë një i mitur viktimë e veprës penale parashikuar nga neni 79/a i K. Penal, dhe një nga neni 290/4 i Kodit Penal.

4.8 VEPRAT PENALE KUNDËR FËMIJËVE, FAMILJES DHE MARTESËS, TË PARASHIKUARA NË SEKSIONIN XI KREU II I K.PENAL (NENET 124 - 130/a TË K.PENAL)

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve mund të themi se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve të Policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Në total gjatë vitit 2023 për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës janë referuar **157** materiale ku 30 janë mosfilluar.

Është për tu theksuar fakti se në pjesën më të madhe të referimeve të ardhura nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore vepra më e përhapur ka qenë ajo e “*Dhunës në familje*” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal dhe konkretisht **145** referime nga të cilat **23** janë mosfilluar.

Në krahasim me vitin 2022 ku ka pasur 215 referime, gjatë vitit 2023 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës, ka patur 58 materiale referuese më pak.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë vitit 2023 janë hetuar në total **192** procedime me 110 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 63 të arrestuar, procedime nga të cilat:

- 65 procedime penale me 33 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 9 të arrestuar ishin procedime të mbartura në hetim nga viti 2022;

- 127 procedime penale me 77 persona nën hetim/të pandehur, prej të cilëve 54 të arrestuar ishin procedime penale të regjistruara të reja për vitin 2023, nga këto 122 procedime me 77 persona nën hetim/të pandehur janë regjistruar për nenin 130/a;

- 30 kanë qenë mosfillime



Nga prokurorët, gjatë vitit 2023 janë kërkuar masa sigurimi për persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “*Dhuna në familje*” të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal dhe konkretisht është kërkuar masa e sigurimit “*arrest në burg*” për 54 persona.

Në lidhje me personat e hetuar për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës gjatë vitit 2023 rezulton se nga 110 persona/të pandehur të hetuar (*46 më pak se në vitin 2022 ku ishin 156 persona të hetuar*)nga të cilët :


1- të gjithë personat kanë qenë mbi 18 vjeç;

2- 101 kanë qenë meshkuj dhe 9 kanë qenë femra;

3- pjesa më e madhe me arsim 9 klasë, të papunë apo të punësuar në subjekte private.

Pra konkludohet se autori i veprave penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës gjatë vitit 2023 ti përkasë gjinisë mashkullore, mbi 18 vjeç, me arsim 9-vjeçar si dhe të papunësuar.

Gjatë vitit 2023 në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës nga prokurorët e kësaj prokurorie:



- është pushuar çështja/akuza penale për 20 procedime penale me 5 persona nën hetim/pandehur, prej të cilave 18 procedime kanë qenë për “Dhunë në Familje”.

- është shpallur moskompetenca për 3 procedime penale me 1 person në hetim.

- është kërkuar dërgimi i çështjes për gjykim për 83 procedime penale me 93 të pandehur, 52 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, të gjitha këto për veprën penale të dhunës në familje

- në total janë përfunduar 106 çështje me 98

persona në hetim/të pandehur, 52 me masë sigurimi “*arrest në burg*”

- janë mbartur për vitin 2024 gjithsej 86 procedime penale me 12 persona nën hetim/pandehur, dhe 11 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”; dhe mbeten në gjykim 44 çështje me 53 të pandehur, 19 “*arrest në burg*”.

Për veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës në total gjatë vitit 2023 ka patur 121 viktime, nga të cilët 30 meshkuj (8 të mitur – 22 të rritur) dhe 91 femra (10 të mitura – 81 të rritura)

Të dhëna për viktimat femra nga veprat penale gjatë vitit 2023

Veprat penale sipas K.Penal	Numri i viktimave femra
N.79	2
N.89	4
N. 99	2
N. 100 - 108/a	3
N.130/a	86
Vepra të tjera penale	62
Totali	159

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se numrin më të madh të viktimave femra e ka vepra penale e parashikuar nga neni 130/a i kodit Penal e ndjekur nga neni 89, neni 100-108/a dhe nenet 79 dhe 99 i Kodit Penal.

KREU 5

TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

Bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë është po aq i rëndësishëm në suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, specifikisht nga pala shqiptare në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

5.1 EKSTRADIME 2023

Përgjatë vitit 2023 nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë **3 kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit** personash të dënuar të cilat janë ekzekutuar për njerin prej tyre duke pësuar një ulje prej 19% në krahasim me një vit më parë ku janë bërë **5 kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit** personash të dënuar të cilat janë ekzekutuar.

Gjithashtu rezulton se përgjatë vitit 2023 nuk kemi asnjë kërkesë për ekstradim për jashtë shtetit ndërsa gjatë vitit 2022 janë bërë **3 kërkesa për ekstradim për jashtë shtetit** dhe nga gjykata është vendosur ekstradimi për 1 person si dhe janë



5.2 LETËRPOROSITË



Rastet e mbetura nuk disponojnë ende një vendim.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë në gjykatë **44 kërkesa për ekzekutim të letërporosive të ardhura nga autoritet e huaja** dhe nga gjykata janë ekzekutuar gjithsej 15 letërporosi, për 6 letërporosi rezulton se ka qenë e pamundur që të ekzekutohen për shkaqet se :

- 1- për subjektin nuk ka të dhëna të mjaftueshme
- 2- subjekti nuk ndodhej në Shqipëri
- 3- Gjykata ka vendosur Moskompetencë Tokësore.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie janë bërë në gjykatë **28 kërkesa për ekzekutim të letërporosive të ardhura nga autoritet e huaja** dhe nga gjykata janë ekzekutuar gjithsej 15 letërporosi, për 7 letërporosi rezulton se ka qenë e pamundur që të ekzekutohen për shkak se subjekti nuk ndodhej në Shqipëri ose ka ndërruar jetë. Rastet e mbetura nuk disponojnë ende një vendim.



Nga të dhënat e grafikut vihet re nuk ka asnjë ndryshim në vitin 2023 krahasuar me atë të një vitit më parë në lidhje me letërporosinë e ekzekutuara nga ana e Gjykatës, ndryshe paraqitet situata me letërporosinë e paekzekutuara të cilat kanë pësuar një ulje me 2% në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë. Gjithashtu, vihet re kemi një rritje të % të letërporosive për të cilat nuk disponohet akoma një vendim gjykate, konkretisht 24% me shumë në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë.


Letër porosi të dërguara nga prokurorët e kësaj prokurorie, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 37 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:

- 3 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 31 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë në sferën ekonomike;
- 3 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit.



Letër porosi të dërguara nga prokurorët e kësaj prokurorie, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 26 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:

- 1 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 11 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- 14 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit.



Nga të dhënat e paraqitura në grafikun Nr..... rezulton se *letërporositë dërguar nga prokurorët e Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për veprat penale kundër pasurisë në sferën ekonomike kanë pësuar një rritje me 32% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë, i njëti trend rritës vihet re edhe për veprat penale kundër jetës dhe personit të cilat kanë pësuar një rritje me 3%. Në lidhje me veprat penale kundër autoritetit të shtetit vihet re një ulje prej 17% në vitin 2023 të letërporosive të dërguar nga prokurorët në krahasim me vitin 2022.*

5.3 NJOHJET E VENDIMEVE PENALE 2023

Pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan **rejulton se gjatë vitit 2023, Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja** rezulton të kenë qenë 7, ku nga gjykata është njohur vendimi i dënimit të dhënë nga autoritetet e huaja për njërin nga rastet. Nuk ka patur raste që nga prokurorët e kësaj prokurorie të jetë kërkuar njohja e vendimit penal të dhënë nga autoriteti gjyqësor shqiptar.

Gjithashtu, bashkëpunimi me autoritetet e huaja është shfaqur edhe në drejtim të transferimit të procedimeve penale prej tyre dhe të rregjistruara në prokurorinë tonë si dhe shpalljeve në kërkim ndërkombëtar.

Ndërsa gjatë vitit 2022, *Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja* rezultojnë të ketë qenë 1 ku nga gjykata është njohur vendimi i dënimit të dhënë nga autoritetet e huaja.

Gjithashtu, nuk ka patur raste që nga prokurorët e kësaj prokurorie të jetë kërkuar njohja e vendimit penal të dhënë nga autoriteti gjyqësor shqiptar.


5.4 TRANSFERIME TE DËNUARISH

Mbështetur në Nenin 78 të Ligjit Nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në VKM Nr.209 datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Urdhërit Nr.8927/1 Prot datë 27.09.2018, të Ministrit të Drejtësisë “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale” janë miratuar *126 transferime të dënuarish*.

5.5 SHPALLJET/HEQJET NGA KËRKIMI NDËRKOMBËTAR

Përgjatë vitit 2023 janë realizuar *4 Urdhër kërkim ndërkombëtar* dhe *4 Heqje kërkimi ndërkombëtar* pasi Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka

vendosur për dy raste parashkrimin e ekzekutimit të vendimit penal, një rast shuarje dënimi dhe për një tjetër është realizuar arrestimi i të dënuarit.



KREU 6 TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

6.1 TË DHËNA PËR NGARKESEN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT

Në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për vitin 2023 duhej të ushtronin funksionin e prokurorit 20 prokuror, por për shkak të shkarkimeve të vettingut, numri i prokurorve të cilët kanë ushtruar funksionin ka qenë i reduktuar. Konkretisht përgjatë vitit 2023 kanë ushtruar funksionin e prokurorit 18 prokurorë. Konkretisht, një prokuror është komanduar në KLP, 3 janë transferuar, 2 janë shkarkuar nga vettingu dhe 1 ka dhënë dorëheqjen si dhe kanë ardhur 3 prokurorë dhe është rikthyer në pozicionin e tij një prokuror i cili ishte i komanduar në Prokurorinë e Pogradecit.

Në fund të dhjetorit të vitit 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kanë ushtruar efektivisht funksionin e prokurorit 12 prokuror si dhe 1 prokuror i komanduar pranë KLP-së.

Përgjatë vitit 2023 janë hetuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan 3800 procedime penale, nga të cilat 598 prokurori ka dal me vendimarrje Mosfillim procedimi, për 510 ka vendosur pezullimin, 101 procedime pushim e tyre, për 382 procedime penale i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë për pushim.

Gjithashtu, rezulton se për 608 procedime penale i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, për 37 procedime ka vendosur moskompetencën dhe përcjell aktet prokurorisë kompetente.

Aktualisht, nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë në hetim 1654 procedime penale.



NGARKESA HETIMORE V.2022-2023




Ngarkesa totale e materialeve të hetuara nga prokurorët e Prokurorisë pranë gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të cilët kanë ushtruar funksionin e tyre pranë kësaj prokurorie përgjatë vitit 2023 ka qenë **3800** përkundrajt 3891 gjatë vitit 2022.

Vihet re një ulje me 2% gjatë vitit 2023 të ngarkesës hetimore në krahasim me një vit më parë.


Vihet re ngarkesa e prokurorve të cilët kanë ushtruar funksionin e tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan gjatë periudhës 2022-2023 ka pësuar ngritje të konsiderueshme të materialeve të hetuara nga ana e prokurorve të kësaj prokurorie. Arsyet e një rritje të tillë të ngarkesës janë për shkak të ngarkesës të mbartuar nga ana e tyre nga një vit më parë, të materialeve të marra nga ana e tyre për shkak të largimeve/trasferimeve të kolëgëve si dhe materialeve të shortuara (të reja).

Një mbi ngarkesë e tillë i atribuohet edhe faktit që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë po punon me numër të reduktuar të prokurorve të cilët ushtrojnë funksionin e tyre efektivisht në këtë prokurori.

NGARKESA TOTALE E PROKURORËVE PËR VITIN 2023 KRAHASUAR ME VITIN 2022



PROCEDIME PENALE TË HETUARA VITI 2022-2023



në krahasim me vitin 2022.

Vihet re vendimet e mosfillimit kanë pësuar një rritje me 2% gjatë vitit 2023 krahasuar me të një vit më parë ndërsa në lidhje me vendimet e pezullimit, pushimit dhe kërkesat për pushim nuk vihet re ndonjë ndryshim krahasuar me një vit më parë.

Gjithashtu, vihet re një ulje e % së kërkesave për dërgimin e çështjes në gjyq konkretisht me 2% më pak në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë. I njëjti trend zbritës vihet re edhe për procedimet penale të cilat janë në hetim. Gjzatë vitit 2023 kemi 2% më pak procedime penale të mbetura në hetim

Gjatë vitit 2023, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilësisë së punës së kryer nga prokurorët, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë:

1. Drejtuesi i Prokurorisë Kreshnik AJAZI

Edhe përgjatë vitit 2023 nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është vijuar të mbahet një ngarkesë hetimore dhe në gjykim. Angazhimi i tij ka qënë rrjedhojë e solidarizimit me trupën e prokurorëve në kushte mbingarkesë në punë për shkak të vakancave në prokurorë.

Drejtuesi i Prokurorisë është përfshirë në shortimin elektronik të ndarjes së materialeve, në rishpërndarjen e çështjeve penale si dhe në grafikun e gatishmërisë për muaj të caktuar.

Hetimet e kryera nga Drejtuesi i Prokurorisë janë kryer me hetime pro-aktive dhe për çështje që kanë pasur sensibilitet të lartë publik, duke marrë kështu përgjegjësitë e tij si titullar.

Nga ana e prokurorit Kreshnik Ajazi janë drejtuar, udhëhequr dhe finalizuar operacionet mbarëkombëtare “Never Forget”, “Rrjeti” dhe “Tempulli 1”. Në këto procedime penale janë arrestuar një numër shumë i madh autorësh të dyshuar të veprave penale dhe veprimtaria e prokurorit është gjetur e drejtë dhe konfirmuar nga gjykata.

Në operacionin “Never Forget” u asgjësua një grup kriminal me rrezikshmëri të lartë dhe theksuar shoqërore që përbëhej nga 16 persona, në drejtim të së cilëve u nxorrën urdhërat e ndalimit. Personat nën hetim kanë qënë të përfshirë në vepra shumë të rënda kriminale si vrasje, vrasje me gjakmarrje, vrasje për motive interesi, shkatërrim të pronës me eksploziv, vjedhje me armë etj. U nxorr urdhëri i ndalimit për personin nën hetim L.H dhe bashkëpunëtorët e tij me rrezikshmëri të lartë shoqërore M.T, B.B, M.T, L.R, L.S etj. U zbardhën 4 ngjarje të rënda kriminale që kishin të bënin me vrasjen e viktimave në disa qytete të vendit dhe vecanërisht vrasjet e ndodhura në qarkun e Elbasanit në vitin 2021 të viktimave A.S dhe A.B. Në këtë

procedim nga ana e prokurorit K.Ajazi u arrit që një shtetas të tërhiqej në bashkëpunim si bashkëpunëtor i drejtësisë.

Në operacionet “Rrjeti” dhe “Tempulli 1” u shpartalluan disa grupe kriminale të përfshira në veprimtarinë kriminale të shitjes dhe shpërndarjes së lëndëve të ndryshme narkotike, kryesisht në ambiente të hapura për publikun si dhe afërsi të institucioneve arsimore. U ndaluan dhe arrestuan rreth 80 persona nën hetim, ku të gjitha masat u deklaruan të ligjshme nga gjykata. U ndaluan duke aplikuar metoda speciale hetimi të tilla si vënia në veprim e agjentit në mbulim, blerja e simuluar e sendeve të kundërligjshme dhe vëzhgimet/përgjimet etj, persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore si E.S, H.Gj, K.I, S.S etj të cilët edhe në disa raste të tjera i kishin shpëtuar goditjes së ligjit.

Drejtuesi i Prokurorisë ka vijuar përfaqësimin në gjykim të akuzave të rënda penale ndaj disa të pandehurve me rekorda të rënda kriminale të tillë si E.LI, M (A).T, B.R, G.B, G.H të akuzuar për veprën penale të vrasjes.

Prokurori K.Ajazi ka përfunduar procedurën e njohjes dhe transferimit nga Mbretëria e Bashkuar për në Shqipëri të një personi me rrezikshmëri shoqërore (K.C) të dënuar nga autoritetet britanike të drejtësisë për vepra penale në fushën e narkotikëve. Për këtë ka marrë edhe falenderimin nga pala britanike në takim të drejtpërdrejtë si transferimi i parë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes mes RSH dhe MB.


Nga ana e prokurorit Kreshnik Ajazi janë dërguar në SPAK për kompetencë hetimi disa procedime penale dhe pasurore të tilla si procedimi në ngarkim të L.H, M.T etj të akuzuar për veprën e vrasjes dhe krijimit të grupit të strukturuar kriminal etj, në ngarkim të K.C për veprën e korrupsionit në zgjedhje, ndaj E.B për veprën e trafikimit të narkotikëve dhe krijimit të grupit të strukturuar kriminal etj, ndaj F.G për veprën e pastrimit të produkteve të veprës penale, si dhe disa procedime pasurore në ngarkim të personave me rrezikshmëri të theksuar si T.Ç, H.B, F.G, L.H etj.

Po ashtu prokurori K.Ajazi ka në hetim disa procedime penale që i përkasin ngjarjeve të rënda kriminale të ndodhura gjatë kësaj periudhe ose të rifilluara të tilla si vrasja e L.B dhe A.C, rrëmbimi i R.H, rrëmbimi i A.C, vjedhja me pasojë vdekjen e Z.K etj.

Drejtuesi i Prokurorisë ka filluar procedime penale kryesisht për këto vepra penale :

- *“Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 319 në lidhje me nenin 25 të K.Penal*
- *“Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete” të parashikuar nga neni 295/a i K.Penal*
- *“Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës” të parashikuar nga neni 201 i K.Penal*
- *“Shkatërrim i pronës”, “Fshehje e të ardhurave”, “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës” dhe “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga nenet 150, 180, 201 dhe 248 të K.Penal*
- *“Shkatërrim i pronës”, “Fshehje e të ardhurave”, “Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës” dhe “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga nenet 150, 180, 201 dhe 248 të K.Penal*


PROCEDIME PENALE TË HETUARA VITI 2023




Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e drejtuesit të prokurorisë përgjatëvitit 2023 ka qenë 95 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 9 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 24 procedime vendim pezullimi, për 1 procedime penal ka vendosur pushim, për 4 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 23 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, për 10 procedim ka vendosur moskompetencë dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente si dhe ka patur në hetim 3 referime pasurore. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 drejtuesi i prokurorisë ka në hetim 21 procedime penal.

Gjithashtu, rezulton se ngarkesa hetimore ka pësuar një rritje me 54% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.

Ngarkesa hetimore v.2022-2023




PROCEDIME PENALE TË HETUARA VITI 2022-2023



Nga të dhënat e grafik rezulton se vendimet e mosfillimit kanë pësuar një rritje me 7% , me 18% pezullimet, 1% pushimet, me 3% kërkesat për pushim, si dhe me 16% kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq. Gjithashtu rritje kanë pësuar edhe vendimet mbi moskompetencën me 4% ndërsa procedimet e mbetura në hetim kanë pësuar një ulje me 4% gjatë vitit 2023 krahasuar me atë të një viti më parë.


2. ZV/ Drejtuesi i Prokurorisë Xhelian SEFERI

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatëvitit 2023 ka qenë 433 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 61 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 81 procedime vendim pezullimi, për 3 procedime penal ka vendosur pushim, për 38 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezultojnë se për 74 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, për 1 procedim ka vendosur moskompetencë dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente. Ndër të tjera rezultojnë se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 175 procedime penal.




Gjithashtu, rezultojnë se ngarkesa hetimore ka pësuar një rritje me 24% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezultojnë se vendimet e mosfillimit dhe pezullimet kanë pësuar respektivisht një rritje me 6% në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë. Kërkesat për pushim, ato për dërgimin e çështjes në gjyq si dhe procedimet e mbartura kanë pësuar një rritje të vogël në 2023 krahasuar me vitin 2022, përkatësisht me 3%.




3. Drejtuese Seksionit Edlira BAKO



Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 199 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 35 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 22 procedime vendim pezullimi, për 2 procedime penal ka vendosur pushim, për 28 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezultojnë se për 40 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, për 3 procedime ka vendosur moskompetencë dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente. Ndër të tjera rezultojnë se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 69 procedime

penal.



Gjithashtu, rezultojnë se ngarkesa hetimore ka pësuar një rritje me 9% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.



Nga të dhënat e grafikut rezultojnë se vendimet e mosfillimit, pezullimet, pushimet dhe kërkesat për pushim nuk kanë pësuar asnjë ndryshim në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë. Kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq si dhe procedimet e mbartura kanë pësuar një rritje të vogël në 2023 krahasuar me vitin 2022, përkatësisht me 1% për kërkesat e dërgimit të çështjes në gjyq dhe 6% për procedimet në hetim.


4. Drejtuese Seksionit Pranvera STAFA

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 239 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 49 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 21 procedime vendim pezullimi, për 11 procedime penal ka vendosur pushim, për 73 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 42 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 43 procedime penal.




Gjithashtu, rezulton se ngarkesa hetimore ka pësuar një rritje me 18% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se vendimet e mosfillimit, pushimet dhe kërkesat për pushim kanë pësuar rritje në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë, përkatësisht mosfillimet me 3%, pushimet me 2% dhe kërkesat për pushim me 13%. Vendimet në lidhje me pezullimit nuk kanë pësuar asnjë ndryshim në krahasim me një vit më parë. Kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq kanë pësuar një ulje me 2% në 2023 krahasuar me vitin 2022 ndërsa procedimet në hetim kanë pësuar një rritje me 3% në vitin.




5. Prokuror Petref ASLLANI




Nga të dhënat e paraqitura në grafikun vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 364 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 49 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 70 procedime vendim pezullimi, për 10 procedime penal ka vendosur pushim, për 45 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezultojnë se për 64 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ndër të tjera rezultojnë se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 126 procedime penal.

Gjithashtu, rezultojnë se ngarkesa hetimore ka pësuar një ulje me 6% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.



Nga të dhënat e grafikut rezultojnë se vendimet e mosfillimit kanë pësuar ulje në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë, përkatësisht me 3%. Pezullimet dhe kërkesat për pushim kanë pësuar një rritje përkatësisht me 1% gjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë. Vendimet për pushim nuk kanë pësuar asnjë ndryshim përgjatë dy viteve ndërsa kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq kanë pësuar një ulje me 3% në 2023 krahasuar me vitin 2022. Procedimet në hetim të kanë pësuar një rritje me 8% në vitin 2023.


6.Prokuror Zena LILA



Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 98¹⁵ procedime penale të hetuara, nga të cilat për 16 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 35 procedime vendim pezullimi, për 17 procedime penal ka vendosur pushim, për 8 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 64 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq si dhe për 2 procedime ka vendosur moskompetencën dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024

prokurori ka në hetim 10 procedime penal.

Gjithashtu, rezulton se ngarkesa hetimore ka pësuar një ulje me 64% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.




Nga të dhënat e grafikut rezulton se kanë pësuar ulje në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë, vendimet e mosfillimit 4%, pezullimet me 5%, kërkesat për pushim me 8%, kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq me 18% dhe procedimet penale në hetim me 29% vetëm vendimet e pushimit kanë pësuar një rritje me 1% gjatë vitit 2023.

¹⁵ Ngarkesa e ulët e prokurorë Zena Lila vjen si rezultat se prokurorja gjatë vitit 2023 në periudhën 15.05.2023-26.10.2023, pas kësaj periudhe ka ezauruar edhe lejen e zakonshme.

7. Prokurore Rajmonda BERISHA


Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 411 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 116 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 48 procedime vendim pezullimi, për 7 procedime penal ka vendosur pushim, për 34 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 71 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq si dhe për 4 procedime ka vendosur moskompetencën dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 131 procedime penal.




Gjithashtu, rezulton se ngarkesa hetimore ka pësuar një rritje me 4% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se kanë pësuar rritje në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë, vendimet e mosfillimit 2%, kërkesat për pushim me 1%.

Pezullimet kanë pësuar një ulje me 2% gjatë vitit 2023, pezullimet nuk kanë pësuar asnjë ndryshim sikurse edhe pushimet, kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq kanë pësuar ulje me 8% dhe procedimet penale në hetim kanë pësuar rritje me 4% gjatë vitit 2023 në krahasim me atë të një viti më parë.




8.Prokuror Artur ISMAILUKAJ



Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 229 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 43 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 31 procedime vendim pezullimi, për 5 procedime penal ka vendosur pushim, për 27 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 39 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq si dhe për 5 procedime ka vendosur moskompetencën dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente. Ndër të tjera

rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 79 procedime penal.

Gjithashtu, rezulton se ngarkesa hetimore ka pësuar njërritje me 32% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.




Nga të dhënat e grafikut rezulton se kanë pësuar rritje në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë, vendimet e mosfillimit 6%, pezullimet me 3%,pushime me 1 %, kërkesat për pushim me 2%, kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq me 5% dhe procedimet penale në hetim me 11% vetëm vendimet e moskompetencës nuk kanë pësuar asnjë ndryshim gjatë dy viteve.


9. Prokuror Neritan HOXHA

Me vendimin Nr 82 dt. 24.04.2023 të KLP-së prokuror Neritan Hoxhës I ndërpritet komandimi si drejtues i Prokurorisë Pogradec dhe ri-kthehet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksiomit të Përgjithshëm Elbasan për të ushtuar funksionin e tij si prokuror pranë kësaj prokurorie.

Nga të dhënat e paraqitura në Grafikun Nr. ___ vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 299 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 38 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 22 procedime vendim pezullimi, për 4 procedime penal ka vendosur pushim, për 22 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 58 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 155 procedime penal.



10. Prokuror Durim BEDINI



Me Vendimin Nr 82, dt.24.04.2023 të KLP-së prokuror Durim Bedini është transferuar nga Prokuroria e Kavajës për të ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksiomit të Përgjithshëm Elbasan.

Nga të dhënat e paraqitura në Grafikun Nr. ___ vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 248 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 38 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 22 procedime vendim pezullimi, për 6 procedime penal ka vendosur pushim, për 34 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 32 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 116 procedime penal.

11. Prokuror Glenda ZENELI

Me Vendimin Nr 258 dt.10.07.2023 KLP-së prokuror Glenda Zeneli është emëruar për të ushtruar funksionin e tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Nga të dhënat e paraqitura në Grafikon Nr. ___ vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 155 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 29 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 2 procedime vendim pezullimi, për 2 procedime penal ka vendosur pushim, për 7 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 9 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 106 procedime penal.





12. Prokuror Ermira MANELLI



Trasferuar nga Prokuroria Gjirokastrer në Prokurorinë Elbasan me Vendimin Nr 240 dt 03.07.2023 të KLP-së, ku ka qëndruar e komanduar në Prokurorinë Gjirokastrer deri më dt. 30.09.2023. Pas mbarimit të komandimit më dt. 01.10.2023 ka filluar të ushtroj funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Nga të dhënat e paraqitura në Grafikon Nr. ___ vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 60 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 5 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 1 procedime vendim pezullimi, për 10 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 3 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 38 procedime penal.


13. Prokuror Hektor MUSHI

ga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit përgjatë vitit 2023 ka qenë 826 procedime penale të hetuara, nga të cilat për 38 materiale hetimore ka marrë vendim për mosfillim, 37 procedime vendim pezullimi, për 10 procedime penal ka vendosur pushim, për 48 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 116 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq si dhe për 2 procedime ka vendosur moskompetencën dhe dërgimin aktet prokurorisë kompetente. Ndër të tjera rezulton se në vitin 2024 prokurori ka në hetim 585 procedime penal.



Gjithashtu, rezulton se ngarkesa hetimore ka pësuar një rritje me 8% përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.


Nga të dhënat e grafikut rezulton se kanë pësuar rritje në vitin 2023 krahasuar me atë të një viti më parë, vendimet e mosfillimit, pezullimet, pushimet, si dhe dosjet e mbetura në hetim, respektivisht me 1% ndërsa kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq kanë pësuar një rritje me 3% gjatë vitit 2023.



14. Prokuror Mustafa TURKU

Prokuror Mustafa Turku ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan deri më dt.26.10.2023 kur është shkarkuar nga KPK me vendimin datë 26.10.2023.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e prokurorit nga 1 janar 2023 e deri në momentin e shkarkimit të tij nga KPK-ja ka marrë vendim për mosfillim për 18 materiale hetimore, 3 procedime vendim pezullimi, për 5 procedime penal ka vendosur pushim, për 1 procedime i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 19 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.





Prokurori ka dorzuar pas shkarkimit të tij nga KPK-ja 856 materiale, prej të cilave 11, kallzime penale, 188 procedime penale në fazën e hetimit, 73 procedime në fazë gjykimi, 50 procedime (Kërkesa për pushim / parashkrime që ndodhen në gjykim), 390 procedime penale / parashkrime në fazë hetimi, 2 referime pasurore si dhe 142 gjykime të tjera.

15. Prokuror Arbër BEREXHA

Me vendimin nr.130 dt 07.06.2023) të KLP-së prokuror Arbër Berexha është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të ushtruar funksionin e tij si prokuror pranë kësaj prokurorie.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun vihet re se ngarkesa e prokurorit nga 1 janar 2023 e deri në momentin e transferimit të tij ka marrë vendim për mosfillim për 30 materiale hetimore, 38 procedime vendim pezullimi, për 5 procedime penal ka vendosur pushim. Gjithashtu, rezulton se për 3 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.



Prokurori ka dorzuar pas transferimit të tij 456 materiale, prej të cilave 83 procedime penale në fazën e hetimit, 76 procedime në fazë gjykimi, 50 procedime (Kërkesa për pushim / parashkrime që ndodhen në gjykim), 240 procedime penale / parashkrime në fazë hetimi, 2 referime pasurore si dhe 2 gjykime të tjera.

16. Prokuror Gentian HABAZAJ

Me vendimin nr.44 dt 23.02.2023 është komanduar në KLP.

Prokurori ka dorzuar pas komandimit të tij 264 materiale, prej të cilave 105 procedime penale në fazën e hetimit, 32 procedime në fazë gjykimi, 8 procedime (Kërkesa për pushim / parashkrime që ndodhen në gjykim), 115 procedime penale / parashkrime në fazë hetimi, si dhe 3 gjykime të tjera.



17. Prokuror Ritvan SUKA



Me vendimin nr.123 dt 29.05.2023 të KLP-së, prokuror Ritvan Suka është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të ushtruar funksionin e tij si prokuror pranë kësaj prokurorie.

Nga të dhënat e paraqitura në Grafikon Nr.____ vihet re se ngarkesa e prokurorit nga 1 janar 2023 e deri në momentin e transferimit të tij ka marrë vendim për mosfillim për 6 materiale hetimore, 35 procedime vendim pezullimi, për 2 procedime penal ka vendosur pushim. Gjithashtu, rezulton se për 1 procedim ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës

me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

Prokurori ka dorzuar pas transferimit të tij 381 materiale, prej të cilave, 4 kallzime penale, 139 procedime penale në fazën e hetimit, 45 procedime në fazë gjykimi, në, 40 procedime (Kërkesa për pushim / parashkrime që ndodhen në gjykim), 148 procedime penale / parashkrime në fazë hetimi, 3 referime pasurore si dhe 2 gjykime të tjera.



18.Prokuror Platin ALIÇKA




Me vendimin nr.125 dt 29.05.2023 të KLP-së, prokuror Platin Aliçka është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të ushtruar funksionin e tij si prokuror pranë kësaj prokurorie.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun vihet re se ngarkesa e prokurorit nga 1 janar 2023 e deri në momentin e transferimit të tij ka marrë vendim për mosfillim për 16 materiale hetimore, 18 procedime vendim pezullimi, për 11

procedime penal ka vendosur pushim dhe për 1 procedim ka paraqitur kërkesë për pushim. Gjithashtu, rezulton se për 3 procedime ka ngritur akuzë duke i'u drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

Prokurori ka dorzuar pas transferimit të tij 536 materiale, prej të cilave, 4 kallzime penale, 60 procedime penale në fazën e hetimit, 62 procedime në fazë gjykimi, në, 38 procedime (Kërkesa për pushim / parashkrime që ndodhen në gjykim), 203 procedime penale / parashkrime në fazë hetimi, 3 referime pasurore si dhe 166 gjykime të tjera




6.2 TË DHËNA PËR NGARKESEN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE TË SEKSIONEVE

Përgjatë vitit 2023 në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kanë ushtruar funksionin e oficerëve të seksionit 13 oficerë të policisë gjyqësore, I njëjti numër që ka qenë edhe përgjatë vitit 2022.

Konkretisht, gjatë vitit 2023 janë transferuar nga prokuroritë e rretheve 3 (tre) oficerë të policisë gjyqësore si dhe janë transferuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan 4 (katër) oficer policie gjyqësore.

Nga të dhënat e rezultuara nga regjistri elektronik i kësaj prokurorie dhe nga të dhënat statistikore të mbajtura nga vet oficerët rezulton se ngarkesa e përgjithshme që kanë mbuluar oficerët e seksioneve në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për vitin


2023 ka qenë 1575 procedime penale të deleguara ndërsa në vitin 2022 ka qenë 1217 procedime.



Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re përgjatë vitit 2023 procedimet penal të deleguara për hetim oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve janë rritur me 12% në krahasim me një vit më parë.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se nga numri total I procedimeve penale të deleguara nga ana e prokurorit të çështjes oficerëve të seksioneve vihet re, një rritje të numrit të përqindjes nga viti 2022 në vitin 2023.

Konkretisht, kemi rritje me 2 % të procedimeve penale ku O.P.Gj-të e seksioneve kanë sugjeruar pushimin e procedimeve penale të hetuara. I njëjti trend vihet re edhe me pezullimet, numri I të cilave vjen në rritje me 5 % krahasuar me një vit më parë, kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim me 8% me tepër në krahasim me vitin 2022.



Gjithashtu rezulton se kemi rritje prej 1% të procedimeve penale në krahasim me vitin 2021, të cilat aktualisht janë në hetim nga ana e oficerëve.

Një situatë e tillë I atribuohet rritjes së ngarkesës së O.P.Gj-ve të seksioneve e cila siç u citua më sipër është rritur me 12% në krahasim me vitin 2022.

Gjatë vitit 2023 treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilësisë të punës së kryer nga oficerët e policisë gjyqësore, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë:


1. O.P.Gj Altin XHETANI

Nga të dhënat e paraqitura në grafik re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 151 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 34 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 7 pezullimi, për 58 kërkesë për gjyq, për 3 procedime moskompetencë si dhe 8 referime. Rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 49 procedime penal.



Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara ka mbetur e njëjtë përgjatë vitit 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri referimeve, I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre si dhe i pezullimeve kanë pësuar një rritje respektivisht me 1% të një viti më parë. Sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë kanë pësuar një ulje me 5% gjatë vitit 2023 në krahasim të një viti më parë ndërsa procedimet penale të mbartura kanë pësuar një rritje me 2% gjatë vitit 2023 në krahasim me atë të një viti më parë. Sugjerimet për moskompetencë të procedimit penal kanë qenë të njëjta në të dy vitet.





2. O.P.Gj Armanda SHAHINI



Nga të dhënat e paraqitura në grafikun vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 71 çështje totale të hetuar nga ana e saj. Konkretisht për 10 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 1 pezullimi, për 8 kërkesë për gjyq, për 1 procedim moskompetencë si dhe 22 referime. Rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 19 procedime penal. *Sugjeruar ne 3-tre raste vendosja e masave me karakter pasuror sipas Ligjit nr.10192 dt.03.12.2009.*

Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është rritur me 12% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.



Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre ka pësuar një rritje prej 2% nga një vit në parë, ndryshe nga pezullimet të cilat nuk kanë pësuar asnjë ndryshim krahasuar me atë të një viti më parë. Ndërsa sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë kanë pësuar një rritje me 1% të një viti më parë. I njëjti trend vihet re edhe me procedimet e mbartura të cilat kanë pësuar një rritje prej 11% të një viti më parë, referimet me 9%.


3. O.P.Gj Anila Dusha

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 158 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Koncretisht për 40 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 50 pezullimi, për 68 kërkesë për gjyq, për 0 procedime moskompetencë si dhe 25 referime. Rezulton se në vitin 2024 oficeri nuk ka të mbartur asnjë procedim penal procedime penal.



Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është rritur me 62% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre është rritur me 12% nga një vit në parë, sikurse edhe pezullimet të cilat kanë pësuar një rritje me 18% krahasuar me atë të një viti më parë. Ndërsa sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë kanë pësuar një rritje me 21% të një viti më parë. Në lidhje me procedimet e mbartura rezulton se nuk ka asnjë procedim të mbartur nga viti 2023. Rritje me 3% kanë pësuar edhe referimet krahasuar me atë të një viti më parë.





4. O.P.Gj Dr.Lorena MUSAI




Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 98 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 24 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 6 pezullimi, për 26 kërkesë për gjyq, si dhe 3 referime. Rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 32 procedime penale.

Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është ulur me 2% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.




Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre është rritur me 2% sikurse edhe pezullimet. Sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë kanë pësuar një ulje me 4% të një viti më parë. I njëjti trend vihet re për moskompetencat dhe referimet ndërsa hetimet e mbartura kanë pësuar një rritje me 3% të një viti më parë.

5. O.P.Gj Nevrus NDREGJONI



Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 121 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 32 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 27 pezullimi, për 27 kërkesë për gjyq, për 0 procedime moskompetencë si dhe 30 referime. Rezulton se në vitin 2023 oficeri ka të mbartura 35 procedime penale.

Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është rritur me 36% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.



Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre nuk ka pësuar asnjë ndryshim, ndërsa pezullimet kanë pësuar një rritje me 8%, krahasuar me atë të një viti më parë. Ndërsa sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë për dërgimin e çështjes në gjyq kanë pësuar një rritje me 8% të një viti më parë. I njëjti trend vihet re edhe për referimet të cilat kanë pësuar një rritje prej 7% të një viti më parë sikurse edhe procedimet e mbartura të cilat kanë pësuar një rritje me 13% në krahasim me një vit më parë.


6. O.P.Gj Rasim GUZI

Nga të dhënat e paraqitura në Grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 132 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 50 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 15 pezullimi, për 30 kërkesë për gjyq, për 0 procedime moskompetencë si dhe 9 referime. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 28 procedime penale.





Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është rritur me 4% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre kanë pësuar një rritje me 5% , sikurse edhe pezullimet kanë pësuar po të njëjtën rritje, krahasuar me atë të një viti më parë. Ndërsa sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë për kanë pësuar një ulje me 10% të një viti më parë. Në lidhje me një vit më parë procedimet e mbartura kanë pësuar një rritje prej 2% .




7. O.P.Gj Petrit CAKU

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 116 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 26 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 12 pezullimi, për 42 kërkesë për gjyq, për 0 procedime moskompetencë si dhe 13 referime. Rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 34 procedime penale.




Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është rritur me 8% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi nuk ka pësuar ndryshim ndërsa pezullimet kanë pësuar një ulje me 1%, krahasuar me atë të një viti më parë. Ndërsa sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë kanë pësuar një rritje me 3% të një viti më parë. Në lidhje me një vit më parë procedimet e mbartura kanë pësuar një ulje me 2% në krahasim me një vit më parë ndërsa referimet një rritje me 7% .




8. O.P.GJ Laureta FUSHA

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 207 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Koncretisht për 54 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 40 pezullimi, për 105 kërkesë për gjyq, për 4 procedime moskompetencë. Rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 38 procedime penale.



Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara gjatë vitit 2023 është rritur me 8% krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve përgjatë vitit 2023 ku është sugjeruar pushimi I tyre kanë pësuar një rritje me 7% , një rritje me 4% pezullimet, po të njëjtën rritje kanë pësuar sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë krahasuar me atë të një viti më parë. Kanë pësuar një ulje me 1 % sugjerimet për shpalljen e moskompetencës gjatë vitit 2023 ndërsa procedimet e mbartura kanë pësuar një rritje me 1 % në krahasim me një vit më parë.




9. O.P.Gj Xhaferr MUHA

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 128 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Koncretisht për 16 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 3 pezullimi, për 41 kërkesë për gjyq, për 1 procedime moskompetencë si dhe 24 referime. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 41 procedime penale.



Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është rritur me 5% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.



një ulje me 5% gjatë vitit 2023.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikrezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga një vit në tjetrin, ndërsa pezullimet kanë pësuar një ulje me 4%, krahasuar me atë të një viti më parë. Sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë për kanë pësuar një rritje me 12% gjatë vitit 2023 në krahasim me atë të një viti më parë. Në lidhje me një vit më parë procedimet e mbartura kanë pësuar


10. O.P.Gj Fjoralba MEMIA

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 180 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 38 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 51 pezullimi, për 67 kërkesë për gjyq, për 0 procedime moskompetencë si dhe 16 referime. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 34 procedime penale.



Gjithashtu, rezulton se ngarkesa e procedimeve penale të hetuara është ulur me 2% në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë.

Nga të dhënat e grafikut rezulton se numri I procedimeve ku është sugjeruar pushimi I tyre kanë pësuar një ulje me 2% , pezullimet një rritje me 5%, krahasuar me atë të një viti më parë. Ndërsa sugjerimet për të dërguar procedimin penal duke ngritur akuzë për kanë pësuar një rritje me 4% të një viti më parë. Në lidhje me një vit më parë procedimet e mbartura janë rritur me 7% në krahasim me një vit më parë ndërsa referimet janë ulur me 2%.



11. O.P.Gj Hasan ASLLANI

Transferuar me vendimin Nr.59 datë 24.04.2023 të KPGJ-së në Prokurorinë Pranë Gjykatës



së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Komandohet në Prokurorinë e Beratit deri më datë 31.10.2023 ndërpritet komandimi dt 01.11.2023 dhe kthehet në Prokurorinë e Elbasanit për të ushtruar funksionin e tij si officer I policisë Gjyqësore.


Rezulton se oficeri I policisë gjyqësore ka patur një ngarkesë të vogël prej 2 procedimeve gjatë vitit 2023, nga të cilët për 1 procedim ka sugjeruar aplikim nga shmangia penale dhe për një tjetër

dërgimin e ëështjes në gjyq duke ngritur akuzë.

12. O.P.Gj Drini PASHO

Trasferuar me vedimin Nr.75 datë 24.04.2023 të KPGJ-së, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për të ushtuar funksionin e oficerit të policisë gjyqësore.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 93 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 17 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 19 pezullimi, për 48 kërkesë për gjyq, për 3 procedime moskompetencë si dhe 6 referime. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 114 procedime penale.



13. O.P.Gj Armino VISHAJ

Trasferuar me vendimin Nr.72 dt.24.04.2023 të KPGJ-së, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për të ushtuar funksionin e oficerit të policisë gjyqësore.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vihet re se ngarkesa e oficerit të policisë gjyqësore përgjatë vitit 2023 të jetë 118 çështje totale të hetuar nga ana e tij. Konkretisht për 5 prej tyre është sugjeruar pushimi I procedimit, për 10 pezullimi, për 58 kërkesë për gjyq, për 2 procedime moskompetencë si dhe 18 referime. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2024 oficeri ka të mbartura 43 procedime penale.




KREU 7 INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

7.1 STRUKTURA ORGANIKE

Në referim të shkresave nr.69/13 prot., dt.19.01.2023, nr.109/26 prot., dt.03.02.2023 dhe nr.186/4 prot., datë 22.02.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme, struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndër të tjera, përbëhej nga 25 prokurorë (1 drejtues, 1 zv.drejtues dhe 23 prokurorë).

Me shkresën nr.600/3 prot., dt.20.04.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme është përcjellë struktura e re organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pas miratimit të hartës së re gjyqësore sipas VKM nr.495, dt.21.07.2022 “Për ri-organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave”. Në këtë shkresë bëhet me dije se në zbatim të Urdhërit nr.54, dt.18.04.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të ushtrojnë funksionet 20 prokurorë (1 drejtues, 1 zv.drejtues dhe 18 prokurorë). Pra pas miratimit të hartës së re gjyqësore struktura organike në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është shkurtuar me 5 prokurorë.

Struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është si vijon :



PROKURORËT		
Nr.	Emër, mbiemër	Funksioni
1	Kreshnik Ajazi	Drejtues i Prokurorisë

2	Xhelian Seferi	Zv.Drejtues i Prokurorisë
3	Pranvera Stafa	Drejtues Seksioni
4	Edlira Bako	Drejtues Seksioni
5	Rajmonda Berisha	Prokuror
6	Petref Asllani	Prokuror
7	Artur Ismajlukaj	Prokuror
8	Zena Lila	Prokuror
9	Durim Bedini	Prokuror ¹⁶
10	Glenda Zeneli	Prokuror ¹⁷
11	Neritan Hoxha	Prokuror ¹⁸
12	Ermira Manelli	Prokuror ¹⁹
13	Gentian Habazaj	Prokuror ²⁰
14	Ritvan Suka	Prokuror ²¹ (vakant)
15	Platin Aliçka	Prokuror ²² (vakant)
16	Arbër Berexha	Prokuror ²³ (vakant)
17	<i>Elveta Murra</i>	<i>Prokuror²⁴</i>
18	<i>Binas Nina</i>	<i>Prokuror²⁵</i>
19	<i>Mustafa Turku</i>	<i>Prokuror²⁶</i>
20	<i>Hektor Mushi</i>	<i>Prokuror²⁷</i>
21	<i>Bledar Mustafaraj</i>	<i>Prokuror²⁸</i>

SEKSIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr.	Emër, mbiemër	Funksioni
1	Xhaferr Muha	Oficer i policisë gjyqësore
2	Petrit Caku	Oficer i policisë gjyqësore
3	Altin Xhetani	Oficer i policisë gjyqësore
4	Armanda Shahini	Oficer i policisë gjyqësore
5	Laureta Fusha	Oficer i policisë gjyqësore
6	Rasim Guzi	Oficer i policisë gjyqësore
7	Lorena Musai	Oficer i policisë gjyqësore
8	Fjoralba Memia	Oficer i policisë gjyqësore
9	Anila Dusha	Oficer i policisë gjyqësore
10	Nevruz Ndrejoni	Oficer i policisë gjyqësore
11	Armino Vishaj	Oficer i policisë gjyqësore ²⁹
12	Drini Pasho	Oficer i policisë gjyqësore ³⁰

¹⁶ Trasferuar me Vendimin Nr 82, dt.24.04.2023 të KLP-së nga Prokuroria e Kavajës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

¹⁷ Emëruar me Vendimin Nr 258 dt.10.07.2023 KLP prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

¹⁸ I ndërpritet komandimi si drejtues i Prokurorisë Pogradec me vendimin Nr 82 dt. 24.04.2023 të KLP.

¹⁹ Trasferuar nga Prok Gjirrokaster ne Prok Elbasan me Vendimin Nr 240 dt 03.07.2023,KLP vazhdon e komanduar në Gjirakastër deri 30.09.2023, kthehet në 01.10.2023.

²⁰ I komanduar në KLP me vendimin Nr.44 dt 23.02.2023,

²¹ Transferuar ne Prok Tiranë me vendimin Nr.123 dt 29.05.2023 të KLP-së

²² Transferuar ne Prok Tiranë me vendimin Nr.125 dt 29.05.2023 të KLP-së

²³ transferuar ne Prok Tiranë me vedimin Nr.130 dt 07.06.2023 të KLP-së

²⁴ Shkarkuar nga KPK, në proces apelimi

²⁵ Shkarkuar nga KPK, në process apelimi

²⁶ Shkarkuar nga KPK me vendimin datë 26.10.2023

²⁷ Shkarkuar nga KPK me vednimin datë 15.12.2023

²⁸ Komanduar MD larguar me dorëheqje, mbaruar statusi i magistratit me vendimin nr.316 datë 20.10.2023 të KLP-së.

²⁹ Trasferuar me vendimin Nr.72 dt.24.04.2023 të KPGJ-së, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

³⁰ Trasferuar me vedimin Nr.75 datë 24.04.2023 të KPGJ-së, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

13	Hasan Asllani	Oficer i policisë gjyqësore ³¹
14	Erion Karoli	Oficer i policisë gjyqësore (vakant)
15	Ermal Çela	Oficer i policisë gjyqësore ³² (vakant)
16	Agim Çekrezi	Oficer i policisë gjyqësore ³³ (vakant)
17	Juliana Beqiraj	Oficer i policisë gjyqësore ³⁴

ADMINISTRATA		
Nr.	Emër, mbiemër	Funksioni
1	Alketa Kurmaku	Kancelare
2	Lindita Shopi	Kryetar Dege Buxhet/Finance
3	Elida Kasa	Kryesekretare
4	Xhesi Çimo	Specialist IT
5	Armida Halili	Koordinatorë për të miturit
6	Anita Hoxha	Sekretar
7	Etleva Ballkoçi	Sekretar
8	Rozalina Terziu	Sekretar
9	Zhaneta Pashaj	Sekretar
10	Fjoralba Salla	Sekretar
11	Xhesika Latifi	Sekretar
12	Zamira Zykollari	Sekretar
13	Pamela Hoxha	Sekretar
14	Klajva Xheka	Sekretar
15	Denada Hajdini	Arkiviste
16	Enian Prifti	Shofer
17	Xhemil Fejza	Shofer
18	Armand Çanaku	Ftues
19	Rudina Pema	Sanitare
20	Nosi Prendi	Punonjës shërbimi
21	Migena Feimi	Arkiviste (me kohë të pjesshme)
22	Antoneta Shabani	Sanitare (me kohë të pjesshme)

7.1.1 ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PROKURORISË

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të detyrimeve ligjore, organizimi i brendshëm i prokurorisë është rregulluar përmes :

- Urdhër nr.1, dt.06.01.2023 “Për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
- Urdhër nr.2, dt.06.01.2023 “Mbi ndarjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”
- Urdhër nr.3, dt.06.01.2023 “Për caktimin e drejtuesve të seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”

³¹ Transferuar me vendimin Nr.59 datë 24.04.2023 të KPGJ-së në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, komandohet në Prokurorinë e Beratit deri më datë 31.10.2023 ndërpritet komandimi dt 01.11.2023.

³² Transferuar Prok Tiranë me vendimin Nr.70 dt 24.04.2023 të KPGJ-së.

³³ Transferuar Prok Përgj me vendimin Nr.36 dt 24.04.2023 të KPGJ-së.

³⁴ E komanduar në Prokurorinë e Tiranës me vendimin Nr.1 datë 06.01.2023, transferuar me vendimin Nr.31 dt 24.04.2023 të KPGJ-së.

Këto urdhëra janë ndryshuar në varësi të dinamikave që lidhen me karrierën e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

A.Ndarja e seksioneve është si vijon :

Seksioni 1

I përgjithshëm.

Ky seksion do të hetojë dhe përfaqësojë në gjykim veprat e tjera penale që nuk janë në kompetencë lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe të seksioneve të tjera të kësaj prokurorie, të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhëri.

Seksioni 2

I posaçëm kundër pastrimit të produkteve të veprës penale, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore.

Ky seksion do të hetojë dhe përfaqësojë në gjykim veprat penale të mëposhtme :

- Veprat penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” parashikuar nga neni 135 i K.Penal, “Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit” parashikuar nga neni 136 i K.Penal;
- Veprat penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike” parashikuar nga neni 137 i K.Penal, “Vjedhjes së rrjetit të komunikimeve elektronike” parashikuar nga neni 137/a i K.Penal dhe “Vjedhja e veprave të artit dhe kulturës” parashikuar nga neni 138 i K.Penal;
- Vepra penale e “Mashttrim” parashikuar nga neni 143 i K.Penal;
- Veprat penale në lidhje me skemat mashtruese piramidale, manipulimi i tregut etj, të parashikuara nga nenet 143/a-149/b;
- Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare, si dhe në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare të parashikuara nga nenet 163-170/ç;
- Veprat penale në fushën e doganave të parashikuara nga nenet 171-179/ç;
- Veprat penale në fushën e tatimeve dhe taksave të parashikuara nga nenet 180-182/a;
- Veprat penale në lidhje me fallsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë të parashikuara nga nenet 183-185 të K.Penal.
- Vepra penale në fushën e falimentit të parashikuara nga nenet 193-196 të K.Penal;
- Vepra penale në lidhje me zhvillimin e palejuar të lojërave të fatit të parashikuar nga nenet 197-198 të K.Penal;
- Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese pa qenë i regjistruar të parashikuar nga neni 246/a i K.Penal;
- Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive dhe “interesave privatë” të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, të parashikuar nga neni 257/a i K.Penal;
- Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal;
- Çelja e llogarive anonime, të parashikuar nga neni 287/a i K.Penal;
- Përvetësimi i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale, të parashikuar nga neni 287/b i K.Penal;
- Importimi, prodhimi, shitja dhe ruajtja e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve, prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe

ushqimorë, tregtimi dhe hedhja për konsum e lëndëve djegëse në kundërshtim me standardet ligjore të cilësisë, mashtrimi me produktet ushqimore si dhe prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore, të parashikuara nga nenet 288 – 288/ç të K.Penal;

- Hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale sipas ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Seksioni 3

I drejtësisë penale për të mitur, kundër dhunës me bazë gjinore, marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ekzekutimit të vendimeve penale.

Ky seksion do të hetojë dhe përfaqësojë në gjykim veprat penale të mëposhtme :

- Veprat penale me të mitur sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
- Vrasja e foshnjës e parashikuar nga neni 81 i K.Penal;
- Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas, ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar dhe dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë, të parashikuara nga nenet 93-95 të K.Penal;
- Veprat penale me natyrë seksuale, të parashikuara nga nenet 100 – 108/a të K.Penal;
- Veprat penale e “Dhunimit të banesës” parashikuar nga neni 112 i K.Penal dhe “Dhunimit të varreve” parashikuar nga neni 118 i K.Penal;
- Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit të parashikuara nga nenet 113 – 117 dhe 121/a të K.Penal;
- Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuar nga nenet 124-130/a të K.Penal;
- Veprat penale kundër drejtësisë të parashikuara nga nenet 300-302, 304-311, 312/a-318, 320-324/a të K.Penal;
- Veprat penale me bazë gjinore;
- Ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, si dhe trajtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale;
- Përfaqësimin në gjykimet me viktime akuzuese të parashikuara nga neni 59 i K.Pr.Penale, si dhe gjykimet civile ku si palë është Prokuroria;
- Trajtimin e çështjeve dhe pjesëmarrjen në gjykim në lidhje me çështjet e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë si ekzekutim të letërporosive të ardhura nga jashtë shtetit, njohjen e vendimeve penale të huaja dhe ekstradimet.
- Trajtimin e kërkesave të të dënuarve.
- Përfaqësimin në gjykim të çështjeve civile ku palë në gjykim është organi i prokurorisë sipas dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil, K.Pr.Civile, K.Pr.Administrative dhe në ligje të tjera që parashikojnë pjesëmarrjen e prokurorit në proces.
- Shqyrtimin e informacioneve të policisë gjyqësore për pushimin e procedimeve penale për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe për rrjedhojë përfaqësimin në gjykim të këtyre çështjeve, për ato procedime penale të pezulluar në të cilat prokurorët vendimarrës nuk ushtrojnë funksionet në prokurorinë tonë.

B.Ndarja e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore është si vijon :

Seksioni 1 - I përgjithshëm (5 prokurorë dhe 8 opgj)

Seksioni 2 - I posaçëm kundër pastrimit të produkteve të veprës penale, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore. (3 prokurorë dhe 2 opgj)

Seksioni 3 - I drejtësisë penale për të mitur, kundër dhunës me bazë gjinore, marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ekzekutimit të vendimeve penale. (3 prokurorë dhe 3 opgj)

C.Drejtuesit e Seksioneve janë si vijon :

Seksioni 1 - I përgjithshëm

Z.Xhelian Seferi, njëherazi dhe Zv.Drejtues i Prokurorisë

Seksioni 2 - I posaçëm kundër pastrimit të produkteve të veprës penale, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore.

Znj.Edlira Bako

Seksioni 3 - I drejtësisë penale për të mitur, kundër dhunës me bazë gjinore, marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, ekzekutimit të vendimeve penale.

Znj.Pranvera Stafa

7.1.2 ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

7.1.2.1 EMËRIMI I ZV.DREJTUESIT TË PROKURORISË

Drejtuesi i Prokurorisë ka miratuar Urdhërin nr.44, dt.14.06.2023 në mbështetje të neneve 41, 44, 55 dhe 56 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Rregulloren për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm miratuar me Urdhërin nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Rezulton se me urdhërin nr.104, datë 11.10.2021 nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është emëruar në pozicionin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë Z.Gentian Habazaj, duke filluar nga data 11.10.2021. Rezulton se me vendim nr.44, datë 23.02.2023 të KLP, prokurori Gentian Habazaj është komanduar për një periudhë 5 vjeçare si Këshilltar Ligjor në KLP, nga data 15.03.2023 deri më datë 14.03.2028. Në këto rrethana, pozicioni i Zv.Drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka qënë vakant.

Për këto arsye dhe në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore për mirëadministrimin e prokurorisë është urdhëruar fillimi i procedurës për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkak se me vendimin nr.44, datë 23.02.2023, Zv.Drejtuesi aktual Z.Gentian Habazaj është komanduar për një periudhë 5 vjeçare si Këshilltar Ligjor në KLP.

Referuar urdhërave nr.1, nr.2, dhe nr.3, dt.06.01.2022 (të ndryshuar) të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, funksionojnë tre seksione në këtë prokurori që drejtohen nga prokurorët Pranvera Stafa, Edlira Bako dhe Xhelian Seferi.

Drejtuesit e Seksioneve të paraqesin tek Kancelarja e Prokurorisë formularin për shprehjen e interesit sipas modelit të parashikuar në Rregulloren për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm miratuar me Urdhërin nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm. Formularët të depozitohen brenda orës 12.00 të ditës së hënë dt.19.06.2023.

Kancelarja përgatit një relacion me shkrim mbi listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore mes Drejtuesve të Seksioneve që shprehin interesin për të kandiduar për Zëvendës Drejtues, i cili i dorëzohet Drejtuesit të Prokurorisë dhe kundërfirmohet prej tij.

Pas konfirmimit nga Drejtuesi i Prokurorisë, lista emërore e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore i komunikohet të gjithë prokurorëve.

Kancelarja përgatit Fletën e Listimit të Votave për kandidatët konkures sipas modelit të parashikuar në Rregulloren për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm miratuar me Urdhërin nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili i dorëzohet Komisionit të Votimit dhe administrohet prej tij.

Komisioni i votimit të përbërë nga Kancelarja Alketa Kurmaku, kryesekretarja Elida Kasa dhe sekretarja Fjoralba Salla.

Sekretare Pamela Hoxha është ngarkuar me mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes ditën e votimit, në të cilin pasqyrohet votimi i çdo prokurori dhe mendimi/opinioni i tij për kandidatët konkures, nëse prokurori votues dëshiron të japë një mendim/opinion/diskutim.

Votimi është i hapur. Mendimi/rekomandimi jepet për kandidatin që merr shumicën e votave të prokurorëve të pranishëm në votim.

Në përfundim të votimit, Komisioni i Votimit, plotëson Fletën e Listimit të Votave, duke shënuar të parin kandidatin që ka marrë numrin më të madh të votave dhe më pas kandidatët e tjerë, sipas votave të marra. Komisioni shpall kandidatin me numrin më të madh të votave si kandidatin për të cilin mbledhja e prokurorëve jep mendimin për Zëvendës Drejtues i Prokurorisë.

Thirrjen e mbledhjes së prokurorëve si vijon :

- a. **Rendi i ditës** : Votimi për dhënien e mendimit për zgjedhjen e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë.
- b. **Data e mbledhjes** : Ditën e martën, dt.20.06.2023, ora 15.00 në Sallën e Mbledhjeve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Drejtuesi i Prokurorisë emëron Zëvendës Drejtuesin e Prokurorisë. Mendimi i dhënë nga mbledhja e prokurorëve nuk është i detyrueshëm për Drejtuesin e Prokurorisë.

Në mbledhjen e prokurorisë marrin pjesë të gjithë prokurorët me të drejtë vote. Në rast se një prokuror nuk mund të paraqitet në mbledhje njofton kancelaren e prokurorisë me shkrim mbi mosparaqitjen dhe shkaqet përkatëse. Nëse shkak del aty për aty dhe lidhet me zhvillimin e seancave gjyqësore, prokurori njofton verbalisht kancelaren.

Në mbështetje të neneve 41, 42 dhe 44 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Rregulloren për emërimin e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm miratuar me Urdhërin nr.101, dt.12.06.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe në përputhje me mendimin e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të shprehur në mbledhjen e datës 20.06.2023, me Urdhërin nr.46, dt.20.06.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë është urdhëruar që **Z.Xhelian Seferi**, me funksion prokuror dhe Drejtues Seksioni në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, emërohet në detyrën e Zëvendës Drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Ky urdhër ka hyrë në fuqi më datë 20.06.2023. Është njoftuar për këtë urdhër Prokurori i Përgjithshëm dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Një kopje e këtij urdhëri është administruar në dosjen personale të prokurorit.

7.1.2.2 PROCESI I RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË PROKURORËVE (VETTING)

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.681, dt.07.07.2023 ka vendosur të konfirmojë në detyrë prokurorin **Z.Artur Ismajlukaj**, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH. Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë për shkak se është ankimuar në KPA nga Komisioneri Publik.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.686, dt.14.07.2023 ka vendosur të konfirmojë në detyrë prokurorin **Z.Xhelian Seferi**, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH. Ky vendim mori formë të prerë për shkak mos ankimimi më datë 27.09.2023.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.706, dt.20.10.2023 ka vendosur të konfirmojë në detyrë prokurorin **Z.Durim Bedini**, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH. Ky vendim mori formë të prerë për shkak mos ankimimi më datë 21.12.2023.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.708, dt.26.10.2023 ka vendosur të shkarkojë prokurorin **Z.Mustafa Turku** nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.725, dt.15.12.2023 ka vendosur të shkarkojë prokurorin **Z.Hektor Mushi** nga detyra e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.712, dt.07.11.2023 ka vendosur të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit **Bledar Mustafaraj** dhe ndalimin e emërimit të tij si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i

Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 30.11.2023. Pra, në organikën aktuale të Prokurorisë së Elbasanit mbeten pa përmbyllur gjatë vitit 2023 procesin e rivlerësimit kalimtar prokurorët Zena Lila, Gentian Habazaj, Neritan Hoxha, Pranvera Stafa, Petref Asllani dhe Rajmonda Berisha, ndërsa për prokurorin Artur Ismajlukaj vijon procesi i rivlerësimit në KPA.

7.1.2.3 LËVIZJET NË ORGANIKËN E PROKURORËVE

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr.44, dt.23.02.2023 ka vendosur të komandojë prokurorin **Z.Gentjan Habazaj** në detyrën e Këshilltarit Ligjor në KLP. Afati i komandimit është 5 vjet dhe fillon nga data 15.03.2023.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë vendimin nr.82, datë 24.04.2023 “Për transferimin e përhershëm pa pëlqim të prokurorëve nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para të cilat shkrihen për efekt ristrukturimi” nëpërmjet të cilit ka vendosur transferimin e përhershëm të **Z.Durim Bedini**, në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë vendimin nr.82, datë 24.04.2023 “Për ndërprerjen e transferimit dhe caktimit të përkohshëm të prokurorit **Z.Neritan Hoxha**” nëpërmjet të cilit ka vendosur ndërprerjen e transferimit dhe kthimin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr.130, dt.07.06.2023 ka vendosur të caktojë prokurorin **Z.Arbër Berexha** në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky vendim hyn në fuqi më datë 19.06.2023.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr.125, dt.29.05.2023 ka vendosur të caktojë prokurorin **Z.Platin Aliçka** në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky vendim hyn në fuqi më datë 14.06.2023.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr.123, dt.29.05.2023 ka vendosur të caktojë prokurorin **Z.Ritvan Suka** në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky vendim hyn në fuqi më datë 05.06.2023.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë vendimin nr.258, datë 10.07.2023 “Për caktimin në detyrë të prokurorit” nëpërmjet të cilit ka vendosur caktimin e **Znj.Glenda Zeneli**, në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë vendimin nr.240, datë 03.07.2023 “Për caktimin e **Znj.Ermira Manelli** në detyrë të prokurorit Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan” nëpërmjet të cilit ka vendosur caktimin e **Znj.Ermira Manelli**, në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në pozicionin vakant shpallur me vendimin e KLP nr.92, dt.09.05.2023. Ky vendim hyn në fuqi më datë 30.09.2023.

7.1.2.4 SHQETËSIMET E NGRITURA NË LIDHJE ME ORGANIKËN E RE

A. Në ushtrimin e funksioneve ligjore të Drejtuesit të Prokurorisë si dhe duke qënë i vetdijshëm përballë trupës së prokurorëve të kësaj prokurorie mbi gjendjen e mbingarkesës në punë, përsa i takon situatës aktuale të organikës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i është bërë me dije KLP me anë të disa shkresave si vijon :

1.Në referim të shkresave nr.69/13 prot., dt.19.01.2023, nr.109/26 prot., dt.03.02.2023 dhe nr.186/4 prot., datë 22.02.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme, struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndër të tjera, përbëhej nga 25 prokurorë (1 drejtues, 1 zv.drejtues dhe 23 prokurorë).

Me shkresën nr.600/3 prot., dt.20.04.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme është përcjellë struktura e re organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pas miratimit të hartës së re gjyqësore sipas VKM nr.495, dt.21.07.2022 “Për ri-organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave”. Në këtë shkresë bëhet me dije se në zbatim të Urdhërit nr.54, dt.18.04.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të ushtrojnë funksionet 20 prokurorë (1 drejtues, 1 zv.drejtues dhe 18 prokurorë).

Pra pas miratimit të hartës së re gjyqësore struktura organike në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është shkurtuar me 5 prokurorë.

Në një reagim në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, me shkresën nr.4000 prot., dt.25.04.2023, dërguar edhe në KLP për dijëni, kam kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme :

“Përsa më sipër në ushtrim të kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë dhe për nevoja pune, në funksion të transparencës dhe diskutimit profesional të kërkuar edhe nga prokurorë të kësaj prokurorie, kërkojmë informacion me shkrim mbi (1) arsyet dhe (2) metodologjinë e përdorur në këto ndryshime që prekin Prokurorinë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Elbasan, si dhe çfarë (3) kriteresh janë mbajtur parasysh në këtë shkurtim të numrit të prokurorëve duke u ndalur në faktin nëse ulja e ngarkesës prej 400 materiale mund të shërbejë si bazë arsyetuese për të shkurtuar strukturën me 5 prokurorë.

Po ashtu, lutemi të na dërgoni edhe një kopje të njehsuar të urdhërit nr.54, dt.18.04.2023 të PP si dhe në kopje të studimit eventual që mund të ketë shërbyer si bazë për këtë urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm”.

Natyrisht që për këtë shkresë dhe kërkesat e ngritura në të nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

2.Me shkresën nr.1025/4 prot., dt.26.06.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme është përcjellë vendimin nr.87, datë 22.06.2023 i Prokurorit të Përgjithshëm “Për caktimin e kategorive të prokurorive”, ku në pikën 1 janë përcaktuar prokuroritë e kategorisë së parë (të lartë), në të cilën përfshihet edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, krahas Prokurorive të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Tiranës, Durrësit, Fierit, Korçës, Shkodrës, Vlorës dhe Prokuroria e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Mbi këtë bazë është përcaktuar edhe struktura e pagave.

Rezulton se struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan përbëhet në tërësi prej 56 punonjës.

Me urdhërin nr.89, dt.23.06.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm janë caktuar strukturat organike të prokurorive në të gjithë vendin (prokurorë, oficer të policisë gjyqësore dhe punonjës administrativ).

Nga studimi i këtij urdhëri rezulton se ndër prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të kategorisë së parë (të lartë), **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka numrin më të ulët të punonjësve në strukturë organike.** Kështu :

- **Prokuroria Tiranë** 230 punonjës
- **Prokuroria Durrës** 85 punonjës
- **Prokuroria Fier** 62 punonjës
- **Prokuroria Shkodër** 60 punonjës
- **Prokuroria Korçë** 58 punonjës
- **Prokuroria Vlorë** 57 punonjës
- **Prokuroria Elbasan** 56 punonjës

Ndërsa përsa i takon numrit të prokurorëve është bërë kjo ndarje :

- **Prokuroria Tiranë** 90 prokurorë
- **Prokuroria Durrës** 34 prokurorë
- **Prokuroria Fier** 22 prokurorë
- **Prokuroria Shkodër** 20 prokurorë
- **Prokuroria Vlorë** 20 prokurorë
- **Prokuroria Elbasan** 20 prokurorë
- **Prokuroria Korçë** 19 prokurorë

Diferenca të tjera vihen re edhe përsa i takon numrit të punonjësve administrativ sipas sektorëve përkatës.

Duke mos pasur informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën në punë në prokurori të tjera dhe për këtë arsye në pamundësi për të bërë një vështrim krahasues, është bërë me dije gjendja e ngarkesës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Kjo prokurori ushtron funksionet e saj në Bashkitë Elbasan, Librazhd, Cërrik, Peqin, Belsh, Prrenjas dhe Gramsh, me një popullsi rreth 259.112 banorë³⁵. Në të njëjtin territor veprojnë Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, Komisaritet e Policisë Elbasan, Peqin, Cërrik, Librazhd dhe Gramsh si dhe Stacionet Policore Prrenjas dhe Belsh. Po ashtu, vepron Agjensia e Mbikqyrjes Policore Korçë-Elbasan, Sektori i Policisë Ushtarake Mengël dhe Drejtoria e SHKBB. Nga pikëpamja e lëndës, në ngarkesën e punës përfshihen edhe problematikat që lidhen me veprimin në territorin administrativ që mbulon Prokuroria Elbasan edhe të tre IEVP, konkretisht IEVP Peqin, IEVP Elbasan, IEVP Kosovë e Madhe.

Në një përmbledhje tërësore të të dhënave nga Zyra e Regjistrimit, deri në këtë fazë të vitit 2023, janë ri shpërndarë për shkak të lëvizjes nga detyra dhe dorëzimit të materialeve të prokurorëve

³⁵ https://ëëë.instat.gov.al/media/11213/vrs_2022pptx.pdf

Gentjan Habazaj, Zena Lila, Ritvan Suka, Platin Aliçka dhe Arbër Berexha, 2181 materiale, një ngarkesë që i është ri-shpërndarë një numri të kufizuar dhe përgjysmuar prokurorësh.

Në mbledhjen e datës 17.07.2023 të trupës së prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nga të gjithë prokurorët është ngritur shqetësimi për ngarkesën e madhe dhe pothuajse të papërballueshme në punë.

Në këto rrethana, jemi të mendimit që shkurtimi i menjëhershëm i numrit të prokurorëve me 5 prokurorë dhe numri më i ulët në tërësi i punonjësve të kësaj prokurorie krahasuar me prokuroritë e tjera, është një veprim jo realist dhe i pakonsultuar dhe për këtë arsye KLP mund të ndërhyjë për të kërkuar shtimin e numrit të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në 25 të tillë.

Besoj edhe KLP është i vetdijshëm se Prokuroria Elbasan nuk mund të ketë numrin më të ulët të punonjësve ndër prokuroritë e kategorisë së parë, përse kohë edhe nga KLP kjo prokurori është ravijëzuar, ndonëse jo formalisht, si “*prokurori karriere*” bashkë me prokuroritë e Tiranës dhe Durrësit, ku edhe problematikat e punës në Prokurorinë e Elbasanit janë specifike, komplekse dhe dinamike, ndërsa përse i takon numrit të prokurorëve është shumë larg nga “prokuroritë e tjera të karrierës”. Për këto arsye, me lejon të parashtoj mendimin se ndryshimet në numrin e prokurorëve të një prokurorie, sidomos të një prokurorie që vlerësohet si e rëndësishme nga KLP, duhet të kryhen me një qasje profesionale, të jenë rrjedhojë e logjikshme e një studimi shkencor dhe konsultimit ndëraktorial, në mënyrë që rëndësia që i jep KLP kësaj prokurorie të gjejë të njëjtën gjatësi vale edhe nga organet e tjera që kanë atribut të ndryshojnë organikat strukturore. Në fund të fundit stabiliteti strukturor i një organi është tipar i pavarësisë kushtetuese të tij dhe çdo hap që prek këtë stabilitet mund të jetë një premisë për cenim të parimit të pavarësisë funksionale.

Është në frymën e kuadrit ligjor aktual të miratuar pas reformës në drejtësi që çështje me rëndësi specifike të organikës së sistemit të prokurorisë të kryhen në kuadër të një diskutimi me strukturat drejtuese dhe trupën e prokurorëve të çdo zyre prokurorie në të gjithë vendin. Parimisht ndërhyrjet e njëanshme dhe jo transparente në strukturë çënojnë mirëfunksionimin e çdo zyre prokurorie, sjellin disbalancim në ndarjen proporcionale të ngarkesës dhe krijojnë pasiguri në detyrë për çdo prokuror që ushtron funksionet në prokurorinë që preket nga ndryshimet strukturore të bëra me efektin *surprizë*.

Po ashtu, më lejon të paraqes përsëri kërkesën për plotësimin nga KLP të vakancave të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan si një mjet efikas për përballimin e situatës së mbingarkesës në punë. Caktimi i vetëm një magjistrati të porsadiplomuar nga 26 të tillë si dhe transferimi me lëvizje paralele i një prokurori tjetër që fillon detyrën në këtë prokurori 3 muaj pas datës së vendimit janë shumë pak krahasuar me nevojat tona aktuale në punë.

B. Me shkresën nr.4806, dt.16.05.2023 drejtuar KLP, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, kam bërë me dije se Prokurore Znj.Zena Lila është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar detyrën për shkaqe shëndetësore. Sipas informacionit të dërguar me shkrim nga bashkëshorti i saj rezulton se gjendja shëndetësore e prokurores është e tillë që kërkon një kohë relativisht të gjatë për kurim dhe rehabilitim shëndetësor. Për këtë arsye ka filluar të paraqesë dhe do të vijojë në mënyrë periodike me depozitim të raporteve shëndetësore të lëshuara sipas ligjit. Në këto rrethana, me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor kam marrë masat e nevojshme konform ligjit në hapjen e zyrës së prokurores me anë të një komisioni dhe është kryer procesi

i zëvendësimit të kësaj prokurore nga çështjet që ka në verifikim/hetim dhe gjykim pasi afatet dhe rregullat procedurale janë të ngutshme që nuk presin deri në përfundim të qartësimit të gjendjes shëndetësore të prokurores.

C. Në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë kam parashtruar në mënyrë shkresore në KLP situatën aktuale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Me shkresën nr.600/5 prot., dt.24.04.2023 Prokurori i Përgjithshëm ka zvogëluar numrin e prokurorëve të kësaj prokurorie nga 25 në 20 prokurorë.

Pranë kësaj prokurorie ushtrojnë detyrën efektivisht 11 prokurorë (bashkë me drejtuesin e prokurorisë dhe dy prokurorët Z.Neritan Hoxha dhe Z.Durim Bedini caktuar në këtë prokurori në muajin maj 2023 pas shkrirjes së prokurorive Pogradec dhe Kavajë).

Prej muajit maj 2023 një prokurore e kësaj prokurorie Znj.Zena Lila për arsye shëndetsore është me raport të gjatë mjeksor dhe për shkak pamundësie për të ushtruar detyrën për një kohë të gjatë ka dorëzuar të gjithë ngarkesën e saj. Ndërsa dy prokurorë Binas Nina dhe Elveta Stafa janë të pezulluar për shkak se janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe kanë bërë ankim në Kolegjin e Posacëm të Apelimit.

Për vitin 2023 Këshilli i Lartë i Prokurorisë lidhur me këtë prokurori ka bërë këto lëvizje:

1. Në muajin shkurt 2023 ka komanduar në pozicionin e Këshilltarit Ligjor prokurorin Gentian Habazaj³⁶;
2. Në muajin mars 2023 ka zgjatur komandimin në Ministrinë e Drejtësisë për prokurorin Bledar Mustafaraj³⁷;
3. Në muajin maj 2023 ka caktuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dy prokurorët Ritvan Suka dhe Platin Alicka³⁸;
4. Në muajin qershor 2023 ka caktuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë prokurorin Arbër Berexha³⁹;

Pra së bashku me largimet nga procesi i rivlerësimit kalimtar, arsyet shëndetsore, zvogëlimin e numrit të organikës së prokurorëve, viti 2023 ka sjellë për këtë prokurori edhe komandime/transferime të prokurorëve në institucione/prokurori të tjera, lëvizje të cilat kanë passjellë problematikën e ngarkesës së çështjeve të lëna nga prokurorët e larguar.

Vetëm nga katër prokurorët e fundit (P.Alicka, R.Suka, A.Berexha dhe Z.Lila) që ka dorëzuar ngarkesën e tyre vetëm për një muaj janë dorëzuar 1914 dosje në hetim, në gjykim, praktika ekzekutimi, çështje direkte në gjykatë, dosje parashkrimi, të cilat i'u janë ri-shpërndarë 10 prokurorëve dhe një ngarkesë më të reduktuar edhe drejtuesit të prokurorisë, i cili detyrohet të përfshihet në short për shkak të kësaj situatë si dhe në shërbimin e gatishmërisë si çdo prokuror tjetër i kësaj prokurorie.

³⁶ vendimi i KLP nr.44 date 23.02.2023

³⁷ vendimi i KLP nr.51 date 06.03.2023

³⁸ vendimet e KLP nr.123&125 date 29.05.2023

³⁹ vendimi i KLP nr.130 date 07.06.2023

Në dosjet e lëna/dorëzuara nga prokurorët e larguar ka dosje/çështje sensitive, çështje në përfundim të afateve hetimore apo paraburgimi, të cilat kërkojnë impenjimin e menjëhershëm të prokurorëve, që kanë patjetër edhe ngarkesën e tyre të marrë rregullisht gjatë kësaj periudhe. Në këto kushte, në cilësinë e drejtuesit të kësaj prokurorie, duke qenë se në shpalljen e fundit nga ana e këtij Këshilli është shpallur vetëm një vend vakant, ju paraqes shqetësimin e trupës së prokurorëve për situatën e krijuar dhe më lejoni të sjell në vëmendjen Tuaj që nga ana e këtij Këshilli të konsiderohet në një kohë sa më të shpejtë të mundshme kryerja e procedurave për plotësimin dhe caktimin e prokurorëve edhe për katër vendet vakante të përhershme, që janë pranë kësaj prokurorie⁴⁰.

Është shumë e nevojshme që në trupën e 26 magistratëve të sapo emëruar që kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës të caktohen të paktën 3 prokurorë në Prokurorinë e Elbasanit, pasi situata është emergjente.

D. Me shkresën nr.2582, dt.13.03.2023 drejtuar KLP në ushtrimin e funksioneve ligjore të Drejtuesit të Prokurorisë si dhe duke qenë i vetdijshëm përballë trupës së prokurorëve të kësaj prokurorie mbi gjendjen e mbingarkesës në punë, përsa i takon situatës aktuale të organikës së prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kam bërë me dije si vijon :

Në referim të shkresave nr.69/13 prot., dt.19.01.2023, nr.109/26 prot., dt.03.02.2023 dhe nr.186/4 prot., datë 22.02.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme, struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndër të tjerë përbëhet nga 25 prokurorë (1 drejtues, 1 zv.drejtues dhe 23 prokurorë).

Aktualisht në këtë prokurori ushtrojnë detyrën 13 prokurorë. Rezulton se 3 prokurorë janë të shkarkuar nga KPK në pritje të gjykimit në KPA, 3 prokurorë të komanduar/cp dhe 6 vende prokurorësh vakant.

Me vendim nr.44, datë 23.02.2023 të KLP, prokurori Gentian Habazaj është komanduar për një periudhë 5 vjeçare si Këshilltar Ligjor në KLP, nga data 15.03.2023 deri më datë 14.03.2028.

Me vendimin nr.55, dt.12.03.2021 të KLP, prokurori Bledar Mustafaraj është komanduar me detyrë Përgjegjës i Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë. Periudha e komandimit do të jetë dy vjet dhe fillon nga data 19.03.2021. Me vendimin nr.51, datë 06.03.2023 të KLP këtij prokurori i është zgjatur afati i komandimit në MD edhe për një periudhë 3 vjeçare, nga data 19.03.2023 deri më datë 18.03.2026.

Me vendimin nr. 75, dt.29.03.2021 të KLP, prokurori Neritan Hoxha është caktuar përkohësisht me detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. Periudha e caktimit të përkohshëm do të jetë 1 (një) vit dhe fillon nga data 01.04.2021. Po ashtu, me vendimin Nr.76, datë 29.03.2021 prokurori Neritan Hoxha është caktuar përkohësisht me detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për periudhën 01.04.2021-30.06.2021. Afati i caktimit të përkohshëm për këtë prokuror është zgjatur me vendime të mëposhme të KLP.

⁴⁰ katër vendet e tjera janë vakance e perkohshme për shkak komandimi në KLP&MD dhe ankimi ne KPA.

Duke marrë shkas nga gjendja aktuale e organikës së prokurorëve dhe mbingarkesa në punë e krijuar nga kjo gjendje si dhe duke vlerësuar propabilitetin e veprimeve në dinamikë të procesit të rivlerësimit kalimtar, kërkoj që KLP të vlerësojë mundësinë e plotësimit të vakancave në burime njerëzore në prokurorinë tonë, pasi largimi i përkohshëm i prokurorëve G.Habazaj, B.Mustafaraj dhe N.Hoxha si dhe të prokurorëve të tjerë që janë larguar përfundimisht si rrjedhojë e proceseve të tjera (dalje në pension, dorëheqje, shkarkim nga KPK etj), kanë krijuar vështirësi të mëdha për të përballuar punën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Më lejoni t'ju bëj me dije se nga ana e KLGJ në vitin 2022 janë emëruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan 3 (tre) magjistratë të sapodiplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, ku në vlerësimin tim si Drejtues i Prokurorisë së Elbasanit, kapacitetet profesionale që prodhohen nga kjo shkollë mund të utilizohen edhe nga KLP për të plotësuar vendet vakant në këtë prokurori.

E. Me shkresën nr.13239, dt.27.12.2023 drejtuar KLP kam parashtruar se si rrjedhojë e procesit të ri-vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH sipas ligjit nr.84/2016 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë shkarkuar nga detyra nga KPK dy prokurorë dhe konkretisht Z.Mustafa Turku dhe Z.Hektor Mushi.

Nga të dhënat e regjistrave rezulton se këta prokurorë kanë dorëzuar një ngarkesë shumë të madhe materialesh problematika e së cilave nuk ka përfunduar.

Përgjatë vitit 2023 nga kjo prokurori janë transferuar në prokurori të tjera prokurorët Z.Arbër Berexha, Z.Ritvan Suka dhe Z.Platin Aliçka si dhe është komanduar në KLP Z.Gentian Habazaj. Po ashtu, prokurorë Znj.Zenal Lila për një periudhë shumë të gjatë kohore gjatë këtij viti nuk ka ushtruar funksionet për shkaqe shëndetësore dhe është rikthyer në detyrë vetëm ditët e fundit.

Struktura e prokurorisë parashikon në organikë 20 prokurorë. Aktualisht ushtrojnë funksionet 12 prokurorë, pasi 4 prokurorë janë shkarkuar nga KPK dhe janë në proces apelimi në KPA, një prokuror i komanduar dhe 3 vende janë vakante.

Në këto rrethana më duhet të përcjell shqetësimin që situata për shkak të ngarkesës dhe rishpërndarjes së materialeve, duke pasur parasysh edhe shumë problematika që lidhen me çështjet e tjera të tilla si marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, kërkesa në fazë ekzekutimit etj, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është në prag bllokimi të punës. Prokurorët janë të mbingarkuar.

Për këto arsye, kam kërkuar mirëkuptimin e KLP për një ndërhyrje aktive dhe të menjëhershme për plotësimin, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme, të vakancave me prokurorë në këtë prokurori.

F. Në një reagim në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, me shkresën nr.4000 prot., dt.25.04.2023, dërguar edhe në KLP për dijeni, kam kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme : “Përsa më sipër në ushtrim të kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë dhe për nevoja pune, në funksion të transparencës dhe diskutimit profesional të kërkuar edhe nga prokurorë të kësaj prokurorie, kërkojmë informacion me shkrim mbi **(1) arsyet** dhe **(2) metodologjinë** e përdorur në këto ndryshime që prekin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si dhe çfarë **(3) kriteresh** janë mbajtur parasysh në këtë shkurtim të numrit të prokurorëve duke u

ndalur në faktin nëse ulja e ngarkesës prej 400 materiale mund të shërbejë si bazë arsyetuese për të shkurtuar strukturën me 5 prokurorë.

Po ashtu, lutemi të na dërgoni edhe një kopje të njehsuar të urdhërit nr.54, dt.18.04.2023 të PP si dhe në kopje të studimit eventual që mund të ketë shërbyer si bazë për këtë urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm”.

7.1.2.5 MBROJTJA FIZIKE E PROKURORËVE

Gjatë vitit 2023 me vendimet përkatëse të Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka vijuar mbrojtja fizike e filluar gjatë vitit 2020 për një prokuror dhe në vitin 2021 për një prokuror tjetër. Mbrojtja e prokurorëve është caktuar nga ky komision në zbatim të detyrimeve ligjore, në përputhje me informacionet e administruara nga agjensitë ligjzbatuese dhe thelbësisht për shkaqe që lidhen vetëm me detyrën. Për nga prokurorët e sipërcituar është marrë nga Komisioni vendimi për përforsimin e masave të mbrojtjes personale.

7.1.2.6 PROCESI I VLERËSIMIT ETIKO-PROFESIONAL TË PROKURORËVE

Nga ana jonë janë dërguar në KLP informacioni i kërkuar (formularët e Aneksit 2) në kuadër të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorëve Anton Pali, Ritvan Suka dhe Mustafa Turku. Ky informacion ka qënë voluminoz, i gjërë dhe i detajuar, ku nxjerrja, përpunimi dhe plotësimi i formularëve kanë krijuar vështirësi pune për shkak të volumit të informacionit të kërkuar, afatit të shkurtër të lënë në dispozicion dhe mungesës së eksperiencës së mëparshme.

Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët Anton Pali, Ritvan Suka dhe Mustafa Turku kanë përfunduar Formularin e Integruar të Vlerësimit për këta prokurorë (Aneksi 3). Këto akte i janë dërguar KLP. Vlerësimi është bërë mbi baza profesionale dhe mbështetur në kritere merite duke analizuar cdo element të formularit në mënyrë përshkuese dhe objektive. Nga ana e prokurorëve pasi është bërë vetvlerësimi nuk ka pasur asnjë kundërshti për vlerësimet e bëra prej Drejtuesit të Prokurorisë.

7.1.2.7 OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE

Me vendimin nr.36, datë 24.04.2023 “Për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore Agim Cekrezi”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Agim Cekrezi** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan transferohet në të njëjtën detyrë në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Me vendimin nr.31, datë 24.04.2023 “Për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore Juliana Beqiraj”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Znj. Juliana Beqiraj** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan transferohet në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë.

Me vendimin nr.70, datë 24.04.2023 “Për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore Ermal Çela”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Ermal Çela** oficer i policisë gjyqësore në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan transferohet në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë.

Me vendimin nr.59, datë 24.04.2023 “Për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore Hasan Asllani”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Hasan Asllani** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat transferohet në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan. Me vendimin nr.59/1, datë 24.04.2023 “Për komandimin e oficerit të policisë gjyqësore Hasan Asllani”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Hasan Asllani** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan komandohet për një periudhë 3 mujore në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat. Afati i komandimit fillon nga data 01.05.2023. Me vendimin nr.59/2, datë 14.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të komandimit të oficerit të policisë gjyqësore Hasan Asllani”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Hasan Asllani** oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan i zgjatet afati i komandimit për një periudhë 3 mujore në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat. Afati i komandimit fillon nga data 01.08.2023.

Me vendimin nr.72, datë 24.04.2023 “Për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore Armino Visha”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Armino Visha** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Fier transferohet në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan.

Me vendimin nr.75, datë 24.04.2023 “Për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore Drini Pasho”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Drini Pasho** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Gjirokastrë transferohet në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan.

Me vendimin nr.163, datë 02.11.2023 “Për ngritjen në detyrë të oficerit të policisë gjyqësore Erion Karoli”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **Z.Erion Karoli** oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan është ngritur në detyrë në të njëjtin funksion në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Referuar masave disiplinore të dhëna nga Komisioni i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme gjatë vitit 2022 ndaj disa Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksionit në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga ana e një oficeri është kundërshtuar në Gjykatën Administrative kjo masë disiplinore (vërejtje me shkrim).

Përgjatë vitit 2023 me vendimin Nr. Regj. Them 2331 datë 13/02/2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur “*Pranimi I sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e vendimit nr. 117/1 datë 17/11/2022 të Komisionit të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme*” për Oficere të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Me Vendimin Nr 1743(80-2023-1780) datë 15.09.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur pranimi i padisë : “*Shfuqizimi i Vendimit Nr 117/1 datë 17.11.2022 ‘Për dhënien e masës disiplinore’, të Komisionit të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë, të vendosur me vendimin e datës 13.02.2023 të kësaj gjykate*”.

7.1.2.7.1 KARRIERA E OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE TË SEKSIONIT

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në ushtrim të kompetencave ligjore në mënyrë të vayhdueshme i është drejtuar Komisionit të Policisë Gjyqësore (në vijim KPGJ) pranë PP ka ngritur disa shqetësime thelbësore për mënyrën sesi është administruar karriera e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në pjesën që i përket komandimeve të OPGJ-ve nga dhe drejt Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Më konkretisht rezulton se edhe përgjatë vitit 2023 nga ana e Komisionit të Policisë Gjyqësore, janë kryer lëvizje të oficerëve të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Këto lëvizje, ashtu sikundër çdo transferim të oficerëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë bërë pa marrë fare mendimin e trupës së prokurorëve dhe Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Madje nuk jemi në dijeni nëse prej KPGJ apo Prokurorisë së Përgjithshme është bërë ndonjë studim mbi numrin e oficerëve dhe rregullat që duhet të ndiqen për transferimin, komandimin etj të oficerëve në Prokurorinë e Elbasanit në veçanti dhe në sistemin e prokurorisë shqiptare në tërësi.

Cdo lëvizje nuk është konsultuar as në aspektin sasior dhe as cilësor nga ana e KPGJ me Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe as me trupën e prokurorëve të kësaj prokurorie. Konstatojmë se nuk është marrë fare mendimi ynë për numrin dhe as për emrat e personave që janë sjellë të punojnë në këtë prokurori apo janë larguar prej këtej. Madje nuk kemi asnjë informacion nëse këto transferime janë apo jo rrjedhojë e ndonjë procesi disiplinor dhe as cili është subjekti që ka vënë në lëvizje Komisionin për të kryer lëvizjet e oficerëve.

Meqënëse Drejtuesi i Prokurorisë është, sipas ligjit nr.25/2019, titullar i policisë gjyqësore në juridiksionin ku ushtron funksionet dhe nisur nga fakti që Drejtuesi i Prokurorisë është përgjegjës për drejtimin dhe mirëfunksionimin e prokurorisë, përfshirë edhe çështje të ndjekjes dhe politikës penale, i kemi rekomanduar dhe sugjeruar KPGJ që çdo ndryshim në organikë, si në kuptimin sasior, ashtu edhe në kuptimin nominal, të jetë rrjedhojë e një studimi, analizë dhe pëlqimi të përbashkët mes të gjithë faktorëve, Prokurorisë së Përgjithshme, Komisionit të Policisë Gjyqësore, Drejtuesit dhe trupës së prokurorëve të prokurorisë vendore. Të gjitha kriteret e vendosura në nenet 21 dhe 22 të ligjit nr.25/2019 imponojnë pikërisht detyrimin që ndryshimet në policinë gjyqësore të jenë rrjedhojë të studimeve ndërfaktoriale dhe jo lëvizje mekanike momentale.

Në fund të fundit duhet të dëgjohet edhe mendimi prokurorëve që punojnë cdo ditë me oficerët që nga ana e KPGJ transferohen, jo si rrjedhojë e një mase disiplinore, për dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe ky është një tjetër kriter për forcimin e standartit të pavarësisë funksionale dhe procedurale të prokurorëve, pavarësi kjo e garantuar kushtetushmërisht.

Për këto arsye, kemi propozuar që nga ana e Komisionit të Policisë Gjyqësore, krahas subjektit propozues, për çdo ndryshim të organikës së një prokurorie të kryhet duke marrë drejtpërdrejtë edhe mendimin e drejtuesit dhe trupës së prokurorëve të asaj prokurorie.

Një tjetër moment thelbësisht i nevojshëm për t'u nënvijëzuar në këtë raport është fakti i komunikimit jo korrekt nga ana e Komisionit të Policisë Gjyqësore. Më konkretisht vlen të sjellim në vëmendje rastin që lidhet me oficerin e policisë gjyqësore Juliana Beqiraj, e cila me vendimin nr.97, dt.16.09.2022 të Komisionit të Policisë Gjyqësore, është komanduar nga seksioni i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për në seksionin e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Komandimi ka qënë për një afat 3 mujor dhe fillon nga data 20.09.2022. Deri më datë 31.12.2022 kur edhe mbaronte periudha e komandimit të kësaj oficeri, nga ana e KPGJ nuk është sjellë asnjë akt shkresor që të sqaronte çështjen e vijimit ose jo të komandimit të saj në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Me shkresën nr.4032 prot., dt.25.04.2023 i jemi drejtuar Komisionit të Policisë Gjyqësore ku i kemi bërë me dije se për këtë oficer afati i komandimit ka përfunduar më datë 06.04.2023 dhe se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ku është e emëruar kjo oficeri megjithëse kanë kaluar 20 ditë nga përfundimi i afatit nuk ka asnjë informacion apo vendim nga Komisioni juaj në lidhje me këtë rast.

E gjithë kjo sjellje ka treguar një mungesë tërësore serioziteti nga ana e KPGJ dhe është absolutisht e papranueshme nga pikëpamja administrative, duke sjellë për rrjedhojë edhe një ulje të imazhit të këtij komisioni në perceptimin e autoriteteve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për mënyrën sesi duhet të funksionojë ky komision.

7.1.2.7.2 VLERËSIMI I PUNËS SË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE TË SEKSIONIT

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në zbatim të ligjeve nr.97/2016 dhe 25/2019 dhe të “Rregullores për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore”, Nr.27, datë 30.10.2020, të miratuar me Vendimin Nr.27/1, datë 30.10.2020, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, ka realizuar vlerësimin e aftësisë profesionale dhe sjelljes etike për vitin 2022, për oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me shkresën nr.0851 prot.dt.13.07.2023, ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni i Policisë Gjyqësore dhe protokolluar nga ana jonë me numër 7311 prot., dt.17.07.2023, janë përcjellë vendimet për kategorizimin e vlerësimit të punës dhe integritetit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për vitin 2022.

Në lidhje me kategorizimin e vlerësimit të Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për vitin 2022 shpreh mosdakortësinë time si Drejtues i Prokurorisë pasi Komisioni i Policisë Gjyqësore ka dalë jashtë tagrave të tij ligjor duke keqinterpretuar dispozitat ligjore përkatëse, të cilat kanë ndikuar më pas në klasifikimin e vlerësimit të OPGJ-ve, nga “*Shumë mirë*”, në “*Mirë*”.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me shkresën nr.1795 prot. dt.17.02.2023, janë dërguar praktikat e vlerësimit të OPGJ-ve për vitin 2022, me pikëzimin përkatës për sejcilin prej tyre, sipas

Rregullores nr.27 dt.30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, e ndryshuar, e miratuar me vendimin e Komisionit nr.27/1 dt.30.10.2020.

Me shkresë të KPGJ, janë përcjellë për njohje ndryshimet e rregullores sa më lart, me vendimi nr.30 dt.07.04.2023 “Për disa ndryshime në Rregullore nr.27 dt.30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin të oficerëve të Policisë Gjyqësore”. Vendim i cili ka hyrë në fuqi menjëherë, domethënë më dt.07.04.2023. Në të parashikohen ndryshime dhe shtesa që i bëhen rregullores së mësipërme. **Gjithashtu në këtë rregullore mungon dispozita kalimtare për të përcaktuar sesi duhet të procedohet nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë dhe Komisionit të Oficerëve të Policisë Gjyqësore për periudhën e vlerësimit para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.** Mungesa e një parashikimi të tillë nuk mund t’i japë Vendimit nr.30 dt.07.04.2023 “Për disa ndryshime në Rregullore nr.27 dt.30.10.2020 Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, fuqi prapavepruese duke rënduar pozitën e oficerit të policisë gjyqësore, i cili vlerësohet për një periudhë kur ky vendim nuk ka ekzistuar. Pra këto ndryshime të rregullores mund dhe duhet të ishin aplikuar vetëm për periudhën e vlerësimit që i takon një periudhe të mëvonshme nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të rregullores, për shembull duke filluar në vlerësimin e punës për vitin 2023 që kryhet brenda muajit shkurt 2024.

Më konkretisht:

1.Ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, në lidhje me kompetencat e Komisionit të Policisë Gjyqësore, shprehet se ky komision vlerëson rezultatet e punës të oficerëve të policisë gjyqësore⁴¹, gjithashtu, po ky komision mbi bazën e rezultateve të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë, bën klasifikimin vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimeve: “I paaftë”, “Mjaftueshëm”, “Mirë” dhe “Shumë mirë”⁴².

Në zbatim të ligjit të sipërcituar është miratuar Rregullorja nr.27 datë 30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore” dhe në bazë të kësaj rregullore është bërë vlersimi i oficerëve nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë.

Komisioni i Policisë Gjyqësore në bazë të pikëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë ka bërë më pas kategorizimin e vlersimit të oficerit duke u bazuar në një vendim ku hyrja në fuqi e tij ka qenë më dt.07.04.2023, pas periudhës për të cilën është bërë pikëzimi nga ana e drejtuesit.

Komisioni i Policisë Gjyqësore në keqinterpretim të zbatimit të Vendimit nr.30 dt.07.04.2023 “Për disa ndryshime në Rregullore nr.27 dt.30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, ka aplikuar tek oficerët e policisë gjyqësore ndryshimet e parashikuara në të.

Në nenin 5 të saj të titulluar “Klasifikimi i vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, është parashikuar detyrimi i Drejtuesit të Prokurorisë dhe të Komisionit të Policisë Gjyqësore, **që për krverien e vlerësimit përfundimtar marrin parasysh faktin nëse ndaj tij është marrë masë disiplinore përgjatë periudhës që vlerësohet.**

Cili është kuptimi i termit “masë disiplinore gjatë periudhës që vlerësohet” ?

1. Periudha që ka qenë objekt kontrolli për dhënien e masës disiplinore ?
2. Periudha gjatë së cilës është dhënë masa disiplinore nga Komisionit ?
3. Periudha gjatë së cilës është në fuqi masa disiplinore e dhënë nga Komisioni ?

⁴¹ Shiko nenin 10 pika d, ligji 25/2019

⁴² Shiko nenin 29 pika 3, ligji 25/2019

Nga aktet e administruara nga Komisionit, rezulton se gjatë vitit 2022, janë dhënë masa disiplinore, “Vërejtje me shkrim”, parashikuara nga neni 34, pika 1 gërma “a”, e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, për opgj-të Armanda Shahini, Lorena Musai, Laureta Fusha, Rasim Guzi, Xhaferr Muha, Petrit Caku, Nevruz Ndrejoni për periudhën e kontrollit maj 2020-maj 2021.

Komisioni i Policisë Gjyqësore ka vendosur me vendimet nr: 82, 83, 84, 85, 86, 87,88 dt.11.05.2023, që për OPGJ e sipërcituar, në bazë të rregullores vlerësimit, të ndryshuar me vendimi nr.30 dt.07.04.2023 “Për disa ndryshime në Rregullore nr.27 dt.30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, t’u zbriten 20 pikë sejcilit, duke sjellë në këtë mënyrë ndryshimin e klasifikimit të vlerësimit të OPGJ-ve për vitin 2022, nga kategoria “Shumë mirë”, në “Mirë”.

Referuar nenit 5 pika 2 e rregullores ndryshuar me vendimi nr.30 dt.07.04.2023 “Për disa ndryshime në Rregullore nr.27 dt.30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetin të oficerëve të Policisë Gjyqësore”, në të cilën është bazuar Komisioni i Policisë Gjyqësore rezulton **se periudha për të cilën është marrë masa disiplinore i përket periudhës maj 2020-maj 2021 dhe jo e periudhës në të cilin është bërë vlerësimi i fundit, pra viti 2022**. Në këtë mënyrë Komisioni i Policisë Gjyqësore i ka dhënë një fuqi retroaktive ndryshimeve të rregullores duke penalizuar pa të drejtë oficerët për periudha të ndryshme dhe mbi bazën e një rregullore që nuk ka ekzistuar në kohën kur është kryer vlerësimi nga ana e Drejtuesit dhe i janë përcjell aktet Komisionit. Pavarësisht se vendimet e vlerësimit të Komisionit të Oficerëve të Policisë Gjyqësore janë bërë pas miratimit të ndryshimeve në rregullore, ky fakt nuk e përlligj ndërhyrjen e këtij komisioni në pikëzimin e bërë nga Drejtuesi i Prokurorisë përse kohë vet Komisioni nuk i ka dhënë fuqi retroaktive ndryshimeve në rregullore dhe ka ometuar të përcaktojë qartë kuptimin e termit “masë disiplinore gjatë periudhë që vlerësohet”.

Ka qënë praktikisht e pamundur dhe është nonsens të mendosh që Drejtuesi i Prokurorisë duhet të kishte aplikuar në muajin shkurt 2023 një ndrvshim në rregullore që është miratuar nga Komisioni juaj në muajin prill 2023.

2.Gjithashtu Komisioni i Policisë Gjyqësore, në lidhje me **OPGJ Lorena Musai**, nuk ka marrë parasysh vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.2331(31155-00258-80) dt.13.02.2023, me pale: paditëse Lorena Musai dhe e paditur Komisioni I Policisë Gjyqësore, me objekt “sigurim padie” etj, vendim që ka vendosur “Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, Pezullimin e zbatimit të vendimit nr.117/1 dt.17.11.2022 të Komisionit të Policisë Gjyqësore, me të cilin paditëses i është caktuar masa disiplinore e “vërejtjes me shkrim”.

Në lidhje me këtë vendim Komisioni i Policisë Gjyqësore është bërë me dije pasi ka qenë palë e procesit gjyqësor përfaqësuar me autorizim nga Znj.Ana Qorri si dhe nuk është ankimuar nga ana e komisionit. Vendimi gjyqësor i mësipërm nuk është marrë parasysh nga ana e Komisionit të Policisë Gjyqësore në momentin që masën e ka konsideruar të mirëqenë, kur në të vërtet ajo është pezulluar me vendimin e mësipërm të gjykatës, duke i zbritur oficerit 20 pikë nga vlersimi i bërë nga Drejtuesi i Prokurorisë, duke ndikuar për rrjedhojë edhe në ndryshimin e vlerësimit nga “Shumë mirë” në “Mirë”. Në një rast të tillë Komisioni i Policisë Gjyqësore mund të mos ishte shprehur në lidhje me kategorizimin e vlerësimit të oficerit në fjalë (deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga gjykata administrative) ose të kishte proceduar në bazë të pikëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë, duke e klasifikuar “Shumë Mirë” dhe jo “Mirë”. Në këtë mënyrë Komisioni ka dalë mbi dhe në kundërshtim me vendimarrjen e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Në vijim të analizës së mësipërme dua të risjell në vëmendjen tuaj, se Ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, në lidhje me kompetencat e Komisionit të Policisë Gjyqësore, shprehet se ky komision vlerëson rezultatet e punës të oficerëve të policisë gjyqësore⁴³, gjithashtu po ky komision mbi bazën e rezultateve të paraqitura nga drejtuesi i prokurorisë, bën klasifikimin vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimeve: “I paaftë”, “Mjaftueshëm”, “Mirë” dhe “Shumë mirë”⁴⁴. Në zbatim të ligjit të sipërcituar është miratuar Rregullorja nr.27 datë 30.10.2020 “Për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore”, e cila me ndryshimet e fundit ka sjelle një disbalancë në raportin e punës prokurori dhe komision. Konkretisht ndryshimi i nenit 4, pika 10, të rregullores⁴⁵ është në kundërshtim me ligjin, në të cilin citohet “Në rastet kur Komisioni, vlerëson se pikëzimi i kriterëve dhe nënkriterëve të bëra nga drejtuesi i prokurorisë nuk përputhet me të dhënat statistikore të paraqitura dhe aktet që shoqërojnë vlerësimin, bën vlerësim të ri, të ndryshëm nga ai i drejtuesit të prokurorisë. Arsyet e vlerëzimit ndryshe nga Komisioni pasqyrohen në vendimin përfundimtar të vlerësimit të Komisionit”.

Në këtë kontekst të analizës ligjorë shprehem se ky ndryshim nuk mund të përliqet dhe t’i jepet kompetenca komisionit të oficerëve të policisë gjyqësore për të shqyrtuar, vlerësuar dhe vënë në dyshim vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë për oficerët. Ky ndryshim mund të përliqet vetëm në rastet kur nga oficeri mund të ankimonte vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë, në këtë rast mund të hynte në veprim Komisioni për të respektuar të drejtën e ankimit të oficerit, por të vlerësonte dhe shqyrtonte vlerësimin vetëm për këtë oficer.

Duke ju referuar dispozitave të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, tagrin dhe të drejtën eksplicite për vlerësimin e oficerëve e ka Drejtuesi i Prokurorisë, pra në asnjë rast Komisioni nuk mund të ndërhyjë kryesisht në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë duke bërë një vlerësim ndryshe të oficerit. Ai ka vetëm tagrin që në bazë të vlerësimit dhe të pikëzimit të dhëna nga Drejtuesi i Prokurorisë të bëjë kategorizimin e oficerëve “i paaftë”, “mjaftueshëm”.....etj.

Në fund të fundit ky është edhe kuptimi i frymës që përcjell ligji nr.25/2019 që vendos Drejtuesin e Prokurorisë si titullar dhe përgjegjës të veprimtarisë së policisë gjyqësore për juridiksionin ku ushtron funksionet e tij dhe ku ligji nr.25/2019 duhet kuptuar si një derivat i reformës në drejtësi që garanton dhe kontribuon në një sistem prokurorial të decentralizuar, të pavarur, të shkëputur edhe konceptualisht nga sistemi i drejtësisë përpara ndryshimeve ligjore të paketës së reformës në drejtësi dhe imun nga tendencat centrifungiste që sjellin regres dhe duhet t’i përkasin të shkuarës.

I gjithë procesi i vlerësimit të punës së oficerëve të seksionit është miratuar në mënyrë unanime edhe nga e gjithë trupa e prokurorëve në disa mbledhje të mbajtura për këtë qëllim.

7.1.2.7.3 PROPOZIM PËR SHPËRBLIM ME MERITA PROFESIONALE PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE

Në kuadër të kompetencave si Drejtues i Prokurorisë sipas përcaktimeve të ligjit nr.97/2016 si dhe në cilësinë e prokurorit të çështjes për procedimin penal nr.393/2023, kam propozuar

⁴³ Shiko nenin 10 pika d, ligji 25/2019

⁴⁴ Shiko nenin 29 pika 3, ligji 25/2019

dhënien e një shpërblimi financiar për merita profesionale oficerëve të policisë gjyqësore, si vijon :

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka regjistruar dhe vijon hetimet në kuadër të procedimit penal nr.393, viti 2023. Ky procedim penal është regjistruar për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve” të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

Në kuadër të këtij procedimi penal është organizuar dhe ekzekutuar megaoperacioni policor me emrin “Rrjeti” ku gjatë së cilit është nxjerrë urdhëri i ndalimit për 50 persona, janë arrestuar në flagrancë 6 persona, janë ushtruar kontrole në mbi 80 banesa si dhe janë proceduar në gjendje të lirë apo shpallur në kërkim disa persona të tjerë.

Gjatë këtij procedimi penal janë aplikuar metodat speciale të hetimit, ndër të tjera edhe përgjimet telefonike të një numri shumë të madh personash, ku me ndihmën e Sektorit të Përgjimit të Komunikimeve Elektronike në Prokurorinë e Përgjithshme, përkatësisht me oficerët e policisë gjyqësore të ngarkur me ndjekjen e këtij procedimi penal Z.Adem Hidaj dhe Z.Basri Hadroi, me administratorët Z.Rezart Hana, Z. Elson Metalla dhe Z.Klaudio Ligori, është bërë e mundur realizimi me sukses i këtij procedimi penal.

Duke vlerësuar veprimet e kryera nga këto oficerë të policisë gjyqësore në ndjekjen, relatimin në dinamikë e në kohë të shpejt të të dhënave të përfituara nga interceptimet telefonike, kanë bërë të mundur arrestimin në flagrancë/ndalimin e autorëve, janë identifikuar bashkëpunëtorët e tyre, është dokumentuar gjërësisht veprimtaria kriminale si dhe konfiskimin e provave materiale në ngarkim të tyre (lënda narkotike, armë etj). Këta oficerë kanë ndjekur me përparësi dhe në kohë reale interceptimet telefonike, kanë raportuar dhe mbajtur kontakt të vazhdueshme me oficerët në terren për vëzhgimin dhe ndjekjen e personave të dyshuar si dhe kanë treguar gatishmëri dhe seriozitet në trajtimin e rasteve që iu janë ngarkuar për interceptim telefonik, duke përballuar me sukses edhe pas orarit zyrtar të punës dhe me efikasitet një volum të konsiderueshëm pune.

Në këtë kuadër, për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të Sektorit të Përgjimit të Komunikimeve Elektronike në Prokurorinë e Përgjithshme, mbështetur në aktet nënligjore të Prokurorisë së Përgjithshme, mbështetur në vlerësimin për shpërblimin për meritat profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të sektorëve, kam cmuar se duhet akorduar një shpërblim për punën e kryer nga ana e tyre të Z.Adem Hidaj, Z.Basri Hadroi, Z.Rezart Hana, Z. Elson Metalla dhe Z.Klaudio Ligori me detyrë oficerë të policisë gjyqësore të Sektorit të Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative në Prokurorinë e Përgjithshme.

Për këto arsye i është propozuar Prokurorit të Përgjithshëm shpërblimi financiar për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të sipërcituar.

7.1.2.8 REKRUTIME TË REJA LIDHUR ME STAFIN ADMINISTRATIV PËRGJATË VITIT 2023

Në strukturën organike për vitin 2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë vijuar 2 punonjës me kontratë 6 orësh.

Në këtë drejtim, ka vijuar marrëdhënia kontraktore me **Antoneta Shabani** në pozicionin e pastrueses dhe ka filluar më datë 14.02.2022 marrëdhënia kontraktore me **Migena Feimi** në pozicionin e arkivistes.

7.1.2.9 PROCEDURA E NDJEKUR NË RASTET E PUNËSIMEVE

Të gjitha procedurat për fillimin e marrëdhënieve të punës kanë ndjekur një procedurë strikte dhe unike nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me qëllim përafrimin përsa është e mundur me rregullat e rekrutimit në shërbimin civil.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për çdo rast është janë marrë vendimet e fillimin e procedurës së punësimit dhe për ngritjen e Komisionit të Pranimit dhe Vlerësimit të kandidaturave. Përbërja e këtij komisioni ka qënë me përfaqësues nga drejtuesit e prokurorisë, trupa e prokurorëve, oficerët e policisë gjyqësore, stafi administrativ dhe në rastin e rekrutimit të specialistit të IT-së edhe një ekspert i jashtë nga stafi universitar. Është nxjerrë njoftimi mbi kriteret e pranimit dhe më pas ky njoftim i është shpërndarë publikut për njohje nëpërmjet ëbsite zyrtar të Prokurorisë së Përgjithshme, në një media lokale me shikueshmëri të lartë, pranë Zyrës Rajonale të Punësimit si dhe në rrjetet e komunikimit social të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Për çdo rast punësimi, procedura e ndjekur është si vijon : Drejtuesi i Prokurorisë miraton urdhërin për fillimin e procedurës. Drejtuesi krijon me urdhër një komision për pranimin dhe vlerësimin, i cili realizon intervistimin, testimin dhe vlerësimin e aplikantëve. Përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe të posaçme që duhet të plotësojnë aplikantët për vendin vakant në bazë të nevojave të punës, në përputhje me procesin e punës që do të kryhet nisur dhe nga interesi për rritjen e eficensës së mbarëvajtjes së punës në prokurori, duke marrë në konsideratë edhe praktikën më të mira për rastet e ngjashme. Për këtë qëllim nxirret akti “Njoftim” ku specifikohen dokumentat që duhet të dorëzohen, procedurën që do ndiqet me aplikantët dhe afatet përkatëse. Njoftimi për vendin vakant dhe specifikimet e mësipërme njoftohen publikisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, në Drejtorinë Rajonale të Punës Elbasan dhe në një televizion lokal. Njoftimi shpallet në këndin e njoftimeve në hyrjen kryesore të prokurorisë si dhe në llogarinë në rrjetin facebook të kësaj prokurorie. Aplikantët dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar (jo më pak se dy javë) dokumentacionin përkatës pranë Zyrës së Kryesekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Marrja e dokumentave konfirmohet nga kryesekretarja kundrejt protokollimit. Dokumentat për cilindo aplikant i përcillen për siglim Drejtuesit të Prokurorisë. Dokumentacioni administrohet nga Kancelarja e Prokurorisë. Konkurimi zhvillohet në dy faza : Verifikimin paraprak që është vlerësimi i dokumentacionit dhe intervista si dhe vlerësimi që është testimi me shkrim. Në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, kancelarja kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit nëse përmbush apo jo kriteret e vendosura dhe përpilon për cdo aplikant një raport paraprak për këtë qëllim. Vijohet me procesin e intervistimit individual të të gjithë aplikantëve në datën dhe orën e përcaktuar, e cila i njoftohet aplikantëve. Mosparaqitja pa shkak të arsyeshëm nga aplikanti sjell si pasojë skualifikimin e tij. Intervistimi i aplikantëve kryhet në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit dhe me pjesëmarrjen e kancelares, e cila kryen relativimin për cdo aplikant. Intervistimi dokumentohet në një procesverbal mbledhje që mbahet nga një punonjës i administratës së prokurorisë. Në vijim, zhvillohet faza e testimit me

shkrim, në datën dhe orën e përcaktuar. Testimi zhvillohet nga Komisioni i Pranimit dhe mbikqyret prej tij. Komisioni miraton tezën e testimit me shkrim, e cila e sekretuar i shpërndahet aplikantëve ditën e testimit. Nga Komisioni kryhet edhe korigjimi i tezave të testimit. Testimi bazohet në njohuritë teorike dhe praktike të aplikantëve. Mosparaqitja pa shkak të arsyeshëm nga aplikanti sjell si pasojë skualifikimin e tij. Fazat e konkurimit kanë këtë sistem pikëzimi : dokumentacioni 20 pikë, intervista 40 pikë dhe testimi me shkrim 40 pikë. Në përfundim të fazave të sipërcituara komisioni analizon çdo aplikant dhe merr vendim për renditjen e tyre. Kualifikimi dhe/ose skualifikimi i aplikantëve si dhe renditja e tyre kryhet me votim nga komisioni nisur nga kriteret e përcaktuara. Vendimi merret me shumicë votash. Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Pranimit do të bëhet bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat, rezultatit të intervistës me secilin prej tyre si dhe testimin me shkrim. Komisioni miraton një raport përfundimtar drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë në të cilin përcaktohet e gjithë procedura e ndjekur, arsyetimi mbi çdo vendim të marrë si dhe renditja e kandidatëve sipas një liste. Konsiderohen të kualifikuar kandidatët që marrin mbi 70 pikë në renditjen përfundimtare të Komisionit të Pranimit. Kontrata lidhet nga punëdhënësi me aplikantin fitues duke respektuar renditjen e komisionit. Kancelarja njofton aplikantin fitues për të filluar marrëdhënien e punës. Një njoftim mbi rezultatin e konkurimit shpallet në vendin e njoftimeve në godinën e prokurorisë. Janë gjithashtu të vlefshme, për çdo fazë të procesit, njoftimet e realizuara nga Kancelarja me mjete komunikimi dhe njoftimet e drejtpërdrejta nga komisioni. Drejtuesi i Prokurorisë është organi në të cilin aplikuesit mund të paraqesin ankimmimet/kundërshtimet e mundshme mbi çdo vendim të marrë në çdo fazë të konkurimit. Afati i ankimit/kundërshtimit tek Drejtuesi i Prokurorisë mbi vendimet e Komisionit të Pranimit është 5 (pesë) ditë nga e nesërmja e njoftimit të vendimit nga Kancelarja. Mbi ankimin Drejtuesi merr vendim me shkrim, i cili i njoftohet kandidatit ankues. Ekzistenca e kontakteve dhe/ose lidhjeve familjare, gjinie, krushqie ose shoqërore të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale apo fshehja e tyre nga kandidatët dhe/ose ekzistenca e rekordeve kriminale brenda ose jashtë vendit nga kandidatët ose personat e lidhur me ta, përbën shkak që Komisioni i Pranimit ose Drejtuesi i Prokurorisë të vendosin e skualifikimin e një kandidati. Kryetari i Komisionit të Pranimit kryen verifikimet dhe/ose konfirmimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët si dhe në bashkëpunim me agjensitë ligjzbatuese kërkon dhe administron informacion mbi personalitetin e kandidatëve fitues dhe personave të lidhur me të. Procedura e sipërcituar ndiqet nga Komisioni i Pranimit dhe Drejtuesi i Prokurorisë bazuar mbi parimet e ligjshmërisë, mirëbësimit, objektivitetit, konfidencialitetit, barazisë, etikës, profesionalizmit dhe garancisë për rregullshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë. I gjithë dokumentacioni i administruar për këtë proces, së bashku me procesverbalin e intervistimit, administrohet nga Kancelarja.

7.1.2.10 PROCEDURA E NDJEKUR NË RASTET E LARGIMEVE

Bazuar në Urdhërin nr.25, dt.11.02.2019 “Për dorëzimin e dokumentacionit dhe ambjenteve” të Prokurorit të Përgjithshëm, për të gjithë prokurorët që janë larguar nga detyra në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë një urdhër për procedurën që duhet të ndiqet në kryerjen e dorëzimeve të dosjeve, dokumentacionit dhe

bazës materiale. Kjo procedurë është ndjekur për çdo prokuror të larguar pavarësisht shkakut të largimit, të tillë si shkarkim nga KPK, komandim etj. Konkretisht është urdhëruar fillimi i procedurës për dorëzimin e dokumentacionit dhe bazës materiale nga prokurori i larguar. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe bazës materiale (mjetet/materiale/zyra) që dorëzohen nga prokurori. Zyra e Regjistrimit të është urdhëruar të evidentojë çështjet në hetim dhe gjykim të prokurores, duke bërë dhe rakordimet përkatëse me vetë prokurorin sipas një liste. Për çështjet në hetim duke përcaktuar numrin e çështjes, datën e regjistrimit, oficerin e policisë gjyqësore që ndjek hetimin, veprën penale për të cilën është regjistruar, emrin dhe mbiemrin e personit nën hetim/pandehur, datën e regjistrimit të emrit, masën e sigurimit personal, si dhe në rast masash sigurimi “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” të përcaktojë dhe datat e arrestimit dhe caktimit të masës së sigurimit. Për çështjet që janë dërguar me kërkesa në gjykatë para gjyqtarit të seancës paraprake, apo që janë në gjykim themeli duke përcaktuar numrin e çështjes, veprën penale për të cilën është regjistruar, emrin dhe mbiemrin e personit nën hetim/pandehur, datën e regjistrimit të emrit, masën e sigurimit personal, si dhe në rast masash sigurimi “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” të përcaktojë dhe datat e arrestimit dhe caktimit të masës së sigurimit, kërkesën objekt gjykimi, fazën ku ndodhet gjykimi, emri i gjyqtarit dhe datën e caktuar për seancën gjyqësore të radhës. Prokurori i larguar është urdhëruar të marrë masat përkatëse për evidentimin të të gjitha materialeve shkresore në ndjekje të tilla si materiale kallëzuese, fashikuj procedimesh penale në hetim dhe gjykim, fashikujt e procedimeve të referuara për parashkrim, praktika që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale, shkresa njoftimi për seanca gjyqësore, praktikave shkresore për këto raste, praktikave në lidhje me persona në kërkim në nivel kombëtar/ndërkombëtar, si dhe cdo akt tjetër që i përket një procesi penal dhe/ose administrativ në ndjekje/përfaqësim nga ky prokuror, materialet shkresore ndjekja dhe problematika e së cilave ka përfunduar, si dhe numërtimin dhe listimin e këtyre materialeve apo çështjeve. Prokurori i larguar është urdhëruar që pas evidentimit, të marrë masat që brenda një afati sa më të shpejtë, të bëjë dorëzimin pranë Komisionit, të materialeve kallëzuese, fashikujve të procedimeve penale në hetim dhe gjykim, fashikujt e procedimeve për parashkrim, praktikave që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale, shkresave të njoftimit për seanca gjyqësore, praktikave shkresore për këto raste, praktikave në lidhje me persona në kërkim në nivel kombëtar/ndërkombëtar, materialet shkresore ndjekja dhe problematika e së cilave ka përfunduar, si dhe cdo akt tjetër që i përket një procesi penal dhe/ose administrativ në ndjekje/përfaqësim nga ky prokuror, pas numërtimit dhe listimit të këtyre materialeve apo çështjeve. Zv.Drejtuuesi i Prokurorisë është urdhëruar të marrë në dorëzim të gjithë materialet kallëzuese, fashikujt e procedimeve penale në hetim dhe gjykim, fashikujt e sjellë për parashkrim, praktikave që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale, shkresa njoftimi për seanca gjyqësore, praktikave shkresore për këto raste, praktikave në lidhje me persona në kërkim në nivel kombëtar/ndërkombëtar, materialet shkresore ndjekja dhe problematika e së cilave ka përfunduar, si dhe cdo akt tjetër që i përket një procesi penal dhe/ose administrativ në ndjekje/përfaqësim nga ky prokuror, pas numërtimit dhe listimit të këtyre materialeve apo çështjeve nga vetë prokurori. Për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të përcaktuar më sipër është mbajtur një procesverbal, i cili është nënshkruar nga marrësi në dorëzim dhe dorëzuesi në cdo fletë të tij. Zv.Drejtuuesi i Prokurorisë pas marrjes në dorëzim të materialeve shkresore është urdhëruar të veprojë si vijon : Materialet shkresore problematika e së cilave vazhdon i raportohen me shkrim Drejtuesit të Prokurorisë për të marrë

masat e zëvendësimit të prokurorit. Materialet shkresore problematika e së cilave ka përfunduar i dorëzohen Sektorit të Arkivit kundrejt procesverbalit. Në lidhje me provat materiale të sekuestruara dhe në posedim të prokurorit (sende, vlera materiale ose monetare, pajisje etj) që dorëzohen nga prokurori i larguar, është urdhëruar të merren në dorëzim nga Zv.Drejtuesi i Prokurorisë, sipas një inventari të nënshkruar nga të dy, në të cilin përshkruhet prova materiale, të dhënat identifikuese të saj, si dhe procedimi penal të cilit i përket (shoqëruar me kopje të procesverbalit të sekuestrimit). Zv.Drejtuesi i Prokurorisë është ngarkuar t'i dorëzojë provat që merr në dorëzim, kundrejt një procesverbali me nënshkrim, sipas rastit në Dhomën e Provave Materiale, ose prokurorit/of.pol.gjyqësore që merr fashikullin pas zëvendësimit të prokurorit të larguar. Mjetet materiale në ngarkim me vlerë monetare, pajisjet elektronike/kompjuterike dhe ambientet e punës (zyra dhe sendet e ndodhura në të sipas inventarit) është ngarkuar Kancelarja dhe Kryetarja e Degës së Buxhet/Financës t'i marrin në dorëzim. Cdo material shkresor dhe/ose me vlerë monetare që dorëzohet i nënshtrohet kontrollit, verifikimit dhe inventarizimit duke e ballafaquar me gjendjen e marrjes në dorëzim. Materialet shkresore listohen dhe numërtohen. Për cdo pasaktësi, mungesë dhe/ose dëmtim është urdhëruar të njoftohet Drejtuesi i Prokurorisë. Pas kryerjes së procedurës së dorëzimit nga prokurori i larguar, nga Komisioni, menjëherë i vihen në dispozicion Drejtuesit të Prokurorisë një kopje e dokumentacionit të mbajtur, si dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë paskësaj janë kryer procedurat përkatëse procedurale penale për zëvendësimin e prokurorit të larguar në materialet apo çështjet në verifikim, hetim dhe gjykim, me prokurorë të tjerë të kësaj prokurorie.

7.2 RAPORTI FINANCIAR

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Elbasan gjatë vitit 2023 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-financiare janë çelur fondet si më poshtë:

Fondi 2023	Plan	Fakt	Realizimi
Fondi i Pagave 600	187,034,000	187,031,260	100 %
Fondi i sigurimeve Shoq.Shëndt.	15,674,800	15,663,999	99.94 %
Fondi i shpenzimeve korrente	13,000,000	12,999.891	100 %
Fondi transferta korrente te brendshme	98,000	94,700	96.63 %
Fondi investimeve	11,100,000	11,054,250	99,59 %

Fondi i pagave ka një diferencë prej 2,740 lekë ose është realizuar në masën 100 %, . Gjatë vitit 2023 është bërë pagesa e magjistratëve për detyrimet e prapambetura të pagës për vitin 2019, 2020 dhe janar-shtator 2021. Në vazhdimësi me çeljen e fondeve nga Prokuroria e Përgjithshme do të bëhet edhe likuidimi i detyrimeve për periudhën tetor-dhjetor 2021 dhe vitin 2022.

Totali i pagesës së orëve të gadishmërisë për prokurorët është në shumën **7,284,661** lekë dhe totali i pagesës të mbikohës të punës për prokurorët është **276,395** lekë. (Vendimit Nr.191 datë

13.05.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku totali i orëve të gadishmërisë dhe orëve jashtë kohës së punës është 200 orë).

Llogaritja e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore është bërë sipas ligjeve në fuqi, ku sigurimin shoqëror llogaritet 9.5% mbi pagën maksimale në Republikën e Shqipërisë e cila është 176,416 lekë, kurse siguri shëndetsor dhe kontributi suplementar llogariten mbi pagën bruto.

Për punonjësit mbështetës (shofer, pastrues, punonjës shërbimi dhe punonjësit me kontratë u dha një shpërblim në masën e 10,000 lekë.

Lidhur me realizimin e fondit të shpenzimeve korrente realizimi është 100%.

- **MATERIALE ZYRE DHE TË PËRGJITHSHME** janë në shumën 517,480 lekë, ku përfshihen shpenzimet për kancelari, materiale pastrimi, dizifektimi, materiale të përgjithshme për funksionimin e zyrave, ku peshën më të madhe e zenë shpenzimet për kancelari në masën 47% të totalit, materiale e pastrimit janë në masën 34,8%.
- **SHËRBIME NGA TË TRETË** janë në shumën 2,735,282 lekë, ku përfshihen shpenzimet për energji elektrike, ujë, shërbime telefonike, shërbime postare, shtypshkrime, etj. peshën më të madhe e zenë shpenzimet për energji elektrike në masën 68,5% të totalit.
- **SHPENZIME TRANSPORTI** janë në shumën 403,609 lekë, ku përfshihen shpenzimet për karburant dhe vaj, pjesë këmbimi, goma dhe bateri, shpenzime për siguracionet e makinave dhe shpenzime të tjera transporti.
- Prokuroria Elbasan ka në pronësi tre automjete, dy automjete HYUNDAI me targë AA806NK AB806NK dhe MAZDA me targë AA881IV, të cilave u janë bërë shërbimet periodike për ti mbajtur në gadishmëri, në shumën 301,908 duke zënë 74,8% të fondit total të grupit.
- **SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJE TË ZAKONSHME** janë në shumën 627,600 lekë, ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, mirëmbajtjen e elektrike, të pajisjeve elektronike, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit. Peshën më të madhe të shpenzimeve të këtij grupi e zenë shpenzimet për riparimin e pajisjeve elektrike, si fotokopje, printera për ti mbajtur në gadishmëri për një funksionim sa më normal të punës në sekretari. Këto shpenzime zenë shumën 454,800 lekë ose 72,5% të fondit total të grupit.
- **SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE** janë në shumën 8,715,920 lekë, ku përfshihen shpenzimet për honorare, shpenzime për taksat e institucioneve, shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative. Shpenzimet për honorare që janë pagesat e avokatë, ekspertëve, përkthyesve etj, janë 8,342,680 lekë ose 95,7% duke zënë peshën më të madhe të shpenzimeve operative.

Në fund të vitit gjendja e fatura të palikuiduara për këtë zë është si më poshtë:

Akte eksperimentimi mjeko-ligjor	1,314,000	lekë
Avokatë	294,600	lekë

Përkthyes	45,720	lekë
Ekspertë të ndryshëm	670,910	lekë
Shpenzime Publike kadastrale		lekë

Realizimi i fondeve është në masën 99,97 %.

Gjatë vitit 2023 është çelur fond për investime në shumën 12,000,000 lekë “*Rikonstrukcion i sistemit të kondicionimit*”. Blerja e pajisjes chiller ishte në shumën 10,338,185.00 lekë dhe garancia 5% e blerjes në masën 544,115 lekë. Firma fituese u shpall operatori ekonomik “*Stela 2000*” shpk me vlerën 10,882,300 lekë. Supervizori ku fitues ishte firma “*ARENA*” sh.p.k u realizua në shumën 146,450 lekë. Kolaudatori ku fitues ishte firma “*KLODIODA*” sh.p.k u realizuar në shumën 25,500 lekë. Totali 11,054,250 lekë.

Shuma e mbetur nga prokurimi në masën 900,000 lekë u rialokua nga Prokuroria e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2023 janë krijuar këto të ardhura:

tarifat e taksave të pullave	71,560 lekë
shpenzimet proceduriale	103,025 lekë

Të ardhurat e krijuara janë derdhur në buxhetin e shtetit.

7.3 INFORMACION MBI REGJISTRAT

Me Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë Nr.14, datë 25.02.2021 “Për organizimin e brendshëm administrativ të punës në prokurori” është krijuar Zyra e Regjistratit.

Në funksion të kësaj pike përmendim nxjerrjen e akteve:

- Nr.11, datë 15.02.2021 Për krijimin e “Regjistratit të njoftimeve të viktimeve akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale” dhe “Regjistratit të çështjeve të tjera” në mbështetje të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.15 datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për trajtimin e njoftimeve të viktimeve akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë element të veprës penale”;
- Nr.59, datë 12.07.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për regjistrimin dhe qarkullimin e materialeve të para hetimore ose kallëzimeve penale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”;
- Urdhër Nr.20, datë 02.02.2022, “Për miratimin e formularit të praktikave të ekzekutimeve të vendimeve penale dhe krijimin e Regjistratit të Urdhërave të Kërkimit Ndërkombëtar”.
- Udhëzim i përgjithshëm Nr.15, datë 26.01.2022 “Mbi rregullshmerinë e mbajtjes dhe depozitimit të akteve procedurale dhe regjistrave të Prokurorisë”.
- Udhëzim i përgjithshëm Nr.27, datë 16.02.2022 “Mbi normimin e disa rregullave për kalimin administrativ të fashikujve të çështjeve penale të përfunduara”.

- Udhëzim i përgjithshëm Nr.60, datë.15.06.2022, “Mbi disa masa administrative dhe procedurale për delegimin e fashikujve të çështjeve penale për veprime verifikuese/hetimore/procedurale nga Prokurorët tek Oficerët e Policisë Gjyqësore”. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, lidhur me regjistrat fizik/elektronik, librat dhe sistemet të cilët janë në përdorim nga institucioni rezulton se në total janë funksional 71 regjistra në përdorim nga të cilët 50 janë regjistra fizik dhe 21 regjistra elektronik.
 - Protokoll i Drejtuesit mbi veprimtarinë hetimore (Drejtuesi Z. Kreshnik Ajazi) - *Fizikisht*
 - **Alketa Kurmaku – Kancelare**
 1. Regjistër “Sekrete Hetimore” – *Fizikisht*
 2. Regjistër i Përgjimeve – *Fizikisht*
 3. Regjistër Kërkesa – Përgjigje në kuadër të drejtës së informimit – *Fizikisht*
 4. Regjistër Kërkesa – Përgjigje në kuadër të drejtës së informimit – *Elektronikisht*
 - **Lindita Shopi - Krvetare e degës Buxhet – Financë**
 1. Libri i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor - *Fizikisht*
 2. Libri i magazines - *Fizikisht*
 3. Librat e arkës të pullave dhe shpenzimeve procedurale - *Fizikisht*
 4. Regjistër i pagesave për avokatët dhe ekspertët – *Elektronikisht*
 5. Regjistër i shpenzimeve procedurale – *Elektronikisht*
 - **Zyra e Protokollit**
 - **Elida Kasa - Kryesekretare**
 1. Protokollit i hyrjeve dhe daljeve të materialeve hetimore - *Fizikisht*
 2. Protokollit i hyrjeve dhe daljeve të shkresave dhe vendimeve të ndryshme - *Fizikisht*
 3. Protokollit i dosjeve që shkojnë në gjykatë: kërkesë për pushim, kërkesë për gjykim - *Fizikisht*
 4. Libër i dorëzimit të shkresave dhe materialeve me firmë - *Fizikisht*
 5. Regjistër i korespondencës së Informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
 6. Libër i dorëzimit të Informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
 7. Regjistri i shumfishimit të dokumentave të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
 8. Libri i qarkullimit të brendshëm të klasifikuar “Sekret Shtetëror” - *Fizikisht*
 9. Regjistri i regjistrave të Informacionit “Sekret Shtetëror” – *Fizikisht*
 - **Sekretare Pamela Hoxha**
 1. Regjistër për dosje të deleguara, pezulluara, për hetim, për kompetencë, parashkrime - *Fizikisht*
 2. Regjistër i Komunikimit të Vendimeve - *Fizikisht*
 3. Regjistër i Hetimit Pasuror - *Fizikisht*
 4. Regjistër për Vendimet e Gjykatës - *Fizikisht*
 5. Regjistër për shpërndarjen e materialeve – *Fizikisht*

6. Regjistër për urdhërat e ekzekutimeve - *Fizikisht*

➤ **Zyra e Regjistrit**

- **Sekretare Zamira Zykollari**

1. Regjistrat e procedimeve penale nga viti 2015 e në vazhdim – *Fizikisht*
2. Regjistrat e procedimeve penale nga viti 2015 e në vazhdim - *Elektronikisht*
3. Regjistri i të miturve – *Fizikisht*
4. Regjitri i Njoftimeve të Viktimave Abuzuese Nr. 59 – *Fizikisht*
5. Regjitri i Njoftimeve të Viktimave Abuzuese Nr. 59 – *Elektronikisht*

- **Sekretare Fjoralba Salla**

1. Regjistri i njoftimit/ kallëzimit të veprave penale, mosfillimit dhe Arrestet – *Fizikisht*
2. Regjistri i njoftimit/ kallëzimit të veprave penale, mosfillimit dhe Arrestet - *Elektronikisht*
3. Regjistri i Hetimeve Pasurore – *Fizikisht*
4. Regjistri i Hetimeve Pasurore – *Elektronikisht*
5. Regjistri i Procedimeve Pasurore – *Fizikisht*
6. Regjistri i Procedimeve Pasurore - *Elektronikisht*
7. Regjistri i evidentimit dhe shpërndarjes së materialeve të OPGJ – ve – *Fizikisht*
8. Regjistri i evidentimit dhe shpërndarjes së materialeve të OPGJ – ve - *Elektronikisht*
9. Libër i Komunikimeve të Brëndshme – *Fizikisht*

- **Sekretare Rozalina Terziu**

1. Regjistri i Ekzekutimeve – *Fizikisht*
2. Regjistri i Ekzekutimeve - *Elektronikisht*
3. Regjistri për Letërporositë – *Fizikisht*
4. Regjistri për Ekstradimet – *Fizikisht*
5. Regjistri për Gjykime të tjera – *Fizikisht*
6. Regjistër për Njohje Ekzekutim i Vendimeve Penale – *Fizikisht*
7. Regjistër për Njohje Ekzekutim i Vendimeve Penale - *Elektronikisht*
8. Regjistri i Urdhërave të Kërkimit Ndërkombëtar – *Fizikisht*
9. Regjistri i Urdhërave të Kërkimit Ndërkombëtar – *Elektronikisht*

➤ **Etleva Ballkoci – Sekretare pranë Drejtuesit**

1. Regjistri i Qarkullimit të Brëndshëm të Korespondencës Procedurale - *Fizikisht*
2. Regjistër i Shpërndarjes së Akteve të Drejtuesit - *Fizikisht*
3. Regjistër “Protokoll i Brëndshëm i Drejtuesit” – “Urdhëra – Udhëzime” - *Fizikisht*
4. Protokoll i mbledhjeve – *Fizikisht*

➤ **Denada Hajdini dhe Migena Feimi – Zyra Arshivës**

1. Regjistër i arkivimit të praktikave të ekzekutimeve – *Fizikisht*
2. Regjistër i dosjeve të arkivës nga viti 2002 deri në vitin 2015 - *Elektronikisht*
3. Regjistër i dosjeve të vjetra nga viti 1990 deri në vitin 2001 - *Elektronikisht*
4. Regjistër i dosjeve të Librazhdit – *Elektronikisht*

5. *Regjistër I procedimeve penale deri në vitin 2014 - Fizikisht*
6. *Regjistër i parashkrimeve – Elektronikisht (vetëm Migena Feimi)*
7. *Regjistër i dosjeve nga viti 2016 e në vazhdim – Elektronikisht*
8. *Regjistër i provave materiale – Fizikisht (vetëm Denada Hajdini)*
9. *Regjistër i provave materiale – Elektronikisht (vetëm Denada Hajdini)*
10. *Regjistër i dosjeve të Gramshit nga viti 1997 – 2007 - Elektronikisht (vetëm Migena Feimi)*

➤ **Xhesi Cimo - Specialist IT**

1. *Evidencë inventarizimi të pajisjeve elektronike si: skaner, fotokopje, kompjutera, printera, etj. – Elektronikisht*
2. *Regjistër lidhur me telefonatat hyrëse në Telefonin VOIP zyra e informacionit si numër kontakti për popullin në Prokurorinë Elbasan – Fizikisht*

➤ **Armida Halili - Koordinatore për Subjektet me Status të Posaçëm**

1. *Database me të dhëna për rastet e të miturve, dhunës në familje etj – Elektronikisht*

➤ **Zhaneta Pashaj – Sekretare pranë Prokurorit**

1. *Regjistër lidhur me marrjen dhe dorëzimin e materialeve (dosjeve penale të përfunduara për lidhje dhe sistemim) materialeve kallëzuese, arresteve – Fizikisht*

➤ **Anita Hoxha - Sekretare pranë Prokurorit**

1. *Regjistër lidhur me marrjen dhe dorëzimin e materialeve (dosjeve penale të përfunduara për lidhje dhe sistemim) materialeve kallëzuese, arresteve – Fizikisht*
2. *Regjistër i shpërndarjes së vërtetimeve – Fizikisht*

➤ **Klajva Xheka - Sekretare pranë Prokurorit**

1. *Regjistër lidhur me marrjen dhe dorëzimin e materialeve (dosjeve penale të përfunduara për lidhje dhe sistemim) materialeve kallëzuese, arresteve – Fizikisht*

➤ **Sekretare Xhensila Latif**

1. *Regjistër i shpërndarjes së materialeve të postës - Fizikisht*

➤ **Armand Canaku – Ftuesi**

1. *Regjistër poste – Fizikisht*

➤ **Nosi Prendi**

1. *Regjistër Hyrje – dalje e qytetarëve – Fizikisht*

➤ **Sistemet që menaxhohen:**

1. ***Sistemi CAMS** – Drejtuesi, Alketa Kurmaku, Fjoralba Salla, Zamira Zykollari dhe prokurorët në lidhje me pjesën e tyre për dosjet.*
2. ***Sistemi Presto** – Seksioni i Posaçëm Kundër Pastrimit të Produkteve të veprave penale, krimeve financiare etj (Prokurorë dhe Oficerë të seksionit).*

3. *Sistemi i Drejtësisë Penale për të Mitur* – Koordinatorja Armida Halili.

➤ **Sistemet me të drejtë akses:**

1. *TIMS* – Prokurorë dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore
2. *ASHK* – Prokurorë, Oficerë të Policisë Gjyqësore, adresa e Prokurorisë
3. *E – Albania* – Prokurorë, Oficerë të Policisë Gjyqësore, adresa e Prokurorisë ku ka akses Kancelarja dhe IT
4. *Sistemi i Certifikatave të Gjendjes Gjyqësore* – Prokurorë dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore
5. *Sistemi elektronik SVGOPGJP* – Drejtuesi dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore
6. *Outlook* – Prokurorë, Oficerë të Policisë Gjyqësore, Administrata
7. *Regjistri notarial* – Drejtuesi dhe Seksioni i Posaçëm
8. *Sistemi i Tatimeve* – Drejtuesi dhe Seksioni i Posaçëm
9. *Electronic platform: The Organised Crime and Corruption Track Record (OCCTR), (managed by JRC) - Zv/Drejtuesi i Prokurorisë Z. Xhelian Seferi dhe Sekretare pranë Zyrës së Regjistrimit Zj. Fjoralba Salla*

7.3.1 INFORMACIONI I KLASIFIKUAR

Drejtuesi i Prokurorisë në mbështetje të ligjit nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar, në zbatim të VKM nr.188/2015, nr.701/2014, nr.312/2011, nr.542/2019, 542/2021, nr.81/2008, ligjin nr.36/2020 si dhe urdhërat e Prokurorit të Përgjithshëm nr.69/2021, 68/2021, 38/2021, 62/2021, 91/2020, 09/2020, 52/2020, 105/2021, 111/2021, 81/2021, 82/2021, 83/2021, si dhe në përputhje me Raportin e Inspektimit të DSIK viti 2021 dhe shkresën dt.06.12.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, miratoi urdhërin nr.12, datë 06.01.2022 “Mbi administrimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”, ndryshuar me urdhërin nr.33, datë 21.02.2022.

Me anë të këtij urdhëri në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan u përcaktuan ambientet si Zona të Sigurisë së Klasit të Parë. Zyrat e klasifikuara sipas këtij urdhëri janë të pajisura me kasaforta sigurie për mbajtjen e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror. U përcaktua Zyra e Informacionit të Klasifikuar dhe në të administrohen regjistrat, librat, dokumentat dhe aktet e klasifikuara sekret shtetëror. Në Zyrën e Informacionit të Klasifikuar ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Njohjen dhe përpunimin e dokumentacionit të klasifikuar sekret shtetëror e kanë të drejtë vetëm personat e pajisur me CSP, të vlefshme dhe sipas niveleve përkatëse të sigurisë.

Po ashtu, u krijuan regjistrat dhe librat e informacionit të klasifikuar si vijon :

- Regjistri i korespondencës së informacionit të klasifikuar sekret shtetëror.
- Regjistri i shumëfishimit të dokumentacionit të klasifikuar sekret shtetëror.
- Libri i qarkullimit të brendshëm të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror.
- Libri i dorëzimit të korespondencës së informacionit të klasifikuar sekret shtetëror.

- Regjistri i regjistrave të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror.

Me urdhërin nr.17, datë 26.01.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë “**Mbi detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretares së Zyrës së Informacionit të Klasifikuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan**” u përcaktuan kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryesekretares së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan në funksionin e saj si Sekretare e Zyrës së Informacionit të Klasifikuar.

Me urdhërin nr.38, datë 11.03.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë “**Për miratimin e Planit të Masave të sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Skemës së Sigurisë Fizike të godinës bashkëlidhur planit të masave**” u miratuan masat për sigurinë fizike të informacionit të klasifikuar të cilat merren në zbatim të urdhërit nr. Nr. 01, datë 11.10.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm për “Përcaktimin e zonave të sigurisë në Prokurori” dhe në përputhje me kërkesat për klasifikimin e zonave të sigurisë.

Ky urdhër u nxorr në mbështetje nenit 38 të Ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Vendimit nr. 189, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 01, datë 11.10.2021, “Për përcaktimin e zonave të sigurisë në Prokurori”, Urdhërin nr. 12, dt.06.01.2022 (të ndryshuar) dhe nr.17, datë 26.01.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë.

Plani i masave të sigurisë fizike të informacionit të klasifikuar dhe aktet e mësipërme i janë përcjellë PP sipas ligjit. Për personat e pajisur me CSP u krye procesi i brifimit për njohjen e detyrave, rregullave dhe përgjegjësive që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore për administrimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror.

Në lidhje me procesin e administrimit dhe shpërndarjes së zyrave në godinën e prokurorisë ka vijuar zbatimi i urdhërit nr.112, datë 28.10.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë në skemën e përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme “**Për miratimin e planit të përdorimit dhe shpërndarjes së ambjenteve të brendshme**”.

7.3.4 ADMINISTRIMI I ARKIVËS DHE DHOMËS SË PROVAVE MATERIALE

Në kuadër të përmbushjes së detyrave ligjore dhe funksionale, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme informacionin si vijon në lidhje me situatën në arkivën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Me shkresën nr.189/49 prot., dt.15.04.2021 Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor ka kërkuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ekspertizës.

Me Urdhërin nr.87, datë 15.09.2021, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka ngritur Komisionin e Ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Ndër të tjera në këtë urdhër është disponuar :

1. *Ngritjen e Komisionit të ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me përbërjen e mëposhtme :*

- *Zv.Drejtuesi i Prokurorisë*
- *Prokuror me eksperiencë mbi 15 vjet*
- *Kancelarja*
- *Kryesekretarja*
- *Sekretarja e ngarkuar me arkivën*

Në mbledhjen e tij Komisioni i Ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka miratuar “Listën Tip të dokumentacionit me afatet e ruajtjes”, e cila i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme (për dokumentacionin administrativ). Kjo listë është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Prokuroria e Përgjithshme me Shkresën nr.1519/21, datë 06.01.2022 ka përcjellë listën e miratuar më dokumentat tip me afatin e ruajtjes (dokumentacioni administrativ).

Rezulton se Komisioni i Ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka miratuar dhe përcjellë për miratim tek Drejtuesi i Prokurorisë pasqyrat emërtuese të çeljes së dosjeve për vitin 2023 (model 5) për dokumentacionin RHK dhe për dokumentacionin me afat ruajtje 5-10 vjet. Këto pasqyra janë miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Komisioni i Ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka miratuar “*Listën Tip të dokumentacionit me afatet e ruajtjes*”, e cila i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme (për dokumentacionin hetimor penal). Kjo listë është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Përsa më sipër, kemi qënë të mendimit që nga Prokuroria e Përgjithshme duhet të vlerësohet mundësia që të nxirren rregulla dhe të miratohen formate dokumentash të unifikuara mbi mënyrën e administrimit të dokumentacionit arkivor në sistemin e prokurorisë me qëllim që të evitohen disponime të ndryshme mbi këtë dokumentacion nga prokurori të ndryshme.

Administrimi i dokumentacionit arkivor është një fushë e re dhe relativisht e panjohur për stafin administrativ të prokurorisë dhe për këtë arsye janë të nevojshme edhe trajnimet përkatëse për punonjësit administrativ. Mënyra sesi ruhet, administrohet, inventarizohet, përpunohet, asgjësohet, transportohet etj dokumentacioni i prokurorisë, përfshirë atë administrativ dhe atë procedural-penal, duhet normohet me rregullat të qarta dhe të unifikuara për sistemin e prokurorisë. Po ashtu, edhe marrëdhënia mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me Arkivin e Shtetit dhe Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor duhet të normohet dhe disiplinohet mes institucioneve në nivel qendror.

Përpunimi sipas normave tekniko-shkencore i dokumentacionit është një proces të duhet të fillojë nga viti 1993 e në vijim, duhet të shoqërohet me inventarizimin e dokumentacionit dhe më pas duhet që Komisioni i Ekspertizës të disponojë mbi këtë dokumentacion. Ky është një proces shumë i vështirë dhe delikat sepse përgjithësisht, ndër vite, dokumentacioni arkivor (procedural dhe administrativ) nuk është ruajtur dhe administruar sipas rregullave të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore si dhe për shkak të faktit se mungon një eksperiencë dhe praktikë në këtë fushë në sistemin e prokurorisë.

Një problematikë tjetër lidhet me faktin që fusha e administrimit të arkivave rregullohet nga një tërësi aktesh ligjore dhe nënligjore (rregullore, urdhëra, udhëzime të institucioneve të ndryshme) të cilat duhet të na vihen në dispozicion.

Përcaktimi i llojeve të dokumentave, kategorizimi i tyre sipas natyrës dhe disponimit, për dokumentacionin administrativ si dhe ndarja e dokumentacionit procedural-penal sipas natyrës së tij dhe mënyrës së zgjidhjes përfundimtare, si dhe përpunimi i këtyre dokumentave janë çështje që mund t'i nënshtrohen një rregullimi të unifikuar. Nga ana tjetër, edhe çështja e veprimit të zyrës së sekretarisë dhe mbajtja e regjistrave të protokollit në prokurori (korrespondencës) duhet të saktësohen dhe unifikohen për shkak se veprimtaria e prokurorisë nga pikëpamja administrative ka specifikat e veta që dallojnë nga veprimtaria e institucioneve të tjera të administratës publike.

Mënyra e hartimit të dokumentave, plotësimi i kërkesave teknologjike për ruajtjen dhe sigurinë fizike të dokumentacionit arkivor, përpunimi tekniko-shkencor, përgatitja dhe dorëzimi në arkivë i dokumentacionit, zbatimi i afateve të ruajtjes, procedurat e asgjësimit etj, janë gjithashtu çështje që duhen rregulluar në mënyrë profesionale, shkencore dhe të unifikuar.

Ky proces mbi dokumentacionin arkivor në sistemin e prokurorisë është një reformë e rëndësishme që duhet kryer në një fushë që nuk është administruar ndër dekada sipas rregullave teknike, profesionale dhe shkencore.

Në kuadër të përmbushjes së detyrave ligjore dhe funksionale, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka nxjerrë urdhërin nr.18, dt.31.01.2022 “Mbi administrimin e provave materiale...”.

Nga ana e një grupi pune, është përfunduar procesi i inventarizimit dhe sistemimit të Dhomës së Provave Materiale.

Rezulton se nga ky proces janë evidentuar një numër i konsiderueshëm sendesh të sekuestruara në cilësinë e provës materiale, të cilat janë klasifikuara si të “paidentifikuara” pasi nuk është arritur të gjendet një lidhje me një procedim penal konkret. Mungesa e regjistrimit të këtyre provave në momentin e hyrjes në Dhomën e Provave ka krijuar këtë problem shumë vite më parë.

Nga informacioni i grupit të punës, ka rezultuar se ekzistojnë një numër shumë i madh sendesh të ndaluara për t'u mbajtur fizikisht në ambjentet e prokurorisë, të tilla si lëndë narkotike, mbetje kufomore humane, pajisje elektronike, tesha, lëndë djegëse etj. Mbajtja e këtyre sendeve në disa raste mund të jetë burim rreziku të shtuar për pasojat më të rënda në ambjentet e prokurorisë.

Mungesa e lidhjes me një procedim penal konkret vështirëson ose pamundëson që nga ana jonë të disponohet sipas neneve 190 dhe 217-218 të K.Pr.Penale, pasi e kemi të pamundur të verifikojmë se çfarë ka disponuar prokurori/gjykata e çështjes në lidhje me provën materiale.

Nga ana tjetër mbajtja e këtyre provave në prokurori mund të jetë e ndaluar, e rrezikshme ose e pamundur për shkak mungese ambjentesh. Theksojmë se ka edhe një numër të konsiderueshëm provash materiale pa asnjë vlerë, të tilla si litarë, shkopinj, lopata, sustë, kazan rakie, hekurishte, copëza platiske etj.

Ndodhur në këto kushte, kemi kërkuar një mendim nga ana e PP mbi mënyrën sesi duhet të veprojmë me këto prova materiale dhe pse jo të vlerësohet mundësia që nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm të nxirrej një udhëzim mbi mënyrën e administrimit dhe disponimit të provave materiale të sekuestruara.

Nga kthimi i përgjigjes nga Prokuroria e Përgjithshme nuk rezultoi të parashtrohej ndonjë zgjidhje në lidhje me këtë problem.

7.4 MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Gjatë vitit 2023 personeli administrativ i kësaj prokurorie i ka kryer me korrektesë detyrat përkatëse, duke qenë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përballimin e ngarkesës në punë dhe krijimin e raporteve korrekte me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana e prokurorisë. Gjatë vitit 2023, buxheti financiar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është administruar me rigorozitet dhe si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetore nga Prokuroria e Përgjithshme për zëra të veçantë të tij, nga ana e kësaj prokurorie janë likuiduar pothuajse të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet procedurale, të pagesës së mbikohës së punës etj. Megjithatë, vlerësoj se ky buxhet duhet të rishikohet në të ardhmen për shtimin e tij në zëra të veçantë për një mbarëvajtje më të mirë të punës, duke u nisur nga fakti që nga viti në vit shtohet ngarkesa e punës dhe për rrjedhojë dhe nevojat financiare. Në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë vlerësoj se marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qenë korrekte. Nga ana e prokurorisë është shprehur gatishmëria për të dhënë informacion subjekteve të interesuar në çdo rast që është gjykuar se nuk cënohet hetimi dhe veprimet procedurale përkatëse. Në respektim edhe të normave Kushtetuese është respektuar e drejta për informim e subjekteve të ndryshme. Në rast të refuzimit të kërkesave për informacione lidhur me çështje konkrete, ato janë argumentuar bazuar në normat procedurale penale mbi ruajtjen e sekretit hetimor. Lidhur me administrimin e dokumentacionit të prokurorisë, konstatoj se jo vetëm regjistrat, por i gjithë dokumentacioni që administrohet në prokurori mbahet dhe ruhet rregullisht. Lidhur me mbajtjen e regjistrave, në prokurori ushtrojnë veprimtarinë punonjësit e ngarkuar posaçërisht me detyrën e mbajtjes së tyre dhe deri më tani nuk konstatohen problematika. Gjithashtu ky punojës merret me përdorimin dhe hedhjen e materialeve në sistemin CAMS dhe nuk janë konstatuar problematika në funksionalitetin aktual të këtij sistemi. Përgjatë vitit 2023, vlerësoj se kapacitetet infrastrukturore kanë qenë të mjaftueshme me qëllim realizimin e aktivitetit të prokurorisë. Megjithatë, kjo çështje meriton një vëmendje të veçantë në varësi edhe të organikës së prokurorisë apo nevojave për të kryer detyra të caktuara. Sa i përket sigurisë, kjo realizohet nëpërmjet shërbimeve private të ruajtjes fizike. Nuk rezulton të ketë pasur problematika lidhur me sigurinë, megjithatë, ashtu siç jam shprehur edhe në raporte të viteve paraardhëse, nisur nga natyra e veprimtarisë së prokurorisë, vlerësoj se do të ishte e përshtatshme që siguria të garantohej nga shërbimet e policisë të Drejtorisë së Policisë. Përgjatë vitit 2023 vlerësoj se është respektuar disiplina në punë dhe etika nga prokurorët, oficerët dhe punonjësit e administratës.

7.5 SIGURIA FIZIKE NË INSTITUCION

Nisur nga nevojat për një ecuri dhe funksionim sa më të mirë të punës dhe në kuadër të detyrimit si Drejtues i Prokurorisë për ruajtjen e sigurisë në institucion sipas nenit 42/i të ligjit nr.97/2016, në lidhje me situatën mbi sigurinë fizike në godinën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan rezulton se aktualisht siguria është maksimale si me prezencë fizike

të punonjësve të SHRSF por edhe me anë të një sistemi të vëzhgimit me kamera me disa kamera dhe pajisje që konstatojnë lëvizjet (*motion detection*). Pas angazhimit aktiv të Drejtuesi të Prokurorisë drejtuar PP (disa herë), KLP, KLGJ, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe DVP Elbasan çështja e sigurisë fizike të godinës së prokurorisë është rregullisht e garantuar.

7.6 MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE NË KUADËR TË PROCESIT ZGJEDHOR 2023

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri nr.17, dt.27.02.2023 mbi normimin e disa rregullave që kanë të bëjnë me nëpunësit e administratës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre gjatë periudhës së procesit zgjedhor. Sipas këtij urdhëri titullarët dhe nëpunësit civil e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kanë pasur detyrimin të zbatojnë në mënyrë korrekte përcaktimet e dhëna në vendimin nr.9/2020 të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik...” dhe udhëzimin nr.11/2023 të Komisionerit Për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil “Për unifikim e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim...”.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri nr.22, dt.27.03.2023 për delegimin e kompetencave dhe firmës për çështjet që lidhen me procesin zgjedhor të datës 14.05.2023. Sipas këtij urdhëri Drejtuesi i Seksionit të Përgjithshëm Z.Xhelian Seferi, për periudhën nga data 27.03.2023 deri në përfundim të procesit zgjedhor në të gjitha fazat e tij, ka mbuluar të gjitha problematikat që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve si dhe të gjitha veprat penale rrethanat e të cilave ose personat e përfshirë në to mund të lidhen me procesin zgjedhor të dt.14.05.2023 për të gjitha Bashkitë e Qarkut Elbasan, duke i’u deleguar të gjitha kompetencat që ka Drejtuesi i Prokurorisë për drejtimin e prokurorisë dhe në ushtrimin e ndjekjes penale të përcaktuara në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”:

Nga ana e Zv.Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri nr.26, dt.12.04.2023 mbi organizimin e shërbimit të gadishmërisë së përforcuar së prokurorëve, oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore dhe punonjëve të administratës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për periudhën zgjedhore nga 14.04.2023 deri më dt.19.05.2023.

Më datë 28.02.2023 është miratuar Rregullore e Brendshme e Grupit të Monitorimit, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet vendore.

Të gjitha problematikat që lidheshin me procedimet penale rrethanat e të cilit kishin të bënin me procesin zgjedhor janë ndjekur nga prokurorët e çështjeve dhe Zv.Drejtuesi i Prokurorisë.

7.7 SKEMA E SHPËRNDARJES SË ZYRAVE

Me anë të Urdhërit nr.112, dt.28.10.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë është miratuar skema e shpërndarjes së zyrave në godinën e prokurorisë dhe emërtimi/numërtimi i tyre. Shpërndarja e zyrave edhe përgjatë vitit 2023 është bërë nga Drejtuesi me anë të urdhërave të ndryshme në kuadër të administrimit material të prokurorisë si dhe sigurisë në institucion në përputhje me këtë skemë.

7.8 INSPEKTIVE TË KRYERA NGA INSTITUCIONE NË PROKURORI

7.8.1 INSPEKTIM I KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Me anë të shkresës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, jemi informuar se Zyra e Komisionerit do të zhvillonte një proces monitorues pranë institucionit tonë me qëllim krijimin e një panorame të plotë për raportimin dhe gjendjen e zbatimit të parimeve të privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në fokus të këtij procesi monitorues ishte:

1. Rregullimi dhe dokumentimi i nivelit të aksesit që kanë punonjësit në sistemet elektronike që përpunojnë të dhënat personale si dhe dosjet fizike.
2. Tipet e regjistrave në administrim nga institucioni
3. Procedurat që aplikohen në raste e transferimit të të dhënave personale, palëve të treta brenda dhe jashtë territorit.
4. Instrumentat ose mekanizmat e komunikimit që aplikohen për të siguruar nivelin e duhur për shkëmbimin e informacionit midis prokurorisë dhe EuroJust në zbatim të ligjit 113/2018.
5. Masat që ndërmerren për të garantuar ruajtjen e konfidencialitetit, etj.

Procesi monitorues u realizua në dy ditë të ndryshme përgjatë muajit Dhjetor 2023, ku nga ana jonë i'u vu në dispozicion i gjithë infomacioni dhe dokumentacioni. Na u komunikua verbalisht një vlerësim pozitiv lidhur me procesin, ende nuk kemi një raport përfundimtar mbi kostatime apo rekomandime nëse ka.

7.8.2 REKOMANDIM NGA AVOKATI I POPULLIT

Me shkresën nr K2/47-11 prot datë 14.12.2023 të Avokatit të Popullit është përcjelle rekomandim lidhur me një procedim penal, ku midis të tjerave është rekomanduar:

1. *Vlerësimin e zbatimit të sistemeve apo procedurave që të garantojnë kontrollin dhe verifikimin periodik të afateve të hetimit të dosjeve për të mos lejuar përsëritjen e të tilla rasteve në të ardhmen;*
2. *Marrjen e masave për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me institucionin e Avokatit të Popullit , duke rritur transparencën, shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e informacionit të saktë dhe dokumenteve hetimore.*

7.8.3 INSPEKTIM NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Përgjatë vitit 2023 kanë vijuar dy inspektive nga ILD për të cilat nuk ka pasur ndonjë konkluzion gjatë këtij viti dhe konkretisht :

- Inspektimi tematik nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë “Mbi zëvendësimet e prokurorëve nga çështjet penale”.
- Inspektimi tematik nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë “Mbi ndarjen e çështjeve në prokurori”.

Me vendimin nr.3409/1 prot., dt.29.12.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur të përfundojë inspektimin tematik të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm mbi marrjen e masave në kuadër të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Në përfundim të këtij inspektimi janë lënë disa rekomandime për ri-shikime të disa pikave në udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Afati për marrjen e masave për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve ka qënë periudha 01.01.2023 deri më datë 01.07.2023. Ky inspektim i ILD është kryer në zbatim të vendimit nr.37, dt.01.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për këtë inspektim është përpiluar Raporti nr.3409, dt.29.12.2022 nga grupi i inspektimit.

Për këtë qëllim Drejtuesi i Prokurorisë ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm “Për disa rishikime në udhëzimet e përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë në zbatim të rekomandimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” nr.49, dt.30.06.2023.

7.8.4 KËRKESA PËR FILLIM PROCEDIMI DISIPLINOR

Përgjatë vitit 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk ka patur asnjë kërkesë për fillim procedimi disiplinor.

KREU 8

INFORMACION PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT

8.1 TRANSPARENCA

Transparenca në veprimtarinë e një organi prokurorie është një element thelbësor në luftën kundër korrupsionit brenda sistemit por edhe një instrument bazik për të bërë të njohur për publikun veprimtarinë e prokurorisë në kuadër të rritjes së besimit të publikut në këtë organ. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka treguar gjithmonë një kujdes të veçantë në ndërtimin e një marrëdhënie dhe komunikim të qëndrueshëm me median por edhe për të pasur një qasje transparente përballë publikut, ku natyrisht përfshihen edhe raportet me subjektet procedurale.

Me urdhërin nr.83, datë 15.07.2022, Drejtuesi i Prokurorisë ka disponuar që në emër të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan krijohen dhe funksionojnë llogaritë në rrjetet e komunikimit social me emërtimet e mëposhtme :

- **Në facebook llogaria me emërtimin Prokuroria e Rrethit Elbasan dhe llogaria page me emërtimin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.**
- **Në tëitther llogaria me emërtimin Prokuroria e Rrethit Elbasan**
- **Në youtube kanali me emërtimin Prokuroria e Rrethit Elbasan**
- **Adresa email : prokuroriaerrethitelbasan@pp.gov.al**

Këto llogari administrohen vetëm nga punonjësi i prokurorisë në pozicionin e specialistit të IT dhe vetëm në pajisjet elektronike të institucionit. Specialisti IT është përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të llogarive elektronike të sipërcituara, të cilat nuk i ndan me asnjë person tjetër, punonjës ose jo në këtë prokurori. Specialisti IT është përgjegjës për sigurinë e aksesimit të këtyre llogarive, për çdo publikim dhe postim në to, si dhe merr të gjitha masat e mënjehershme për të evituar dhe parandaluar çdo ndërhyrje të paautorizuar, nga pajisje të paautorizuara apo persona të ndryshëm nga ai, si dhe për të shmangur aktivitete të pasakta, jo etike, jo profesionale, të paautorizuara etj, në këto llogari. Specialisti IT për çdo aktivitet në këto llogari konsultohet, sipas rastit, në Drejtuesin e Prokurorisë, magjistratin për mediat, koordinatorin për të drejtën e informimit, prokurorin e çështjes apo personin përgjegjës në prokurori. Specialisti IT, në rastet kur merr dijeni nga komunikimet në këto llogari elektronike, për të dhëna që kanë të bëjnë me veprimtarinë e prokurorisë përpilon një raport me shkrim të cilin ia paraqet Drejtuesit të Prokurorisë.

Në llogaritë në rrjetin social Facebook publikohen në mënyrë periodike çdo ditë të hënë të dhëna mbi masat e sigurimit të kërkuara nga prokurorët për personat e arrestuar ose ndaluar gjatë asaj jave nga shërbimet e policisë gjyqësore. Po ashtu, publikon periodikisht të dhëna mbi veprimtarinë procedurale, administrative dhe financiare të prokurorisë, të tilla si të dhëna mbi fajësitë apo pafajësitë të dhëna nga gjykata çdo tre muaj, të dhëna mbi procedime penale të përfunduara me sukses dhe të ndjekur me metoda special hetimi etj.

Drejtuesi i Prokurorisë, në cilësinë e titullarit të prokurorisë, ka pasur në disa raste komunikime me mediat dhe intervista për çështje të veprimtarisë së prokurorisë, të cilat janë detajuar në këtë raport në pjesën që i takon veprimtarisë së prokurorisë. Kështu janë dhënë intervista, sipas çështjes që ka përbërë interes për publikun, të tillë si për çështjen e ekstradimit, për çështje të kriminalitetit të të miturve, për hetimin e ngjarjeve të rënda etj.

Po ashtu, Drejtuesi i Prokurorisë, së bashku me titullarët e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan si dhe në një rast me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ka marrë pjesë në konferenca shtypi për mediat në përfundimin me sukses të procedimeve penale të ndjekura me metoda speciale hetimi apo në kapjen e personave në kërkim me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

8.2 PROCESI MONITORUES NGA KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PËRSONALE


Me anë të shkresës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, jemi informuar se Zyra e Komisionerit do të zhvillonte një proces monitorues pranë institucionit tonë me qëllim krijimin enjë panorame të plotë për raportimin dhe gjendjen e zbatimit të parimeve të privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në fokus të këtij procesi monitorues ishte:

- I. Rregullimi dhe dokumentimi i nivelit të aksesit që kanë punonjësit në sistemet elektronike që përpunojnë të dhënat personale si dhe dosjet fizike.
- II. Tipet e regjistrave në administrim nga institucioni
- III. Procedurat që aplikohen në raste e transferimit të të dhënave personale, palëve të treta brënda dhe jashtë territorit.
- IV. Instrumentat ose mekanizmat e komunikimit që aplikohen për të siguruar nivelin e duhur për shkëmbimin e informacionit midis prokurorisë dhe EuroJust në zbatim të ligjit 113/2018.
- V. Masat që ndërmerren për të garantuar ruajtjen e konfidencialitetit, etj.

Procesi monitorues u realizua në dy ditë të ndryshme përgjatë muajit Dhjetor 2023, ku nga ana jonë iu vu në dispozicion i gjithë infomacioni dhe dokumentacioni. Na u komunikua verbalisht një vlerësim pozitiv lidhur me procesin.

Gjithashtu gjatë këtij viti me anë të shkresës Nr. 2153 prot datë 23/11/2023 nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale na është bërë me dije detyrimi sipas ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, sugjerimet e së cilës u ndoqën me rigorozitet nga ana jonë.



Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në *ëebpage*.

Në *ëeb*site të Prokurorisë së Përgjithshme është përcaktuar edhe hapësira virtuale që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e cila mund të aksesohet përmes link : <https://ëëë.pp.gov.al/Elbasan/>.

Në këtë hapësirë janë vendosur

rubrikat : Dokumente, Media, Programi i Transperncës dhe Kontakt. Nga ana jonë, në rakordim me Koordinatorën për Mediat dhe specialistin përkatës në PP janë publikuar në këtë hapësirë virtuale aktivitete të ndryshme dhe pjesë që i takojnë veprimtarisë procedurale të prokurorisë sonë. Publikimet kanë qënë periodike dhe intesive.

Me rëndësi paraqitet plotësimi i detajuar i Programit të Transparencës si një instrument i rëndësishëm për publikun, në të gjitha rubrikat e tij si prezantimi i institucionit, të dhëna mbi të drejtën për akses dhe për t’u ankuar, dokumentat që mban dhe përpilon prokuroria, kontaktet në prokurori, të dhëna mbi veprimtarinë procedurale dhe financiare të prokurorisë, regjistrat, informacion mbi procedurat që ndiqen në prokurori etj.

Ky *ëeb* site zyrtar i prokurorisë tonë përditësohet në vijimësi me informacione dhe të dhëna duke reflektuar edhe rekomandimet e Komisionerit në kuadër të programit të transparencës . Nuk rezulton asnjë ankesë nga Komisioneri në këtë drejtim për institucionin tonë.

8.3 E DREJTA INFORMIMIT

Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH”, parashikon krijimin e një pozicioni të veçantë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, i cili do të ketë si rol kryesor marrëdhëniet me median dhe publikun.

Neni 61 i ligjit parashikon që *“Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyren prej tij. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.”*

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor drejtuesi i prokurorisë ka caktuar prokurorin për marrëdhënien me publikun dhe median. Nga data 02.06.2023 me urdhrin Nr. 40 të Drejtuesit të Prokurorisë, është caktuar si prokurore e marrëdhënieve me publikun dhe median Zj.Rajmonda Berisha e cila ka zëvendësuar prokuroren Zj.Edlira Bako.

Po ashtu është i caktuar edhe Kordinatori për të drejtën e informimit Zj.Alketa Kurmaku.

Gjatë vitit 2023 rezulton të jenë regjistruar gjithsej 25 kërkesa në kuadër të së drejtës së informimit nga përfaqësues të medias dhe subjekte të tjera. Konkretisht :


19 kërkesa nga gazetarë ,

1 kërkesa nga përfaqësues shoqata/organizata

2 kërkesa nga pedagogë të fakulteteve,

3 kërkesa nga shtetas,

Për 23 kërkesa është dhënë përgjigje dhe informacion dhe për 2 kërkesa janë refuzuar, sipas parashikimeve dhe afateve ligjore duke u publikuar edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në rubrikën programi i transparencës në Eeb site_in zyrtar të Prokurorisë pranë Gjyktës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm [https://ëëë.pp.gov.al/Elbasan/Programi i Transparences 16594](https://ëëë.pp.gov.al/Elbasan/Programi_i_Transparences_16594).




8.4 MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Në lidhje me publikun është për t'u theksuar fakti se nga ana e prokurorëve por edhe e drejtuesit, është mundësuar vazhdimisht pritja me korrektësi e ankesave, shqetësimeve të qytetarëve duke u munduar t'u jepet një zgjidhje sa më e shpejtë, e drejtë dhe ligjore.

Shtetasit janë orientuar që për çdo ankesë apo kërkesë që kanë ta parashtrojnë me shkrim, me qëllim që t'u mundësohet gjithashtu dhënia e një përgjigje me shkrim.

Nga institucioni ynë u është kthyer përgjigje të gjitha kërkesave të ardhura nga institucione të ndryshme apo shtetas brënda të gjitha afateve ligjore.

Vihet re se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm



Elbasan korispondencën më të lartë e ka mbajtur përgjatë vitit 2023 me Prokurorinë e Përgjithshme me 308 kthim-përgjigje, ndjekur me shtetasit të cilët kanë kërkuar dhe marrë informacion e nevojshëm. Një numër të vogël të korrespondencës Prokuroria e ka patur me KLGJ-në përkatësisht me 1 kthim-përgjigje , ONM-ja me 5 kthim-përgjigje, ILD-ja me 6 kthim-përgjigje, me prokuror në proces vettingu me 7 kthim-përgjigje, me I.E.Vp-të me 8 kthim-përgjigje, avokatin e Popullit me 9 si dhe SPAK përkatësisht me 15 kthim-përgjigje.

Veprimtaria dhe funksionimi i prokurorisë përfshin edhe angazhimet me natyrë jo procedurale, krahas asaj veprimtarie që lidhet me ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore për ushtrimin e ndjekjes penale. Për këtë arsye, gjatë vitin 2023, Drejtuesi i Prokurorisë por edhe funksionarë të tjerë të saj kanë marrë pjesë në mënyrë aktive dhe me përgjegjësinë e duhur në shumë aktivitete, takime, mbledhje që lidhen me veprimtarinë procedurale ose administrative të prokurorisë.

1. Datë 13/01/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Z. Kreshnik Ajazi dhe Zv/Drejtuesi Z. Gentian Habazaj morën pjesë në ceremoninë e 110 - vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit.
2. Datë:19/01/2023 Drejtuesi Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi thirri në një mbledhje OPGJ-të në prezencë dhe të Zv/Drejtuesit Z. Gentian Habazaj për diskutim rreth Urdhërit Nr. 14 dt: 16/01/2023 për moszvarritje të dosjeve, plotësimin të tabelës rreth Vlerësimit të OPGJ-ve, pasqyrimin e të dhënave në sistemin elektronik dhe orarit të paraqitjes në punë dhe njoftimi kur lëvizin për veprime hetimore
3. Datë 20/01/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të posaçëm mori pjesë në një tryezë diskutimi rreth hapësirave miqësore për të rinjtë në Këshillin e Qarkut Elbasan.
4. Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi më datë 20 – 27 Janar 2023 priti delegacionin belg në institucion në lidhje me hetimin e një ngjarjeje të ndodhur në Belgjikë.
5. Datë: 24/01/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi dhe një intervistë për Panorama TV në lidhje me gjendjen e kriminalitetit në vend si dhe për prioritetet e organit të hetimit për vitin 2023.
6. Datë 25/01/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi priti në zyrën e tij delegacionin suedez për të diskutuar rreth funksionimit të KVSP-së dhe mënyrës së

funkcionimit të prokurorisë. Pjesë e takimit ishte dhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili.

7. Më datë 26/01/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në prezantimin e analizës vjetore të DVP Elbasan.
8. Më datë 30/01/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Z. Kreshnik Ajazi dha një intervistë për gazetarin Andreë Higgins nga The New York Times.
9. Më datë 01/02/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Z. Kreshnik Ajazi dha një intervistë për televizionin Egnatia.
10. Më datë 07/02/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar për trajtimin e rasteve të fundit të dhunës në familje.
11. Më datë 08/02/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në një takim me dyer të mbyllura me Kryetarin e Bashkisë Elbasan dhe Ambasadorin Anglez në Shqipëri dhe më pas në një diskutim me të rinjtë, të organizuar nga projekti Rays. Pjesë e takimit ishin dhe Oficerja e Policisë Gjyqësore Znj. Lorena Musai, Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili.
12. Më datë 21/02/2023 Drejtuesi i Prokurorisë organizoi një takim në sallën e mbledhjeve me zyrën e shërbimit të provës Elbasan. Pjesë e takimit ishte Drejtuesja e Seksionit Prokurore Znj. Pranvera Stafa dhe Prokurori i Ekzekutimeve Z. Mustafa Turku.
13. Datë 22/02/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili dhe Oficere e Policisë Gjyqësore Znj. Lorena Musai morën pjesë në Ëorkshop - in me temë “Fight Against Cybercrime” (Krimi Kibernetik) të organizuar nga Projekti Rays, Palladium.
14. Datë 22/02/2023 Zv/Drejtuesi i Prokurorisë Z. Gentian Habazaj mori pjesë në një takim me ekspertët anglez mbi hartimin e një Strategjie të Integruar të Çështjeve të Sigurisë për KVSP e Elbasanit.
15. Akt – Marrëveshje nr. 375/2637 prot datë 15/03/2022 për lëvizjen dhe aksesin në godinën e përbashkët të Prokurorisë dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan.
16. Më datë 16/03/2022 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në



simpoziumin në kuadër të projektit Rays si anëtare e KVSP-së. Në fjalën e tij drejtuesi foli rreth metodave innovative për identifikimin e personave të rinj me rrezikshmëri të lartë për tu përfshirë në krim.

17. Më datë 17/03/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërdisiplinar për trajtimin e rasteve të fundit të dhunës në familje.
18. Më datë 3, 4 dhe 5 Prill 2023 Drejtuesi i Seksionit të Përgjithshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Z. Xhelian Seferi realizoi trajnimin e punonjësve të policisë në varësi të DVP Elbasan, lidhur me veprimet procedurale për ngjarjet/veprat penale që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.
19. Më datë 05/04/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi dhe Drejtuesi i Seksionit të Përgjithshëm Z. Xhelian Seferi morën pjesë në takimin e taks-forcës vendore për parandalimin e kultivimit të lëndëve narkotike, në DVP Elbasan, ku ishin pjesë dhe aktorë publik vendor.
20. Prononcim i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për emisionin “31 Minuta” në televizionin A2/CNN.
21. Më datë 06/04/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi organizoi një mbledhje me Oficerët e Policisë Gjyqësore të prokurorisë për diskutime problematikash pune.
22. Më datë 07/04/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në takimin e organizuar nga KLP me kryetarin e KLP-së dhe komisionin e vlerësimit të veprimtarive profesionale dhe etike, për çështjen e vlerësimit vjetor të prokurorëve. Të pranishëm ishin të gjithë drejtuesit e prokurorisë të rretheve.
23. Më datë 27/04/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në takimin e zhvilluar në Prokurorinë e Përgjithshme me Prokurorin e Përgjithshëm, drejtuesin e SPAK dhe Ministrin e Drejtësisë për Rekomandimet prioritare për luftimin e kriminalitetit të Këshillit të Ministrave për vitin 2023.
24. Më datë 27/04/2023 Drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në takimin e trekëndëshit të sigurisë Bashki – Prokurori – Polici me Kryetarin e Bashkisë Elbasan, Drejtorin e DVP Elbasan dhe përfaqësues të Zyrës së Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit dhe akteve ekstremeve.
25. Më datë 10/05/2023 me rastin e 110 – vjetorit të Ditës së Drejtësisë Drejtuesi i Prokurorisë në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” organizuan një simpozium me temë “Sfidat e drejtësisë shqiptare nga Kanuni i Zhurisë deri tek reforma në drejtësi në kuadër të proceseve integruese”.
26. 01/06/2023 i Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan mori pjesë në Forumin Ballkani Perëndimor: Fuqizimi i të rinjve për adresimin e Ekstremizmit, Urrejtjes dhe Polarizimit.
27. Prononcim i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për televizionin ABC Neës, lidhur me kriminalitetin e të miturve.
28. Prononcim i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për emisionin Ekskluziv me gazetare Anila Hoxha, rreth çështjes me rusët.
29. Prononcim i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për emisionin Inside Story ne Top Channel rreth kriminalitetit të të miturve.

30. Konferencë për median e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me Drejtorin e DVP – së Elbasan rreth veprimtarisë kriminale të shitjes së lëndëve narkotike të llojeve të ndryshme dhe arrestimit të 45 personave që ushtronin këtë veprimtari.
31. Datë 11/07/2023 Oficere e Policisë Gjyqësore Znj. Lorena Musai dhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili morën pjesë në takim me Znj. Alma Tandili, Kryetare e Agjensinë Shtetërore të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Bashkinë Elbasan, për të diskutuar rreth fëmijëve në situatë rruge.
32. Datë 12/07/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi dhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili mori pjesë në takim e organizuar nga KVSP në prezencë të Ambasadorit të OSBE dhe përfaqësuesve të disa Bashkive të tjera të Qarkut të Elbasani dhe jo vetëm, për shkëmbimin e praktikave të mira në funksionimin e KVSP-së.



33. Datë 14/09/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili mori pjesë në takim me përfaqësues të UNDP – së për zhvillimin e analizës së 3 - të të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të Dhunës në Familje në Bashkinë Gramsh.
34. Datë 14/09/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi dhe Zv/Drejtesesi Z. Xhelian Seferi takuan një delegacion të CSIT të ambasadës britanike ku u diskutua për projektin mbi problematikat që lidhen me pëpunimin e vendit të ngjarjes, sidomos me provat biometrike.
35. Datë 21/09/2023 preoncimi i Zv/Drejtesesi të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Xhelian Seferi për televizionin Top Channel mbi problematikat në lidhje me veprën penale të zjarrvënies në Qarkun Elbasan.
36. Dt: 22/09/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi thirri në një takim punonjësit e policisë për të diskutuar rreth problematikave që hasen në hetimin e çështjeve që kanë të bëjnë me policinë. Pjesë e takimit ishte Drejtori i DVP – së Elbasan, Zv/Drejtesesi Z. Xhelian Seferi, Drejtueset e seksionit prokurore Znj. Edlira Bako dhe Znj. Pranvera Stafa
37. Prenoncimi i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi për ABC Neës.
38. Dt: 28/09/2023 Konferenca për median e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, Drejtorit

të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Muhamet Rrumbullaku, prokurorëve Artur Ismajlukaj dhe Hektor Mushi, të drejtorëve të policisë Elbasan dhe Tiranë Ilir Proda dhe Tonin Vocaj, për megaoperacionin “Never Forget”.

39. Datë 11/10/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi realizoi një intervistë live për emisionin Top Neës në televizionin Top Channel, rreth sigurisë publike dhe kriminalitetit në Qarkun e Elbasanit.
40. Datë 12/10/2023 pronocimi i e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi për emisionin e gazetarit Fatos Alliu në Info Elbasani dhe emisionin “Fact Check” nga Arsen Rusta në MCN.
41. Datë 25/10/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi mori pjesë në eventin “Ngjarje publike” mbi sfidat dhe zbatimin sa më efektiv të Konventës së Stambollit, të organizuar nga Forumi i Gruas Elbasan.
42. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan



nisur nga problematikat e hasura në materialet hetimore të referuara nga DVP-ja Elbasan dhe Komisaritet e Policisë të Qarkut Elbasan, me inisiativën e Prokurorit Neritan Hoxha dhe Oficere e Policisë Gjyqësore Dr. Lorena Musai dhe me miratimin e Drejtuesit të Prokurorisë Z.Kreshnik Ajazi, ka organizuar më datat 26 - 27 tetor 2023, në ambientet e prokurorisë një takim

me qëllim orientues me strukturat përkatëse të policisë me tematikë “ *Pozita procedurale e të miturit në këndvështrimin e KDPM-së si dhe problematikat e hasura në praktikë në veprimet e para hetimore të kryera nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, duke u ndalur edhe në raste konkrete*”.

43. Më datë 31/10/2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me miratim të Drejtuesit të Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi organizoi një takim me përfaqësuesit e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Qarkun Elbasan për të diskutuar sfidat me te cilat përballemi dhe si të përmirësojmë bashkëpunimin me ta. Ky takim u realizua nga Oficerja e Policisë Gjyqësore Dr. Lorena Musai dhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili.
44. Datë 06/11/2023 në ambientet e Prokurorisë u realizua një takim me përfaqësues të Bashkisë Elbasan dhe përfaqësues të organizatës ARSIS, rreth pritshmërive të projektit që ata po aplikojnë për trajnime rreth krimit kibernetik. Pjesë e takimit ishte Zv/Drejtori i Prokurorisë Z. Xhelian Seferi, Oficere e Policisë Gjyqësore Znj. Lorena Musai dhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili.

45. Datë 14/11/2023 Drejtuesja e Seksionit të të miturve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Pranvera Stafa mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues në Bashkinë Librazhd për marrëveshjen e re të bashkëpunimit për MKR – në.
46. Më datë 21/11/2023 Më datë 23/11/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Z. Kreshnik Ajazi, Zv/Drejtuesi Z. Xhelian Seferi dhe Prokurore Glenda Zeneli organizuan një takim me drejtorin e DVP – së Elbasan, shefat e komisarivateve të qarkut, shefat e krimeve dhe shevat e seksioneve të DVP – së, me qëllim ri – kujtimin e opgj-ve mbi dispozitat proceduriale të kryera prej tyre me efekt pavlefshmërie.
47. Më datë 23/11/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Z. Kreshnik Ajazi, Zv/Drejtuesi Z. Xhelian Seferi dhe Kancelarja Znj. Alketa Kurmaku pritën në ambientet e prokurorisë ekspertin e CEPEJ Z. Vincent Macq, në kuadër të projektit të Këshillit të Europës “ Forcimi i efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë në Shqipëri” i cili zbatohet nga Komisioni European për Efikasitetin e Drejtësisë të Këshillit të Europës që synon të rrisë efikasitetin e sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet e CEPEJ si dhe rritjen e cilësisë së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet dhe instrumentet e cilësisë së CEPEJ. Qëllimi i kësaj vizite ishte pasqyrimi i një panorame të qartë të nevojave dhe pritshmërive, dhe rekomandimeve konkrete mbi fushat në të cilat CEPEJ mund të kontribuojë.
48. Më datë 23/11/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Z. Kreshnik Ajazi, prokurore Ermira Manelli dhe prokurore Glenda Zeneli, Koordinatorë për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili, pritën në ambientet e prokurorisë një grup nxënësish gjimnazistë, në kuadër të aktivitetit “Raundi i institucioneve”, në muajin Nëntor i cili është shpallur si muaji i “Të Drejtave të Fëmijëve”, nën koordinimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve Elbasan.
49. Më datë 30/11/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Znj. Armida Halili ishte prezentë në aktivitetin e organizuar nga shërbimi psiko – social i shkollës “Dhaskal Todri” për të diskutuar rreth të miturve në konflikt me ligjin dhe sjelljet që përbëjnë vepër penale.
50. Më datë 05/12/2023 Zv/Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Xhelian Seferi mori pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore. Në këtë aktivitet ishin prezente edhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj



Armida Halili dhe Oficerja e Policisë Gjyqësore Dr. Lorena Musai. Prokuroria u dha pjesmarrësve fletëpalosje të bëra në kuadër të këtyre ditëve.

51. Datë 06/12/2023 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi, Zv/Drejtuesi Z. Xhelian Seferi, Drejtuese e Seksionit Znj. Pranvera Stafa, Prokuror Neritan Hoxha, Prokurore Ermira Manelli pritën përfaqësuesin e ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar Z. James Mogridge. Ky takim kishte si objekt procedurat e transferimit të të dënuarve nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri, problematikat e hasura dhe vendosja e urave lidhëse.
52. Më datë 07/12/2023 Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Znj. Armida Halili dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore Znj. Lorena Musai dhe Z. Hasan Asllani morën pjesë në tryezën e rumbullakët në Prokurorinë e Përgjithshme të organizuar në kuadër të 16 ditëve aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore, dhe në sesionin informues me temë “Dhuna seksuale online te të miturit”.
53. Më datë 07/12/2023 Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Neritan Hoxha mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Bashkisë Prrenjas në lidhje me Mekanizmin e Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje.
54. Më datë 07/12/2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore përgatiti disa fletëpalosje dhe një video sensibilizuese për të denoncuar dhunën.
55. Datë 12/12/2023 Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Neritan Hoxha mori pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Bashkisë Gramsh “Për Mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare, si edhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”.
56. Më datë 13/12/2023, Zv/Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Z. Xhelian Seferi, prokurore Ermira Manelli, prokurore Glenda Zeneli dhe Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm Armida Halili pritën në ambientet e institucionit një grup nxënësish gjimnazistë të shkollë “Gjuhët e Huaja, të cilët u njohën me funksionin e prokurorisë. Gjatë takimit u bë e mundur informimi i të rinjve rreth veprave penale të kryera më së shumti prej tyre dhe se si procedohet me të miturit në konflikt me ligjin.
57. Më datë 22/12/2023 prokurore Glenda Zeneli mori pjesë në ceremoninë përkujtimore me fëmijët e punonjësve të policisë ë rënë dëshmorë të organizuar nga DVP Elbasan.
58. Drejtuesi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Z. Kreshnik Ajazi dhe Zv/ Drejtuesi Z. Xhelian Seferi më datë 26/12/2023 morën pjesë në ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave të vlerësimit të punës të punonjësve të policisë.

KREU 9

DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2024. REKOMANDIME

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se i do i shërbejnë punës së mëtejshme të administratës, investimeve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan:

- Rekomandojmë që Prokurori i Përgjithshëm të kryejë plotësimin e administratës me punonjës në pozicionin punonjës mirëmbajtje dhe të shtojë pozicionin sekretar pranë prokurorëve.
- Rekomandojmë që Komisioni i Policisë Gjyqësore, lëvizjet e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan t'i realizojë në kuadër të një analize strukturore në plan të gjërë dhe afat mesëm, duke kuadruar nevojat reale të prokurorisë, ngarkesën në punë dhe eficensën e policisë gjyqësore. Transferimet për dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si në aspektin sasior ashtu edhe nominalisht, duhet të jenë rrjedhojë e një koordinimi mes Komisionit të Policisë Gjyqësore, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Çdo ndryshim mekanik dhe momental, duke evituar analizën strukturore dhe pa ruajtur drejtpeshimin mes nevojës dhe efikasitetit, do të ishte jo efektiv.
- Përfundimi më i rëndësishëm i analizës së mësipërme është konstatimi i faktit të rritjes së ngarkesës efektive të Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan përgjatë vitit 2023. Për këtë shkak është i nevojshëm që nga KLP të kryhet plotësimi i organikës me prokurorë.
- Referuar statistikës dhe nevojave duhet të ngrihet një grup pune mes Komisionit të Policisë Gjyqësore, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim saktësimin e numrit të oficerëve që duhet të punojnë në prokurorinë tonë.

Rekomandojmë që Prokurori i Përgjithshëm :

a. Të sigurojë investimet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan sipas kërkesave, projekteve dhe preventivave të depozituara nga ana jonë dhe konkretisht :

- Në sistemin e sigurisë fizike të godinës së prokurorisë.
- Rishikim i kuadrit kontraktor për garantimin e ruajtjes së prokurorisë me SHRSF pas orarit zyrtar të punës dhe në ditët e pushimit zyrtar.

b. Marrjen e masave të nevojshme për fillimin e procesit të sistemimit të arkivës së prokurorisë, e cila është e tejmbushur, duke përcaktuar rregulla të qarta mbi mënyrën e administrimit të dokumentacionit arkivor në përputhje me aktet ligjore dhe rregullat teknike dhe shkencore për mbajtjen e këtij dokumentacioni apo edhe për transferimin ose asgjësimin e tij.

c. Është e nevojshme të azhurnohen aktet nënligjore më natyrë të brendshme me qëllim njehsimin e praktikave më të mira në prokurori përpara i takon shpërndarjes së çështjeve dhe aplikimit të shortit, më fokus përditësimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.3, viti 2016 “Mbi shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

d. Është e nevojshme të qartësohen me udhëzim të posacëm kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të prokurorisë dhe kancelarit në drejtimin dhe administrimin financiar të prokurorisë, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjeve nr.97/2016, nr.9936/2008 dhe nr.10296/2010 dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

e. Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjet nr.97/2016, 115/2016, 152/2013 dhe VKM nr.187/2017 dhe nr.919/2020, duhet të përpilohen aktet nënligjore për përcaktimin e punonjësve administrativ të prokurorisë që përfshihen brenda kuadrit të shërbimit civil, në mënyrë që të normohen procedurat e rekrutimit, transferimit, lëvizjes paralele, masave disiplinore, largimit nga detyra etj të këtyre punonjësve.

Nga ana tjetër kjo do të ndihmonte në realizimin e objektivave të mëposhtme

- Përfundimi në një afat sa më të shkurtër i procedimeve penale të mbartura nga viti 2023 dhe vitet e kaluara.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën nga nëpunësit shtetërorë, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, pasurisë, rendit dhe sigurisë etj.
- Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmërisë së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe marrjen në përgjegjësi penale të subjekteve përkatëse, si pastrimin e produkteve të veprës penale, vjedhjet etj, të cilat janë më të ndjeshme për shoqërinë tonë.
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.
- Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t’iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës.
- Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e prokurorëve si një instrument i rëndësishëm për të garantuar zbatimin e ligjit prej tyre.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të prokurorëve për zbatimin e detyrimeve që ata kanë sipas Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12 datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve me prokurorëve dhe Drejtuesve të Prokurorisë, informimin,

transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar”.

- Konsolidimin në një nivel të qëndrueshëm bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë jo vetëm si mjet efikas në parandalimin e ngjarjeve kriminale, por është edhe mesazh për forcimin e besimit të publikut.
- Hetimi me intesitet i ngjarjeve të rënda kriminale dhe rezultatet konkrete për autorët e tyre, shpërndarja dhe trafikimi i narkotikëve si dhe format e krimit ekonomik që sjellin pasoja në financat publike dhe ato të qytetarëve duhet të jenë në vëmendjen tonë, sigurisht pa lënë pas dore ndjekjen efektive penale për të gjitha krimet e tjera.
- Mbështetja e punës sonë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është një tregues efektiv i rezultateve të punës dhe suksesit të prokurorisë, mbështetje e cila vjen rrjedhojë e ushtrimit me profesionalizëm të detyrave nga ana e prokurorëve por edhe ndërtimit të marrëdhënieve korrekte mbi bazë ligjshmërie me gjyqtarët.
- Rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë.
- KLP duhet të trajtojë administratën për plotësimin e formularëve të Aneksit 2 në procesin e vlerësimit profesional të prokurorëve dhe për procese të tilla të caktojë afate më të gjata pune pasi kërkohet të dhëna të detajuara dhe duhet të realizohet një proces shumë i vështirë, në mënyrë të tillë që procesi i nxjerrjes, përpunimit dhe dërgimit të të dhënave të kërkuara në KLP të mos krijojë pengesa në punën tonë të përditshme.
- Duhet të shtohet një pozicion në Zyrën e Buxhet/Financës për hedhjen e të dhënave në sistem.
- Duhet të shtohet fond financiar për pagesën e orëve të punës jashtë orarit zyrtar të punës për punonjësit e administratës dhe oficerët e policisë gjyqësore.

DREJTUESI I PROKURORISË
Kreshnik AJAZI